**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale**

*Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite- Ministry of Labour and Social Welfare*

DEPARTAMENTI PËR POLITIKA SOCIALE DHE I FAMILJES

# MIRËQENIA SOCIALE 2019

PRISHTINË, 2020

**Përgatiti** Ylfete Ramosaj-Abazi, Zyrtare e lartë për të dhëna dhe statistika
Divizioni për Planifikim dhe Përfshirje Sociale DPSF/MPMS
ylfete.ramosaj@rks-gov.net

**Përgjegjës** Mentor Morina, Drejtor
Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes / MPMS
mentor.morina@rks-gov.net

**Adresa** Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes / MPMS
Rr. UÇK-së Nr.1
10000 Prishtinë, Kosovë

**Botues** Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes / MPMS
Data e botimit: Dhjetor 2020
©: Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes / MPMS
Riprodhimi nuk është i lejuar pa autorizim. Për përdorimin e të dhënave duhet theksuar burimi

## Lista e shkurtesave:

| | |
|---|---|
| MMPS | Ministria e Punës dhe Mirëqënies Sociale |
| DPSF | Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes |
| DPPS | Divizioni për Planifikim dhe Përfishirje Sociale |
| DPS | Divizioni  i Politikave Sociale |
| DSHS | Divizioni i Shërbimeve Sociale |
| DAKPM | Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar |
| DNS | Divizioni i Ndihmës Sociale |
| KPSHSF | Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare |
| NJMI | Njësia për Monitorim dhe Inspektim |
| PVPQ | Plani Vjetor i Qeverisë |
| QPS | Qendra për Punë Sociale |
| SOS | Fshati i Fëmijëve |
| QKUK | Qendra Klinike Universitare e Kosovës |
| SDSF | Shpresa dhe Shtëpia e Fëmijëve |
| ISSH | Instituti Special në Shtime |
| SHPMPF | Shtëpia e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare |
| SHK | Shtëpitë e Komunitetit |
| QMGF | Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve |
| MF | Ministria e Financave |
| MZHE | Ministria e Zhvillimit Ekonomik |
| MAPL | Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal |
| ATK | Administrata Tatimore e Kosovës |
| ZAK | Zyra e Auditorit Kombëtar |
| NJAB | Njësia e Auditorit të Brendshëm |
| BQK | Banka Qendrore e Kosovës |
| PKShA | Posta e Kosovës Shoqëri Aksionare |
| NJKM | Njësia e Kontrollit dhe e Mbikëqyrjes |
| DFDIL | Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës |
| SNS | Skema e Ndihmës Sociale |
| NS | Ndihma Sociale |
| DPP | Departamenti i Punës dhe Punësimit |

| | |
|---|---|
| TI | Teknologjia e Informative |
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| DKSHMS | Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale |
| BpB | Banka për Biznes |
| KEDS | Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike |
| KESO | Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike |
| OJQ | Organizatë Jo Qeveritare |
| FFAKP | Familjet më Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përhershme |
| KM | Komisioni Mjekësor |
| RTK | Radio Televizioni i Kosovës |
| PV | Personat e Verbër |
| PPT | Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik |

## Lista e figurave:


| | | |
|---|---|---|
| *Figura 1* | Rastet e reja të fëmijëve të braktisur, janar-dhjetor 2019 | 24 |
| *Figura 2* | Përqindja e fëmijëve të braktisur sipas gjinisë, 2019 | 25 |
| *Figura 3* | Fëmijët e braktisur gjatë vititi 2019 dhe ata të bartur nga viti 2018 me përqindje | 25 |
| *Figura 4* | Numri i fëmijëve të braktisur që janë bartur nga viti 2018 në vitin 2019 | 26 |
| *Figura 5* | Numri i fëmijëve të vendosur në strehim familjar brenda familjes, sipas muajve | 28 |
| *Figura 6* | Shuma e mjeteve të procesuara për pagesën e strehimit familjar brenda familjes, 2019 | 29 |
| *Figura 7* | Numri i rasteve të reja dhe i rasteve të bartura të fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes, 2019 | 30 |
| *Figura 8* | Numri i fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes dhe numri i familjeve strehuese, 2019 | 31 |
| *Figura 9* | Shuma e mjeteve të procesuara për pagesën e strehimit famljar jashtë familjes, 2019 | 31 |
| *Figura 10* | Numri i kërkesave të shqyrtuara për adoptim, 2019 | 32 |
| *Figura 11* | Numri i kërkesave të aprovuara për vendosje në strehim familjar dhe familje strehuese, 2019 | 33 |
| *Figura 12* | Numri i fëmijëve të strehuar në SOS Familje | 34 |
| *Figura 13* | Numri i fëmijëve të vendosur në strehimore, 2019 | 35 |
| *Figura 14* | Numri i fëmijëve me sjellje asociale dhe të miturit në konflikt me ligjin, 2019 | 36 |
| *Figura 15* | Numri i fëmijëve të evidentuar në punë të rënda | 38 |
| *Figura 16* | Fëmijët në punë të rënda me përqindje, 2019 | 38 |
| *Figura 17* | Përqindja e viktimave të dhunës në familje sipas moshës, 2019 | 41 |
| *Figura 18* | Përqindja e viktimave të dhunës në familje sipas gjinisë | 41 |
| *Figura 19* | Përqindja e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore sipas moshës, 2019 | 44 |
| *Figura 20* | Përqindja e viktimave të trafikimit sipas gjinisë | 45 |
| *Figura 21* | Përqindja e viktimave të trafikimit sipas vendit të prejardhjes, 2019 | 45 |
| *Figura 22* | Trajtimi i rasteve me këshilla martesore sipas nacionaliteteve, 2019 | 47 |
| *Figura 23* | Përqindja e kërkesave për strehim institucional/rezidencial | 51 |
| *Figura 24* | Numri i kërkesave të shqyrtuara për strehim institucional/reidencial, 2019 | 52 |
| *Figura 25* | Struktura nacionale e klientëve në SHPMPF-Prishtinë, dhjetor 2019 | 53 |
| *Figura 26* | Struktura nacionale e klientëve në ISSH, dhjetor 2019 | 54 |
| *Figura 27* | Struktura nacionale e klientëve në Shtëpinë e Fëmijëve në Shtime | 55 |
| *Figura 28* | Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së | 56 |
| *Figura 29* | Shuma e mjeteve të procesuara për pagesën e Skemës së FFAKP-së, 2019 | 57 |
| *Figura 30* | Fëmijët përfitues të FFAKP-së sipas vijueshmërisë së procesit mësimor, 2019 | 58 |
| *Figura 31* | Numri i kërkesave të shqyrtuara nga Komisioni Mjekësor i Shkallës I, 2019 | 59 |

| | | |
|---|---|---|
| *Figura 32* | Kërkesat e shqyrtuara nga Komisioni Mjekësor i Shkallës I, me përqindje | 59 |
| *Figura 33* | Numri i ankesave të vlerësuara nga Komisioni Mjekësor i Shkallës II, 2019 | 60 |
| *Figura 34* | Ankesat e vlerësuara nga Komisioni Mjekësor i Shkallës II, me përqindje | 60 |
| *Figura 35* | Numri i familjeve të përfshira në SNS, 2019 | 68 |
| *Figura 36* | Numri i anëtarëve të familjeve të përfshirë në SNS, 2019 | 68 |
| *Figura 37* | Pagesat e ndihmës sociale sipas muajve, 2019 | 69 |
| *Figura 38* | Numri i familjeve në SNS, sipas komunave/QPS-ve, dhjetor 2019 | 70 |
| *Figura 39* | Familjet në SNS sipas numrit të anëtarëve të familjes, 2019 | 71 |
| *Figura 40* | Përqindja e familjeve në SNS sipas kategorive, dhjetor 2019 | 72 |
| *Figura 41* | Bartësit e ndihmës sociale sipas kategorive dhe strukturës, dhjetor 2019 | 73 |
| *Figura 42* | Struktura nacionale e familjeve në SNS, dhjetor 2019 | 75 |
| *Figura 43* | Struktura nacionale e anëtarëve të familjeve në SNS, dhjetor 2019 | 76 |
| *Figura 44* | Numri i anëtarëve të familjes sipas kategorive dhe strukturës gjinore, dhjetor 2019 | 77 |
| *Figura 45* | Anëtarët e familjes në SNS me përqindje sipas grupmoshave, dhjetor 2019 | 78 |
| *Figura 46* | Numri i kërkesave të vlerësuara nga Komisioni Mjekësor i Shkallës I, 2019 | 83 |
| *Figura 47* | Numri i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni i Ankesave i Shkallës II, 2019 | 85 |
| *Figura 48* | Numri i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni Mjekësor i Shkallës II, 2019 | 86 |
| *Figura 49* | Kontestet administrative të proceduara në Gjykatën Themelore, 2019 | 87 |
| *Figura 50* | Numri i lëndëve të kompletuara dhe jo të kompletuara sipas QPS-ve | 89 |
| *Figura 51* | Numri i familjeve të përzgjedhshme dhe të papërzgjedhshme sipas QPS-ve, 2019 | 90 |
| *Figura 52* | Numri i /familjeve që kanë përfituar ndihmë sociale pa bazë ligjore pas krahasimit me ATK, 2019 | 92 |
| *Figura 53* | Numri i kërkesave për ndihmë të njëhershme, aprovim dhe refuzim, 2019 | 94 |
| *Figura 54* | Numri i kërkesave të shqyrtuara për pëlqim/autorizim sipas QPS-ve, 2019 | 97 |
| *Figura 55* | Shuma e mjeteve të procesuara, të shpërndara dhe të kthyera, 2019 | 99 |
| *Figura 56* | Familjet e subvencionuara sipas skemave, me përqindje, 2018 | 102 |
| *Figura 57* | Familjet e subvencionuara sipas skemave, me përqindje, 2018 | 112 |
| *Figura 58* | OJQ-të e licencuara sipas nivelit ku i ofrojnë shërbimet, 2019 | 113 |
| *Figura 59* | *Përqindja e numrit të kërkesva të shqyrtuara të nivelit superior, 2019* | 121 |
| *Figura 60* | Përqindja e ofruesve të nivelit superior të licencuar dhe rilicencuar, 2019 | 122 |
| *Figura 61* | Numri i ofruesve të licencuar dhe rilicencuar sipas gjinisë, 2019 | 123 |
| *Figura 62* | Përqindja e ofruesve të licencuar/rilicencuar sipas gjinisë, 2019 | 123 |
| *Figura 63* | Numri i kërkesave të shqyrtuara të nivelit bazik, të mesëm dhe të lartë me përqindje, 2019 | 124 |
| *Figura 64* | Ofruesit e shërbimeve të licencuar dhe rilicencuar, me përqindje, 2019 | 125 |

| | | |
|---|---|---|
| *Figura 65* | Numri i ofruesve të licencuar dhe rilicencuar sipas gjinisë, 2019 | 126 |
| *Figura 66* | Ofruesit e licencuar/rilicencuar sipas gjinisë, 2019 | 126 |
| *Figura 67* | Numri i ankesave të shqyrtuara me përqindje, 2019 | 127 |
| *Figura 68* | Përqindja e ankesave të shqyrtuara të nivelit superior sipas sektorëve, 2019 | 128 |
| *Figura 69* | Ankesat e shqyrtuara të nivelit bazik,të mesëm, të lartë sipas sektorëve, 2019 | 129 |
| *Figura 70* | Ankesat e shqyrtuara të nivelit bazik, të mesëm dhe të lartë me përqindja sipas gjinisë, 2019 | 130 |


## Lista e tabelave:


| | | |
|---|---|---|
| *Tabela 1* | Numri i viktimave të dhunës në familje të strehuara në strehimore, 2019 | 40 |
| *Tabela 2* | Numri i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, 2019 | 43 |
| *Tabela 3* | Struktura gjinore dhe nacionale e klientëve në SHPMPF, Prishtinë, dhjetor 2019 | 52 |
| *Tabela 4* | Struktura gjinore dhe nacionale e klientëve në ISSH - Shtime, dhjetor 2019 | 53 |
| *Tabela 5* | Struktura gjinore dhe nacionale e klientëve në Shtëpinë e Fëmijëve - Shtime, dhjetor 2019 | 54 |
| *Tabela 6* | Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së, 2019 | 56 |
| *Tabela 7* | Numri i fëmijëve sipas vijueshmërisë së procesit mësimor, 2019 | 58 |
| *Tabela 8* | Numri i familjeve-anëtarëve të familjes të përfshirë në SNS, 2019 | 67 |
| *Tabela 9* | Familjet në SNS, sipas numrit të anëtarëve të familjes, dhjetor 2019 | 71 |
| *Tabela 10* | Bartësit e ndihmës sociale sipas kategorive dhe strukturës gjinore, dhjetor 2019 | 72 |
| *Tabela 11* | Bartësit e ndihmës sociale sipas statusit, dhjetor 2019 | 73 |
| *Tabela 12* | Struktura nacionale e familjeve në SNS, dhjetor 2019 | 74 |
| *Tabela 13* | Anëtarët e familjeve në SNS, sipas kategorive dhe strukturës gjinore | 76 |
| *Tabela 14* | Numri dhe përqindja e anëtarëve të familjes në SNS sipas grup-moshave, dhjetor 2019 | 77 |
| *Tabela 15* | Familjet në SNS sipas numrit të anëtarëve, pikëve dhe shumës mujore, dhjetor 2019 | 79 |
| *Tabela 16* | Shuma dhe mesatarja e ndihmës sociale sipas numrit të anëtarëve të familjes (2003, 2009, 2012, 201! dhe 2019) | 80 |
| *Tabela 17* | Numri i kërkesave të vlerësuara nga Komisioni Mjekësor i Shkallës I, 2019 | 82 |
| *Tabela 18* | Numri i ankesave, vlerësimeve në Shkallën II dhe kontestet administrative, 2019 | 82 |
| *Tabela 19* | Numri i Qendrave për Punë Sociale të kontrolluara nga Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes, 2019 | 88 |
| *Tabela 20* | Numri i lëndëve të verifikuara me ATK, 2019 | 91 |
| *Tabela 21* | Ndihmat e njëhershme-emergjente, 2019 | 94 |
| *Tabela 22* | Numri i kërkesave të shqyrtuara për pëlqim/autorizim sipas QPS-ve, 2019 | 96 |
| *Tabela 23* | Procedimi, shpërndarja, barazimi dhe kthimi i mjeteve nga BpB në buxhetin e MPMS-së, 2019 | 98 |
| *Tabela 24* | Buxheti i SNS-së dhe shpërndarja e e ndihmave sociale sipas muajve, 2019 | 100 |
| *Tabela 25* | Subvencionimi i energjisë elektrike për familjet në SNS, FDIL për vitin 2018 | 101 |

| | | |
|---|---|---|
| *Tabela 26* | Numri i përfituesve të skemës së FDIL-së sipas kategorive, dhjetor 2019 | 108 |
| *Tabela 27* | Institucionet publike dhe Organizatat Joqeveritare të inspektuara, 2019 | 114 |
| *Tabela 28* | Numri i hulumtimeve të realizuara nga Departamenti i Politikave Sociale, 2019 | 116 |
| *Tabela 29* | Numri i takimeve të komisioneve të përhershme të Këshillit, 2019 | 120 |
| *Tabela 30* | Numri i kërkesave të shqyrtuara të nivelit superior, 2019 | 121 |
| *Tabela 31* | Numri i ofruesve të licencuar dhe rilicencuar sipas gjinisë, 2019 | 122 |
| *Tabela 32* | Numri i kërkesave të shqyrtuara të nivelit bazik, të mesëm dhe të lartë, 2019 | 124 |
| *Tabela 33* | Numri i ofruesve të licencuar dhe rilicencuar sipas gjinisë, 2019 | 125 |
| *Tabela 34* | Numri i ankesave të shqyrtuara sipas niveleve, 2019 | 127 |
| *Tabela 35* | Numri i ankesave të shqyrtuara të nivelit superior, 2019 | 128 |
| *Tabela 36* | Numri i ankesave të shqyrtuara të nivelit bazik, të mesëm dhe të lartë, 2019 | 129 |


## Lista e kutiave:


| | | |
|---|---|---|
| *Kutia 1* | Nocioni **“familje”** dhe **“bashkësi familjare”** sipas Ligjit të Skemës së Ndihmës Sociale | 65 |

# P Ë R M B A J T J A

ORGANOGRAMI I DPSF-së....12

1. PARATHËNIE....13
2. HYRJE....14
3. KUADRI LIGJOR....15
   - 3.1. Aktet ligjore të Shërbimeve Sociale....15
     - 3.1.1. Aktet nënligjore të Shërbimeve Sociale....15
   - 3.2. Aktet ligjore të Skemës së Ndihmës Sociale....16
     - 3.2.1. Aktet nënligjore të Skemës së Ndihmës Sociale....17
   - 3.3. Marrëveshjet e Mirëkuptimit/Bashkëpunimit....17
   - 3.4. Standardet minimale dhe specifikimi i shërbimeve sociale dhe familjare....18
4. DEPARTAMENTI PËR POLITIKA SOCIALE DHE I FAMILJES....19
   - 4.1. Detyrat dhe përgjegjësitë....19
   - 4.2. Struktura Organizative e Depatamentit (niveli qendror dhe lokal)....20
     - 4.2.1. Divizionet brenda Departamentit....20
     - 4.2.2. Institucionet në nivel qendror....21
     - 4.2.3. Institucionet në nivel lokal....21
     - 4.2.4. Trupat punuese....21
5. DIVIZIONI I SHËRBIMEVE SOCIALE....22
   - 5.1. Detyrat dhe përgjegjësitë....22
   - 5.2. Ofrimi i shërbimeve sociale....22
   - 5.3. Fëmijët pa kujdes prindëror dhe format e mbrojtjes sociale....23
     - 5.3.1. Fëmijët e braktisur....23
     - 5.3.2. Kujdestaria....25
     - 5.3.3. Bashkimi familjar....26
     - 5.3.4 Strehimi familjar....26
     - 5.3.5. Adoptimi....31
     - 5.3.6. Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e të drejtës prindërore dhe të keqtrajtuar....32
     - 5.3.7. Fëmijët e abuzuar dhe të keqtrajtuar....33
   - 5.4. Fëmijët në konflikt me ligjin dhe fëmijët me sjellje asociale....34
   - 5.5. Riatdhesimi i fëmijëve të pashoqëruar....35
   - 5.6. Fëmijët në punë të rënda....36
   - 5.7. Dhuna në familje....38
     - 5.7.1. Struktura gjinore dhe mosha e viktimave të dhunës në familje....40
   - 5.8. Trafikimi me qenie njerëzore....41
     - 5.8.1. Strehimi dhe trajtimi i viktimave të trafikimit....41
     - 5.8.2. Numri i viktimave të trafikimit sipas moshës dhe gjinisë....43
     - 5.8.3. Numri i viktimave të trafikimit sipas vendit të prejardhjes....44
   - 5.9. Mbrojtja e viktimave të krimeve seksuale-fëmijë....45

5.10. Të miturit që hyjnë në martesë të parakohshme ........................................................................................45
5.11. Këshilla martesore..............................................................................................................................................46
5.12. Komisioni për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i Shkallës II ..........................................................46
5.13. Bashkëpunimi me Organizatat Jo Qerveritare................................................................................................46
5.14. Avancimi i Infrastrukturës Juridiko-profesionale ...........................................................................................47

6. DIVIZIONI PËR AFTËSINË E KUFIZUAR DHE PERSONAT E MOSHUAR.........................................................48
6.1. Detyrat dhe përgjegjësitë .......................................................................................................................................48
6.2. Aktivitet e realizuara nga Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar ..................................48
6.3. Numri i kërkesave të shqyrtuara për strehim institucional/rezidencial...........................................................50
6.3.1. Struktura gjinore dhe nacionale e klientëve në SHPMPF në Prishtinë .............................................51
6.3.2. Struktura gjinore dhe nacionale e klientëve në ISSH- Shtime...........................................................52
6.3.3. Struktura gjinore dhe nacionale e klientëve në Shtëpinë e Fëmijëve në Shtime................................53
6.4. Skema për Përkrahje Materiale për Familjet me Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme .................54
6.4.1. Numri i fëmijëvë përfitues në Skemën e FFAKP-së, sipas muajve .................................................55
6.4.2. Buxheti i shpenzuar për Skemën e FFAKP-së.....................................................................................56
6.4.6. Numri i fëmijëve në Skemën e FFAKP-së, sipas vijueshmërisë së procesit mësimor.........................56
6.5. Numri i kërkesave të shqyrtuara për paaftësi nga Komisioni i Shkallës I .......................................................57
6.6. Numri i kërkesave të shqrtuara për paaftësi nga Komisioni i Shkallës II .......................................................58

7. DIVIZIONI I NDIHMËS SOCIALE .................................................................................................................60
7.1. Detyrat dhe përgjegjësitë .......................................................................................................................................60
7.2. Struktura organizative e Skemës së Ndihmës Sociale.....................................................................................61
7.3. Delegimi (Dekoncentrimi) i Skemës së Ndihmës Sociale.................................................................................61
7.4. Përgjegjësitë e nivelit qendor- MPMS-së për Skemën e Ndihmës Sociale....................................................61
7.5. Përgjegjësitë e nivelit komunal për Skemën e Ndihmës Sociale....................................................................62
7.5.1. Administrimi i SNS-së në nivelin komunal...........................................................................................62
7.6. Kriteret dhe kushtet për përfitimin e ndihmës sociale .......................................................................................63
7.7. Numri i familjeve dhe anëtarëve të familjeve në SNS.......................................................................................65
7.7.1. Numri i familjeve dhe anëtarëve të familjes në SNS sipas komunave/QPS-ve .................................68
7.7.2. Familjet në SNS sipas numrit të anëtarëve të familjes........................................................................70
7.7.3. Bartësit e ndihmës sociale, sipas kategorive dhe strukturës gjinore.................................................71
7.7.4. Struktura e statusit të bartësve të ndihmës sociale në SNS...............................................................72
7.7.5. Struktura nacionale e familjeve në ndihmë sociale..............................................................................73
7.7.6. Anëtarët e familjeve në SNS, sipas kategorive dhe strukturës gjinore...............................................75
7.7.7. Anëtarët e familjeve në SNS, sipas grup-moshave..............................................................................76
7.8. Shuma mujore e ndihmës sociale.......................................................................................................................77
7.8.1. Rritja e shumës së ndihmës sociale-mesatarja për anëtarë dhe familje............................................79
7.9. Puna e Njësive-Komisioneve të Divizionit të Ndihmës Sociale........................................................................80
7.9.1. Komisioni Mjekësor i Shkallës I ...........................................................................................................80
7.10. Procesi dhe procedurat e ankimimit për ndihmë sociale..................................................................................82
7.10.1. Njësia/Komisioni i Ankesave i Shkallës II në DNS/DPSF.................................................................82

7.10.2. Komisioni Mjekësor i Shkallës II për paaftësi për punë........................................................................84
7.10.3. Kontestet administrative.......................................................................................................................85
7.11. Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes për Skemën e Ndihmës Sociale................................................86
7.12. Krahasimi i të dhënave me Administratën Tatimore të Kosovës........................................................89
7.13. Ndihmat e Njëhershme-Emergjente.......................................................................................................92
7.14. Pëlqimet për autorizim për tërheqjen e ndihmës sociale .....................................................................94
7.15. Buxheti i Skemës së Ndihmës Sociale, procedimi, shpërndarja, barazimi, kthimi i mjeteve dhe provizioni bankar për operatorët ekonomik.........................................................................................................97
7.15.1. Shpërndarja e ndihmave sociale...........................................................................................................98
7.16. Subvencionimi i energjisë elektrike për vitin 2018..................................................................................99
7.17. Baza e të Dhënave (TI) për Skemën e Ndihmës Sociale......................................................................101

**8. DIVIZIONI PËR PLANIFIKIM DHE PËRFSHIRJE SOCIALE ...........................................................................103**

8.1. Detyrat dhe përgjegjësitë ..........................................................................................................................103
8.2. Planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit për vitin 2019..................................................................................103
8.3. Përfshirja sociale.........................................................................................................................................104
8.4. Përjashtimi social..........................................................................................................................................109
8.5. Licencimi i Organizatave Jo Qeveritare......................................................................................................110
8.6. Njësia për Monitorim dhe Inspektim...........................................................................................................112

**9. DIVIZIONI I POLITIKAVE SOCIALE.................................................................................................................114**

9.1. Detyrat dhe përgjegjësitë ..........................................................................................................................114
9.2. Përgatitja e hulumtimeve për publikim .....................................................................................................114

**10. DIVIZIONI PËR MBËSHTETJE ADMINISTRATIVE I KPSHSF-së.........................................................................116**

9.1. Detyrat dhe përgjegjësitë...........................................................................................................................116

**11. KËSHILLI I PËRGJITHSHËM PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE..........................................................117**

11.1. Detyrat dhe përgjegjësitë ..........................................................................................................................117
11.2. Përbërja e Këshillit.......................................................................................................................................118
11.3. Aktivitetet e realizuara................................................................................................................................118
11.3.1. Takimet e rregullta të Këshillit të mbajtura gjatë vitit 2019..................................................................118
11.3.2. Takimet e komisioneve të përhershme të mbajtura gjatë vitit 2019......................................................119
11.4. Komisioni për licencim: niveli superior.......................................................................................................119
11.4.1. Numri i kërkesave të shqyrtuara..............................................................................................................119
11.4.2. Numri i ofruesve të licencuar dhe rilicencuar, 2019.................................................................................120
11.4.3. Numri i ofruesve të licencuar dhe të rilicencuar sipas gjinisë.................................................................121
11.5. Komisioni për licencim: niveli bazik, i mesëm dhe i lartë..........................................................................122
11.5.1. Numri i kërkesave të shqyrtuara gjatë vitit 2019......................................................................................122
11.5.2. Numri i ofruesve të licencuar dhe të rilicencuara, 2019..........................................................................123
11.5.3. Numri i ofruesve të licencuar dhe rilicencuar, sipas gjinisë....................................................................124
11.6. Komisioni i Ankesave....................................................................................................................................125
11.6.1. Numri i ankesave të shqyrtuara gjatë vitit 2019 .......................................................................................125

11.6.2. Numri i ankesave të shqyrtuara, niveli superior....126
11.6.3. Numri i ankesave të shqyrtuara, niveli bazik, i mesëm dhe i lartë....127
11.7. Bashkëpunimi me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë....129

**12. TË ARRITURAT KRYESORE TË DEPARTAMENTIT GJATË VITIT 2019....130**

12.1. Zbatimi i përfitimve dhe kopmpensimeve nga Skemat që menaxhohen nga DPSF-ja....130
12.2. Zbatimi i programit të subvencionimit për energji MPMS/DPSF....130
12.3. Zbatimi i programit për mbështetje financiare të OJQ-ve të licencuara....131
12.4. Shërbimet sociale dhe familjare....131
12.5. Strehimi rezidencial i personave të moshuar pa përkujdesje familjare, fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor....132
12.6. Strehimi rezidencial i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore....132
12.7. Licencimi i ofruesve individual dhe i subjekteve juridike (OJQ-ve)....132
12.8. Ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi i ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare....133

**PËMBLEDHJE ME TË DHËNA TË PËRGJITHSHME....134**

## ORGANOGRAMI I DPSF-së



# PARATHËNIE

Bazuar në Planin Vjetor të Punës, Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes (DPSF), publikon raportin vjetor të punës për vitin 2019, të quajtur "Mirëqenia Sociale 2019".

Publikimi "Mirëqenia Sociale 2019", është përmbledhje e aktiviteteve nga fusha e shërbimeve sociale dhe e ndihmës sociale të realizuara gjatë vitit 2019. Në këtë publikim gjenden informacione të rëndësishme lidhur me mbrojtjen e fëmijëve, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, personat e moshuar pa përkujedesje familjare, personat e rritur me aftësi të kufizuar mendore/ngecje në zhvilim mendor, për fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme, individë dhe familje përfitues të ndihmës sociale, për procesin e licencimit të Organizatave Jo-Qeveritare, të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare etj.

Shpresoj që të dhënat e prezentuara në këtë publikim të mund të përdoren dhe t'u shërbejnë të gjithë akterëve individual dhe institucional që kanë të bëjnë me fushën e mirëqenies sociale.

Në fund faleminderoj të gjitha institucionet në nivelin qëndror dhe lokal për punën dhe bashkëpunimin profesional me DPSF-në gjatë vitit 2019 dhe të gjithë stafin e DPSF-së që ndihmuan në përgatitjen e këtij raporti duke ofruar të dhënat sipas fushës që mbulojnë.

Mentor Morina ______________

Drejtor i DPSF

## 2. HYRJE

Departamenti i Politikave Sociale dhe i Familjes (DPSF) funksionon në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqeniës Sociale. Mision të vetin ka angazhimin në zhvillimin e legjislacionit të ri, vendosjen e standardeve të duhura për shërbimet dhe mbrojtjen sociale, mbështetjen e gjerë dhe të qëndrueshme financiare të grupeve në nevojë, duke përfshirë kriteret legjitime dhe transparente. Gjithashtu, DPSF, siguron që politikat për mirëqenien sociale të prezantohen në bazë të të dhënave mbi varfërinë në Kosovë dhe që politikat buxhetore për rritjen e mirëqeniës sociale të jenë kompatibile me mundësitë buxhetore.

Në këtë raport pasqyrohen aktivitetet kryesore të realizuara nga DPSF gjatë vitit 2019, aktivitete të cilat janë realizuar konform Planit Vjetor të Punës për vitin 2019, objektivave strategjike dhe specifike të fushës së politikave sociale dhe familjare.

Pasqyrimi i aktiviteteve kryesore të realizuara nga DPSF gjatë vitit 2019 është bërë sipas Divizioneve që veprojnë në kuadër të tij, duke filluar nga: Divizioni i Shërbimeve Sociale (DSHS), Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar (DAKPM), Divizioni i Ndihmës Sociale (DNS), Divizioni për Planifikim dhe Përfshirje Sociale (DPPS), Divizioni i Politikave Sociale (DPS), Divizioni për Mbështetje Administrative i KPSHSF-së, Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare (KPSHSF).

Për hartimin e raportit janë shfrytëzuar raportet vjetore të Divizioneve si dhe të dhënat e Bazës së Shërbimeve Sociale e veçanërisht janë shfrytëzuar të dhënat e Bazës së të Dhënave të Skemës së Ndihmës Sociale, me qëllim që të dhënat e prezentuara të jenë gjithëpërfshirëse, të sakta dhe të qarta.

Në fund, për kontributin në hartimin e këtij raporti falenderojë në mënyrë të veçantë, z. Mentor Morina, Udhëheqës i DPSF-së, Udhëheqësitë e Divizioneve, Menaxherin e Bazës së të Dhënave të Shërbimeve Sociale, Menaxherin e Bazës së të Dhënave të Skemës së Ndihmës Sociale, zyrtarët përgjegjës të fushave përkatëse, QPS-të, Institutin Special në Shtime, Shtëpinë e Personave të Moshuar Papërkujdesje Familjare në Prishtinë etj.

# 3. KUADRI LIGJOR

## 3.1. Aktet ligjore të Shërbimeve Sociale

1. Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare;
2. Ligji Nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare;
3. Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës;
4. Kodi Nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur;
5. Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;
6. Ligji Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit;
7. Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

### 3.1.1. Aktet nënligjore të shërbimeve sociale

1. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2010 për Procedurat për Delegimin e Përgjegjësive në Nivel Lokal për Shërbime Sociale në Kosovë;
2. Rregullore për Punën e Panelit për Vendosjen e Fëmijëve pa Kujdes Prindëror në Strehim Familjar dhe Adoptim (Birësim);
3. Udhëzimi Administrativ Nr.12/2012 për Përbërjen dhe Funksionimin e Panelit për Vendosjen e Fëmijëve pa Kujdes Prindëror në Strehim Familjar dhe Adoptim;
4. Udhëzimi Administrativ (MPMS) për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.12/2012 për Përkrahje dhe Funksionimin e Panelit për Vendosjen e Fëmijëve pa Kujdes Prindëror në Strehimin Familjar dhe Adoptim;
5. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.09/2014 për Rregullimin e Procedurave të Adoptimit për Fëmijët pa Përkujdesje Prindërore;
6. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 01/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.12/2012 për Përbërjen dhe Funksionimin e Panelit për Vendosjen e Fëmijëve pa Kujdes Prindëror në Strehim Familjar dhe Adoptim;
7. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2016 për Rregullimin e Strehimit Familjar në Kosovë;
8. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.08/2017 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2016 për Rregullimin e Strehimit Familjar në Kosovë;
9. Udhëzimi Administrativ Nr.13/2010 për Ofrimin e Shërbimeve në Komunitet - për Persona me Aftësi të Kufizuara, Ngecje Mendore në Zhvillimin Mendor;
10. Udhëzimi Administrativ Nr.10/2010 për Ofrimin e Shërbimeve në Komunitet - Shtëpi për Persona të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare;
11. Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2011 për Punën dhe Kriteret e Vendosjes së Rezidenteve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitetet;
12. Udhëzimi Administrativ Nr.10/2014 për Punën dhe Kriteret për Vendosjes së Rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet;
13. Udhëzimi Administrativ Nr.06/2011 për Punën dhe Vendosjen e Rezidentëve, Personave me Aftësi të Zvogëluar Mendore - Ngecje në Zhvillimin Mendor në Institutin Special në Shtime, dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet;

14. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.11/2014 për Punën dhe Kriteret për Vendosjen e Rezidentëve, Personave me Aftësi të Kufizuar mendore-Ngecje në Zhvillim Mendor në Institutin Special në Shtime dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet;
15. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.03/2009 për Rregullimin dhe Përcaktimin e Procedurave të Aplikimit për Realizimin e të Drejtës në Ndihmë Materiale për Familjet me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përhershme;
16. Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2010 Për Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.03/2009 për Rregullimin dhe Përcaktimin e Procedurave të Aplikimit për Realizimin e të Drejtës në Ndihmë Materiale për Familjet me Fëmijë me Aftësi të Kufizuar të Përhershme;
17. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.06/2014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.07/2010 për Rregullimin dhe Përcaktimin e Procedurave të Aplikimit për Realizimin e të Drejtës në Ndihmë Materiale për Familjet me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përhershme;
18. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.02/2014 për Ofrimin dhe Sigurimin e Përkrahjes Financiare të OJQ-ve Vendore Gjatë Vitit 2014;
19. Udhëzimi Administrativ(MPMS) Nr.17/2013 për Licencimin e Subjekteve Juridike/Organizatave që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare;
20. Udhëzimi Administrativ Nr.14/2013 për Monitorimin dhe Inspektimin e Subjekteve Juridike/Organizatave që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare;
21. Rregullore e Punës Nr.999 të Njësisë për Monitorim /Inspektim të Shërbimeve Sociale dhe Familjare;
22. Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2012 për Ofrimin e Sigurimin e Përkrahjes Financiare të OJQ-ve Vendore Gjatë Vitit 2012;
23. Udhëzimi Administrativ Nr.11/2012 për Ndryshimin dhe Plotësimin e UA Nr.02/2012 për Ofrimin dhe Sigurimin e Përkrahjes Financiare të OJQ-ve Vendore gjatë vitit 2012;
24. Udhëzim administrative (MPMS) Nr.08/2013 për Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale pa Përgjegjësi Penale dhe Atyre me Sjellje Asociale;
25. Rregullorja nr. 352/2014 e Punës së Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare;
26. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2015 për Financimin e Aktiviteteve të Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Kompensimet e Anëtareve të tij;
27. Udhëzimi Administrativ Nr.13/2013 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale dhe Familjare në Nivel Bazik dhe të Mesëm;
28. Udhëzimit Administrativ Nr.10/2012 për Organizimin, Fushëveprimin dhe Funksionimin e Këshillit të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale dhe Familjare;
29. Udhëzimi Administrativ (MPMS)Nr.06/2017 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr.10/2010 për Organizimin, Fushëveprimin dhe Funksionimin e Këshillit për Shërbime Sociale dhe Familjare;
30. Udhëzimi Administrativ Nr.04/2012 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale dhe Familjare;
31. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.20/2015 për Financimin e Aktiviteteve të Këshillit për Shërbimet Sociale dhe Familjare (KPSHSF) dhe kompensimet e Anëtareve të Tij;
32. Rregullore Nr. 01/2016 për Funksionin e Punës në Strehimore për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave me Qenie Njerëzore në Nivel të Mesëm dhe të Lartë të Rrezikshmërisë;

## 3.2. Aktet ligjore të Skemës së Ndihmës Sociale

1. Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë.
2. Ligji Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë.

### 3.2.1. Aktet nënligjore të Skemës së Ndihmës Sociale

1. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2010 për Procedurat për Delegimin e Përgjegjësive në Nivel Lokal për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë;
2. Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2013 për Procedurat e Paraqitjes së Kërkesave për Ndihmë Sociale;
3. Udhëzimi Administrativ Nr.16/2013 për Përcaktimin e Kushteve dhe Kritereve për Realizimin e Ndihmave Sociale për të Huajt në Republikën e Kosovës;
4. Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2010 për Procedurat Administrative të Kthimit të Pagesave nga Shfrytëzuesit e Skemës së Ndihmës Sociale të Fituara Pa Bazë Ligjore;
5. Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.08/2010 për Procedurat Administrative të Kthimit të Pagesave nga Shfrytëzuesit e Skemës së Ndihmës Sociale të Fituara Pa Bazë Ligjore;
6. Udhëzimi Administrativ Nr. 11 /2013, për Procedurat e Punës së Komisionit Mjekësor për Aplikuesit për Ndihmë Sociale në Kategorinë e Parë;
7. Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2007 për Themelimin dhe Funksionimin e Komisionit të Ankesave në Shkallës II, lidhur me Ndihmat Sociale.
8. Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2013 për Përcaktimin e Procedurave për Pagesat e Ndihmave të Njëhershme;
9. Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2013 për Procedurat e Regjistrimit, Certifikimit dhe Kërkimit Aktiv të Punësimit për të Papunësuarit që Aplikojnë për Skemën e Ndihmës Sociale;
10. Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2013 për Përllogaritjen e të Mirave Materiale dhe jo Materiale si dhe të Hyrave të Llogaritshme dhe jo të Llogaritshme;
11. Udhëzimi Administrativ Nr. 11/2013 për Procedurat e Punës së Komisionit Mjekësor për Aplikuesit për Ndihmë Sociale në Kategorinë e Parë;
12. Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2012 për Përllogaritjen e Shumës Mujore të Ndihmës Sociale.

## 3.3. Marrëveshjet e Mirëkuptimit/Bashkëpunimit

1. Marrëveshja e Mirëkuptimit për bartjen e kompetencave të shërbimeve sociale dhe delegimin e përgjegjësive të ndihmave sociale në nivel komunal ( 2009 për QPS-të dhe 2016 për Shtëpitë në Komunitet);
2. Marrëveshje e Mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe MPMS-së për transfer të përgjegjësive dhe menaxhimin e Strehimores për mbrojtën e viktimave të trafikimit në Lipjan (2011);
3. Marrëveshje Mirëkuptimi Nr. 252 e datës 14.04.2014, në mes të MPB-së dhe MPMS-së për menaxhimin dhe zbatimin e Programit të Riintegrimit të personave të riatdhesuar;
4. Marrëveshja e Bashkëpunimit Nr. 39 datë 28.01.2019 në mes MPMS -PK.SH.A- BPB për shpërndarjen e ndihmave sociale (2019-2021);
5. Marrëveshje Bashkëpunimi Nr. 231 e datës 03.05.2019, në mes të MPMS-KEDS-KESCO për subvencionimin e energjisë elektrike të kategorive sociale të shpenzuar gjatë vitit 2018;
6. Marrëveshje Bashkëpunimi Nr.102 e datës 28.02.2019, në mes të MPMS-së dhe OJQ-së "World Vision" (2019-2020);
7. Marrëveshje Bashkëpunimi Nr. 398 e datës 10.09.2019, në mes të MPMS-së dhe OJQ-së "Fëmijët pa kujdes prindëror" (2019-2020);
8. Marrëveshje Bashkëpunimi Nr. 554 e datës 05.12.2019 në mes të MPMS-së dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve (2019-2021);

9. Marrëveshje Bashkëpunimi Nr. 578 e datës 30.12.2019 në mes të MPMS-së dhe Fondacionit “Terre des Hommes” (2020-2021);
10. Marrëveshje Bashkëpunimi Nr.102 e datës 28.02.2019 në mes të MPMS-së dhe OJQ-së “World Vision” (2019-2020);
11. Marrëveshje Bashkëpunimi Nr. 3980 e datës 16.09.2019 ne mes të MPMS-së dhe Organizatës për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP;
12. Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të MPMS-së dhe ATK-së, datë 21.01.2019;
13. Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të MPMS-së dhe KEDS-it, datë 03.05.2019;
14. Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të MPMS-së dhe MBPZHR-së, datë 08.01.2019;
15. Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të MPMS-së dhe ARBK-së, datë 30.07.2019;
16. Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të MPMS-së dhe FSSH-së, datë 21.01.2019;
17. Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të MPMS-së dhe MPB/ARC, datë 10.10.2019;
18. Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të MPMS-së dhe BpB/PKSH.A/NLB, datë 28.01.2019.

## 3.4. Standardet minimale dhe specifikimi i shërbimeve sociale të aprovuara

1. Dhuna në familje/Fëmijët dhe të rriturit;
2. Fëmijët në forma të rënda të punës;
3. Adoptimi i fëmijëve pa përkujdesje prindërore;
4. Besimi i fëmijëve në familjet e prindërve të shkurorëzuar dhe të ndarë;
5. Përkujdesja institucionale për personat e moshuar;
6. Kujdestaria;
7. Ribashkimi familjar;
8. Fëmijët me sjellje asociale/fëmijët kryerës të veprave penale pa përgjegjësi penale;
9. Fëmijët e keqtrajtuar/të lënë pas dore;
10. Fëmijët me aftësi të kufizuara;
11. Shërbimi për fëmijët në konflikt me ligjin me përgjegjësi penale;
12. Shërbimi për viktimat e trafikimit me njerëz;
13. Shërbimi për fëmijët përdorues te substancave psiko-aktive;
14. Shërbimi për fëmijët e strehuar në familje me lidhje farefisnore;
15. Shërbimi për fëmijët në strehim familjar dhe familjet strehuese;
16. Standardet minimale të cilësisë së shërbimeve sociale për fëmijët viktima të krimeve seksuale;
17. Standardet minimale të cilësisë së shërbimeve sociale për të miturit që hyjnë në martesë;
18. Standardet minimale të cilësisë së shërbimeve sociale në shtëpi për personat e moshuar;
19. Standardet minimale të cilësisë së shërbimeve sociale në shtëpi për personat ma aftësi të kufizuara;
20. Korniza e Shërbimeve dhe Korniza e Standardeve minimale të cilësisë për persona të moshuar në Shtëpi të Komunitetit;
21. Standardet minimale të cilësisë së shërbimeve sociale në shtëpi rezidenciale për persona me aftësi të kufizuara intelektuale (fëmije dhe të rritur);
22. Korniza e shërbimeve dhe standardet minimale të cilësisë së shërbimeve sociale për fëmijë me aftësi të kufizuara në Qendrat e Kujdesit Ditor.

# 4. DEPARTAMENTI I POLITIKAVE SOCIALE DHE FAMILJARE

## 4.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes vepron në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Politika Sociale dhe i Familjes janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe me Ligjin Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Bazuar në legjislacionin e cekur më lartë përgjegjësitë e DPSF-së janë:

- ✓ *Bashkëpunon me komunat, rrethet akademike, ministritë e tjera dhe me palët e interesuara për ruajtjen e nivelit dhe përparimin e shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Ofron propozime, sugjerime dhe këshilla për Ministrinë dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës në lidhje me zhvillimin e politikave që kanë të bëjnë me shërbimet sociale dhe familjare;*
- ✓ *Përgatit udhëzime administrative, urdhëresa dhe udhëzime në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Nxjerr udhëzime në lidhje me standardet e nivelit të shërbimeve që duhet të plotësohen nga ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Licencon OJQ-të të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare;*
- ✓ *Zhvillon inspektime të shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Shqyrton raportet vjetore të drejtorive përkatëse komunale dhe miraton planet vjetore të punës së tyre;*
- ✓ *Miraton themelimin e objekteve rezidenciale për përkujdesje nga ana e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Merr përgjegjësinë e menaxhimit të drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare në rastet kur komuna dështon në vazhdimësi dhe në mënyrë serioze, që të plotësojë standardet e pranueshme për kryerjen e shërbimeve;*
- ✓ *Jep udhëzime në lidhje me parashtrimin e kërkesave për urdhër kujdestarie para gjykatave, të cilat kanë të bëjnë me fëmijët dhe të rriturit e rrezikuar;*
- ✓ *Në raste të veçanta, bën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të rasteve të shërbimeve sociale dhe familjare;*

- ✓ *Themelon dhe koordinon panelin për vendosjen e fëmijëve në strehim familjar, ose zhvillimin e procedurës së ankesave në lidhje me shërbimet sociale dhe familjare;*
- ✓ *Bën hulumtime në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, nxit ngritjen profesionale të kuadrit nëpërmjet trajnimit dhe ofrimit të këshillimit për profesionistët;*
- ✓ *Publikon doracakë përkatës, raporte për rezultatet e kërkimeve dhe materiale promovuese.*
- ✓ *Inspekton komisionimin e shërbimeve sociale dhe familjare në institucionet e përcaktuara me ligj, si dhe në organizatat joqeveritare dhe në sektorin privat. Në lidhje me këto aktivitete përpilon një raport vjetor me shkrim.*

Udhëheqësi i Departamentit për Politika Sociale dhe i Familjes, raporton tek Sekretari i Përgjithshëm i MPMS-së.

## 4.2. Struktura Organizative e Departamentit (niveli qendror dhe niveli lokal)

Në kuadër të Departamentit të Politikave Sociale dhe të Familjes veprojnë gjashtë (6) divizione, të cilat janë:

1. Divizioni i Shërbimeve Sociale (10 punëtorë);
2. Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar (5 punëtorë);
3. Divizioni i Ndihmës Sociale (11 punëtorë);
4. Divizioni për Planifikim dhe Përfshirje Sociale (8 punëtorë);
5. Divizioni i Politikave Sociale (10 punëtorë);
6. Divizioni për Mbështetje Administrative i KPSHSF-së (2 punëtorë).

### 4.2.1. Institucionet në nivel qendror

Departamenti është përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin edhe të katër (4) institucioneve të karakterit nacional, të cilat ofrojnë shërbime njëzetë e katër orë (24 orë) për personat e moshuar pa përkujdesje familjare, fëmijët e braktisur dhe me aftësi të kufizuara dhe personat e rritur, po ashtu me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor, si dhe viktimat e trafikimit me qenie njerëzore. Këto institucione janë:

1. Instituti Special në Shtime (70 punëtorë);
2. Shtëpia e Personave të Moshuar në Prishtinë (60 punëtorë);
3. Shtëpia e Komunitetit për Fëmijë në Shtime (10 punëtorë);
4. Strehimorja për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit në Lipjan (11 punëtorë).

### 4.2.2. Institucionet në nivel lokal

Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes, po ashtu, është përgjegjës të monitorojë, koordinojë dhe të ketë një bashkëpunim të ngushtë me institucionet e nivelit lokal të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për familje/individë në nevojë sociale, ndihmë sociale dhe shërbime të kujdesit për personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuar (fëmijë dhe të rritur) në komunitet.

Institucionet të cilat janë nën përgjegjësi të komunave si rezultat i procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale në vitin 2009 dhe 2016, kanë kaluar me kompetenca në nivel të përgjegjësive komunale, ndërsa MPMS-ja kujdeset për sigurimin dhe krijimin e qëndrueshëm të financimit të tyre. Institucionet të cilat zbatojnë legjislacionin, politikat, standardet e DPSF/MPMS dhe ofrojnë shërbimet për qytetarët në nivel lokal janë:

1. Qendrat për Punë Sociale (40 QPS në 38 komuna);
2. Shtëpitë e Komunitetit për Personat me Aftësi të Kufizuar (12 shtëpi në 12 komuna);
3. Shtëpitë e Komunitetit për Personat e Moshuar (4 shtëpi në 4 komuna).

### 4.2.3. Trupat punues

1. Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare;
2. Paneli për Vendosjen e Fëmijëve në Strehim dhe Adoptim;
3. Komiteti Nacional për Eliminimin e Punëve të Rënda;
4. Njësia për Inspektimin/Monitorimin e Shërbimeve Sociale;
5. Njësia e Kontrollit dhe e Mbikëqyrjes për Skemën e Ndihmës Sociale.

# 5. DIVIZIONI I SHËRBIMEVE SOCIALE

## 5.1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Shërbimeve Sociale

Divizioni i Shërbimeve Sociale (DSHS), vepron në kuadër të Departamentit për Politika Sociale dhe i Familjes në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Shërbimeve Sociale, janë:

- ✓ *Sigurimi i funksionimit të shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Propozimi, hartimi dhe monitorimi i zbatimit të standardeve dhe procedurave për shërbime sociale, në harmoni me standardet e BE-së;*
- ✓ *Propozimi, hartimi dhe sigurimi i zbatimit të legjislacionit për shërbime sociale në harmoni me standardet e BE-së;*
- ✓ *Koordinimi i aktiviteteve me institucionet relevante;*
- ✓ *Monitorimi i punës së shërbimeve sociale në Qendra për Punë Sociale;*
- ✓ *Bashkëpunimi me organizatat jo qeveritare në fushën e shërbimeve sociale;*
- ✓ *Propozimi dhe hartimi i programe për ngritjen e aftësive profesionale të zyrtarëve të shërbimeve sociale.*

Udhëheqësi i Divizionit për Shërbime Sociale raporton tek Udhëheqësi i Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare.

## 5.2. Ofrimi i shërbimeve sociale

Shërbimet sociale ofrohen kryesisht në nivel lokal. Komponentët kryesore të sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në nivel lokal përfshijnë: Drejtoritë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendrat për Punë Sociale (QPS), institucionet rezidenciale, si dhe rrjetin e OJQ-ve të zhvilluara për të mbështetur grupet e cenueshme. Gjithsej funksionojnë 40 QPS, të shpërndara nëpër 38 komuna të Republikës së Kosovës, të cilat sigurojnë mbulimin gjeografik të tërë vendit.

Numri i personave në gjendje të nevojës sociale dhe familjare, që kanë pranuar shërbime sociale gjatë vitit 2019, sipas kategorive dhe bazuar në politikat sociale të mbrojtjes dhe në legjislacionin në fuqi është paraqitur si më poshtë:

## 5.3. Fëmijët pa kujdes prindëror dhe format e mbrojtjes sociale

Fëmijë pa kujdes prindëror është ai fëmijë prindërit e të cilit nuk janë gjallë, janë të pa njohur, të zhdukur apo për ndonjë arsye tjetër nuk janë në gjendje që të kujdesen për fëmijët e tyre, për një periudhë kohe të përkohshme apo të përhershme.

Te kjo kategori hyjnë fëmijët e braktisur, potencial për braktisje dhe fëmijët pa përkujdesje prindërore për arsye të tjera, siç janë fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e të drejtës prindërore, fëmijët e abuzuar dhe të keqtrajtuar, etj. Mandatin për t'iu ofruar mbrojtje dhe shërbime sociale fëmijëve pa kujdes prindëror e ka Organi i Kujdestarisë, i cili vepron në kuadër të Qendrave për Punë Sociale. Ndërsa format e mbrojtjes sociale që iu ofrohen fëmijëve pa kujdes prindëror e të braktisur janë: *kujdestaria*, *bashkimi familjar*, *strehimi familjar (brenda farefisit dhe jashtë farefisit)*, *strehimi rezidencial (afatshkurtër dhe afatmesëm),* si dhe *adoptimi* si formë themelore dhe e përhershme e mbrojtjes sociale.

### 5.3.1. Fëmijët e braktisur

Bazuar në të dhënat e raportuara nga ana e Qendrave për Punë Sociale, gjatë vitit 2019, janë raportuar 26 raste të reja të fëmijëve të braktisur, të cilët janë paraqitur në figurën më poshtë:

*Figura 1: Rastet e reja të fëmijëve të braktisur, janar-dhjetor 2019*



Bazuar në figurën 1, del që QPS-ja e Ferizajt, prin me katër (4) fëmijë të braktisur, pastaj Qendra e Vushtrrisë dhe e Prishtinës me nga tre (3) fëmijë të braktisur, Qendra e Drenasit, e Mitrovicës, e Istogut dhe e Fushë Kosovës më nga dy (2) fëmijë të braktisur, ndërsa Qendra e Shtimes, Suharekës, Rahovecit, Kamenicës, Skenderajt, Pejës, Lipjanit dhe e Klinës me nga një (1) fëmijë të braktisur *Shih figurën 2:*

*Figura 2: Përqindja e fëmijëve të braktisur sipas gjinisë, 2019*




*Figura 3: Fëmijët e braktisur gjatë vitit 2019 dhe ata të bartur nga viti 2018, me përqindje*



Sipas figurës 2, nga 26 fëmijët e raportuar si të braktisur gjatë vitit 2019, konstatohet se dymbëdhjet (12) fëmijë apo 46% janë meshkuj ndërsa katërmbedhjetë (14) fëmijë apo 54% janë femra.

Në total, gjatë vitit 2019, kanë qenë nën përkujdesje institucionale gjashtëdhjetë (60) fëmijë të braktisur, nga të cilët njëzetë e gjashtë (26) apo 43% janë raste të reja dhe tridhjetë e katër (34) apo 57% janë raste të bartura nga viti 2018. Shih figurën 3:

Numri më i madh i rasteve të bartura është bërë nga strehimi familjarë alternativ, njezetë e katër (24) fëmijë, pastaj nga Shtëpia "Dielli", gjashtë (6) fëmijë, nga Klinika dy (2) fëmijë, një (1) fëmijë nga SOS Familja, SOS Fashatrat e Fëmijëve dhe një (1) fëmijë nga Shtëpia e Fëmijës në Shtime. Shih figurën më poshtë:

*Figura 4: Numri i fëmijëve të barktisur që janë bartur nga vitit 2018 në vitin 2019*




Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të braktisur të cilët kanë qenë përfitues të shërbimeve sociale dhe janë evidentuar gjatë vitit 2019, tetë (8) prej tyre janë fëmijë me nevoja të veçanta.

## 5.3.2. Kujdestaria

Kujdestaria është formë themelore e mbrojtjes sociale, e cila aplikohet dhe realizohet për çdo fëmijë pa përkujdesje prindërore. Kujdestarë ligjorë zakonisht caktohen persona në lidhje familjare, të cilët legjitimohen me Vendim të Qendrës për Punë Sociale dhe monitorohen nga QPS-të. Kujdestari ligjor mund të caktohet edhe nga Organi i Kujdestarisë i QPS-së. Mandati i Kujdestarit ligjor është i përcaktuar

në legjislacionin e aplikueshëm ku roli i tij është që të përfaqësojë fëmijën e të mbrojë të drejtat dhe interesat e tij deri në zgjidhjen e statusit ligjor përfundimtar për fëmijën që është nën përkujdesje.

Çdo fëmijë i evidentuar si fëmijë i braktisur dhe pa përkujdesje prindërore gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, ka përfituar nga kjo formë e mbrojtjes sociale. Gjatë vitit 2019, në kujdestari kanë qenë të vendosur 681 fëmijë pa përkujdesje prindërore.

### 5.3.2. Bashkimi familjar

Me qëllim të mbrojtjes së interesave të fëmijëve të braktisur dhe pa përkujdesje prindërore (të braktisur, të keqtrajtuar, të prindërve të penguar në ushtrimin e detyrës prindërore apo rasteve të tjera kur cenohet interesi dhe mirëqenie e fëmijës/ve, etj.), Qendrat për Punë Sociale edhe gjatë këtij viti i kanë dhënë prioritet krijimit të kushteve për kthimin e fëmijëve në familjet biologjike, apo bashkimit familjar.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, Qendrat për Punë Sociale kanë realizuar njëmbëdhjetë (11) raste të bashkimit familjar d.m.th është bërë bashkimi i fëmijëve të braktisur dhe pa përkujdesje prindërore me familjet biologjike.

### 5.3.4. Strehimi Familjar

Bazuar në legjislacionin në fuqi, Strehimi Familjar i fëmijëve të braktisur dhe pa përkujdesje prindërore, realizohet në dy forma të cilat janë: *Strehimi Familjar i Fëmijëve tek Farefisi* dhe *Strehimi Familjar i Fëmijëve në Familjet Alternative/Jashtë Farefisit.*

MPMS-ja vazhdon t'i mbështet financiarisht dy format e strehimit familjar, me pagesa të rregullta mujore, të cilat janë të rregulluar me Vendim të Ministrit të MPMS-së.

**Strehimi Familjar tek Farefisi -** është formë e mbrojtjes sociale, e cila iu ofrohet fëmijëve të braktisur e pa kujdes prindëror (fëmijëve të lënë pas dore, të keqtrajtuar, të prindërve të penguar në ushtrimin e detyrës prindërore, apo rasteve të tjera kur cenohet interesi dhe mirëqenia e fëmijës/ve), bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Familje strehuese nga farefisi konsiderohen të afërmit e fëmijës që në mënyrë vullnetare kanë pranuar mbikëqyrjen dhe strehimin e fëmijës/ve pa kujdes prindëror, prindërit e të cilëve përkohësisht apo në mënyrë të përhershme nuk janë në gjendje që të ushtrojnë detyrat e tyre prindërore.

Strehimi familjar tek farefisi është i rregulluar me aktet ligjore e nënligjore. Puna profesionale në këtë proces është legjitimuar nga QPS-të, kompetente me vendim, kontratë e mbikëqyrje profesionale. Pagesa e rregullt mujore e strehimit familjar tek farefisi, për një fëmijë është 100 euro. Pagesat e

strehimit familjar te farefisi realizohen përmes llogarive bankare dhe bëhen në emër të kujdestarëve strehues.

Bazuar në figurën e mëposhtme, konstatohet se në muajin janar kemi numrin më të madh të fëmijëve të vendosur në strehim familjar, në këtë muaj janë vendosur 531 fëmijë, pastaj vjen muaji qershor me 521 fëmijë, muaji maj me 520 fëmijë, e kështu me radhë. Ndërsa numri më i vogël i fëmijëve të vendosur në strehim familjar është evidentuar muajin nëntor, në këtë muaj janë vendosur 495 fëmijë.

Sipas figurës 5, muaji dhjetor 2019 është mbyllur me 496 fëmijë, ku shumica prej tyre janë vendosur në strehim familjar në vitet paraprake e që vazhdojnë të jenë aktiv deri sa ta arrijnë moshën 18 vjeç dhe do të paguhen sipas legjislacionit në fuqi.

*Figura 5: Numri i fëmijëve të vendosur në strehim familjar brend familjes sipas muajve, 2019*




Në vitin 2018, muaji dhjetor është mbyllur me 528 fëmijë. Pra, në vitin 2019 kemi një rënie për 32 fëmijë pak apo minus 6% në krahasim me të dhënat e njëjta të vitit paraprak.

*Figura 6: Shuma e mjeteve të procesuar për pagesën e strehimit familjar te farefisi, 2019*




Bazuar në figurën e mësipërme, konstatohet se shuma më e lartë e mjeteve për pagesën e strehimit familjar te farefisi është procesuar në muajin janar, në këtë muaj janë procesuar 54,800 euro, ndërsa shuma më e ulët është procesuar në muajin nëntor, në këtë muaj janë procesuar 49,500 euro. Kur të mblidhen të gjitha shumat e mjeteve të procesuara sipas muajve del që buxheti i shpenzuar për strehim familjar te farefisi për vitin 2019 është: 617,600 euro.

Shuma e mjeteve totale të shpenzuara gjatë vitit 2018 ka qenë 581,100 euro. Pra, gjatë vitit 2019 kemi një rritje të shumës totale të mjeteve të shpenzuar për 36,500 euro më shumë apo plus 6% në krahasim me vitin paraprak.

**Strehimi Familjar Alternativ, jashtë farefisit -** është formë e mbrojtjes sociale, e cila iu ofrohet fëmijëve të braktisur e pa kujdes prindëror (fëmijëve të lënë pas dore, të keqtrajtuar, të prindërve të penguar në ushtrimin e detyrës prindërore, apo rasteve të tjera kur cenohet interesi dhe mirëqenia e fëmijës/ve) bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Familjet strehuese, në të cilat bëhet strehimi i këtyre fëmijëve, rekrutohen, trajnohen dhe certifikohen për strehim familjar nga QPS-të komunale kompetente, në bashkëpunim edhe me OJQ-të partnere që në fushëveprimtarinë e tyre e kanë zhvillimin e strehimit familjar në Kosovë. Pra, familja strehuese nuk ka lidhje familjare me fëmijën që vendoset në strehim.

Pagesa për një fëmijë të vendosur në strehim familjar jashtë familjes është 250 euro në muaj, ndërsa për një fëmijë me nevoja të veçanta, të vendosur në strehim familjar jashtë farefisit është rritur në 350 euro në muaj. Në muajin e parë të vendosjes së fëmijës në strehim familjar jashtë farefisit, aplikohet edhe një pagesë fillestare në shumë prej 75 euro.

Gjatë vitit 2019 në strehim familjar alternativ/jashtë farefisit ishin të vendosur 67 fëmijë pa kujdes prindëror, të braktisur e potencial për braktisje dhe pa përkujdesje prindërore për arsye të tjera. Prej tyre 47 fëmijë (21 fëmijë pa përkujdesje prindërore dhe 26 fëmijë të braktisur) janë raste të bartura nga vitet paraprake ndërsa 20 fëmijë (6 fëmijë pa përkujdesje prindërore dhe 14 fëmijë të braktisur) janë raste të reja, të cilët bazuar në Rregulloren e Punës së Panelit, janë vendosur në strehim paraprakisht me pëlqim për shkak të nevojës urgjente të strehimit të fëmijës jashtë familjes biologjike. Për më tepër, shih figurën 7:

*Figura 7: Rastet e reja dhe rastet e bartura të fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes, 2019*




Bazuar në figurën 8, konstatohet se në muajin dhjetor 2019 kemi numrin më të madh të fëmijëve në strehim, në këtë muaj ishin të vendosur 53 fëmijë, ndërsa në muajin maj kemi numrin më të vogël të fëmijëve të vendosur në strehim familjar, në këtë muaj ishin të vendosur 44 fëmijë.

Viti 2019 (muaji dhjetor 2019) është mbyllur me 53 fëmijë të strehuar (të braktisur e pa përkujdes prindëror), të cilët praktikisht do të barten në vitin 2020. Prej tyre 9 fëmijë janë fëmijë me nevoja të veçanta dhe janë të përfshirë në pagesë, në shumë prej 350 euro në muaj. Shih figurën 8:

*Figura 8: Numri i fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes dhe numri i familjeve strehuese, 2019*




Në vitin 2018, muaji dhjetor është mbyllur me 55 fëmijë. Pra, në vitin 2019 kemi një rënie për 2 fëmijë më pak apo minus 4% në krahasim me të dhënat e njëjta të vitit paraprak.

Bazuar në figurën 9, konstatohet se në muajin dhjetor është procesuar shuma më e lartë e mjeteve për pagesën e strehimit familjar jashtë familjes, në këtë muaj janë procesuar 15,425 euro, ndërsa shuma më e ulët është procesuar në muajin shkurt, në këtë muaj janë procesuar 11,850 euro. Totali i buxhetit të shpenzuar për vitin 2019 është 155,450 euro.

*Figura 9: Shuma e mjeteve të procesuar për pagesën e strehimit familjar jashtë familjes, 2019*



Gjatë vitit 2018 totali i buxhetit të shpenzuar ka qenë 131,715 euro. Po të krahasohet kjo shumë me atë të vitit 2019, konstatohet se gjatë vitit 2019, kemi një rritje të shumës së mjeteve të shpenzuara për 23,735 euro, apo plus 15%.

### 5.3.5. Adoptimi

Adoptimi është formë e përhershme e mbrojtjes sociale për fëmijët e braktisur dhe pa përkujdesje prindërore, e cila iu ofrohet fëmijëve potencial për adoptim vendor dhe adoptim ndërkombëtar, gjithmonë duke vlerësuar interesin më të lartë të fëmijëve.

Kërkesat për adoptim parashtrohen nga ana e QPS-ve, nga Gjykatat Themelore si dhe nga autoritetet e huaja ndërkombëtare, të cilat shqyrtohen dhe trajtohen nga ana e Panelit, që është Trup Profesionale që vepron në kuadër të Departamentit për Politika Sociale dhe i Familjes. Paneli përbëhet nga anëtarë që përfaqësojnë QPS-të dhe OJQ-të si partnere.

Paneli, gjatë vitit 2019, ka mbajtur shtatë (7) takime, ku ka bërë shqyrtimin e kërkesave për vendosjen e fëmijëve në strehim familjar dhe në adoptim.

Gjatë këtyre takimeve, ka shqyrtuar 25 kërkesa për adoptim, nga të cilat 14 kërkesa janë aprovuar për adoptim vendor, 1 kërkesë për adoptim vendor është në proces, 2 kërkesa janë aprovuar për adoptim ndërkombëtar, ndërsa 8 kërkesa për adoptim ndër familjar janë refuzuar. Shih figurën e mëposhtme:

*Figura 10: Numri i kërkesave të shqyrtuara për adoptim, 2019*



Përveç shqyrtimit të kërkesave për adoptim, Paneli ka bërë shqyrtimin edhe të kërkesave për vendosjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore në strehim familjar, si dhe ka bërë vlerësimin dhe rivlerësimin për familje strehuese.

Gjatë vitit 2019, Paneli ka shqyrtuar dhe aprovuar 23 kërkesa për vendosjen në strehim familjar, nga të cilat 10 janë fëmijë pa përkujdesje të përkohshme familjare dhe 13 fëmijë të braktisur, si dhe ka bërë vlerësimin dhe aprovimin për 13 familje strehuese, nga të cilat 5 familje janë vlerësuar për herë të parë, ndërsa 8 familje janë rivlerësuar. Për më tepër shih figurën 11:

*Figura 11: Numri i kërkesave të aprovuara për vendosje në strehim familjar dhe famije strehuese, 2019*




### 5.3.6. Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e të drejtës prindërore dhe të keqtrajtuar

Tek fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e të drejtës prindërore, hyjnë fëmijët, prindërve të të cilëve iu është marrë e drejta prindërore pasi që për arsye shëndetësore apo për arsye juridike nuk janë në gjendje që t'i kryejnë detyrat e tyre prindërore. Ndërsa tek fëmijët e braktisur dhe të keqtrajtuar, hyjnë fëmijët që kanë prindër por që në fakt prindërit nuk kujdesen për ta, duke mos i respektuar obligimet ligjore që kanë si prindër. Në të shumtën e rasteve këta fëmijë janë të lënë pas dore ose janë të abuzuar.

Bazuar në raportet e Qendrave për Punë Sociale, gjatë vitit 2019 janë evidentuar 66 raste të reja të fëmijëve, prindërit e të cilëve janë penguar në kryerjen e të drejtës prindërore dhe të fëmijëve të braktisur dhe të keqtrajtuar.

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve sociale DPSF/MPMS ka ndërtuar marrëveshje bashkëpunimi me OJQ-të si partnere, gjatë procesit të realizimit dhe ofrimit të formave alternative të mbrojtjes për fëmijët pa përkujdesje prindërore/familjare, si: UNICEF, SOS Fshati i Fëmijëve, OFAP, “Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve”, etj.

Gjatë vitit 2019, në SOS Familje janë strehuar 43 fëmijë, prej tyre 31 fëmijë janë të strehuar në vitin paraprak dhe 12 fëmijë janë raste të reja të strehuar gjatë vitit 2019. Shih figurën më poshtë:

*Figura 12: Numri i fëmijëve të strehuar në SOS Familje, 2019*




Vlen të ceket se vazhdojnë të jenë pjesë e programit të SOS Fashatit në Projekte: "Jeta gjysmë e Pavarur dhe Shtëpia e Rinisë", gjithsej 11 të rinjë.

## 5.3.7. Fëmijët e abuzuar dhe të keqtrajtuar

*Fëmijët e keqtrajtuar* - sa i përket kategorisë së fëmijëve të keqtrajtuar edhe gjatë vitit 2019, janë bërë avancime në mbrojtjen e tyre, pavarësisht formës dhe nivelit të rrezikshmërisë. Tek kjo kategori kemi të bëjmë me fëmijë që kanë prindër, që nuk janë të braktisur, mirëpo prindërit e këtyre fëmijëve nuk i kryejnë obligimet e tyre ligjore për përkujdesjen ndaj fëmijëve. Në shumicën e rasteve fëmijët e kësaj kategorie janë të lënë pas dore, iu mungon kujdesi prindëror ose janë të keqtrajtuar në forma të ndryshme.

Për mbrojtje më efikase të fëmijëve të keqtrajtuar, në kuadër të bashkëpunimit në partneritet, DPSF/MPMS dhe OJQ "Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve", strehimorja në Prishtinë, edhe këtë vit kanë bashkëpunuar (në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit reciprok), për strehimin e përkohshëm të fëmijëve të rrezikuar deri sa të krijohen kushtet e favorshme për bashkim familjar ose kthim në komunitet për kategoritë:

- ✓ Fëmijët pa përkujdesje prindërore,
- ✓ Fëmijët e abuzuar dhe të keqtrajtuar,
- ✓ Fëmijët viktima të dhunës në familje,

- ✓ Fëmijët e neglizhuar,
- ✓ Fëmijët viktima të trafikimit (me nivel  të ulët të rrezikut).

Gjatë vitit 2019  numri i fëmijëve të keqtrajtuar të asistuar nga QPS-të është 25 fëmijë.

Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të keqtrajtuar/abuzuar, të strehuar në OJQ-në "Shpresa dhe Shtëpia e Fëmijëve" strehimorja në Prishtinë: kanë qenë gjithsej 25 fëmijë pa përkujdesje prindërore të  strehuar, nga të cilët 11  femijë ishin raste të bartura nga 2018, ndërsa 14 janë raste të reja, të strehuar gjatë vitit 2019.

Aktualisht  të strehuar në strehimore janë 6 fëmijë, për të cilët QPS-të kompetente  akoma nuk kanë arritë të realizojnë  bashkimin familjar të fëmijeve me familjet e tyre.

Për mbrojtje më efikase të fëmijëve pa përkujdesje prindërore DPSF/MPMS ka lidhë marrëveshje bashkëpunimi për strehimin e fëmijëve edhe me OJQ-në "Caritas Umbria" në Klinë.

Në këtë strehimore, gjatë vitit 2019 ishin të strehuar 19 fëmijë pa përkujdesje prindërore, të keqtrajtuar dhe të braktisur, nga të cilët 16 janë fëmijë të bartur nga viti 2018, 1 fëmijë i vendosur gjatë vitit 2019 dhe 2 fëmijë kanë arritur moshën madhore. Në muajin dhjetor në këtë strehimore janë të strehuar 17 fëmijë. Për më tepër shih figurën e mëposhtme:

*Figura 13:  Numri i fëmijëve të vendosur në strehimore, 2019*




## 5.4. Fëmijët në konflikt me ligjin dhe fëmijët me sjellje asociale

Për mbrojtjen e kësaj kategorie të fëmijëve janë realizuar format e duhura të mbrojtjes në harmoni me legjislacionin në fuqi. Sipas raporteve të QPS-ve vazhdon puna profesionale në partneritet me subjektet e tjera relevante, si: Gjykata, Policia e Kosovës, Shërbimi Sprovues, Shkolla dhe OJQ-të.

Nga të dhënat raportuar nga QPS-të, nga Baza e të Dhënave të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, si dhe bashkëpunimi në partneritet, numri i evidentuar i fëmijëve në konflikt me ligjin dhe i fëmijëve me sjellje asociale është 661 fëmijë, të cilën e kemi paraqitur në figurën e mëposhtme:

*Figura 14: Numri i fëmijëve me sjellje asociale dhe të miturit në konflikt me ligjin, 2019*




Nga totali prej 661 fëmijëve që janë trajtuar me shërbimet e nevojshme nga ana e Qendrave për Punë Sociale, prej tyre 176 apo 27% janë fëmijë me sjellje asociale dhe 485 apo 73% janë fëmijë/të mitur në konflikt me ligjin.

## 5.5. Riatdhesimi i fëmijëve të pashoqëruar

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas mandatit që ka, bazuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit në Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar për kategorinë e fëmijëve të pa shoqëruar përmes Qendrave për Punë Sociale, realizon ofrimin e shërbimeve sociale për fëmijët e pa shoqëruar, duke iu ofruar mbrojtje direkte dhe riintegrimin afatgjatë të tyre.

MPMS-j pas koordinimit të punës dhe realizimit të kushteve për kthim të fëmijës/fëmijëve të pashoqëruar, koordinon punën në organizimin e pritjes se fëmijëve në Aeroportin e Prishtinës apo në pikat e tjera kufitare, ku zyrtarë të QPS-së kompetente dhe zyrtarë të MPB-së e bëjnë pritjen e fëmijës në fjalë. Pas realizimit të riatdhesimit të fëmijëve të pashoqëruara, Qendra për Punë Sociale që vepron në territorin ku është riatdhesuar fëmija, është e obliguar që në fillim të bëjë një vlerësim profesional të fëmijës dhe pastaj të vazhdohet me ofrimin e shërbimeve të nevojshme sociale dhe familjare.

Gjatë vitit 2019, është bërë riatdhesimi i 19 fëmijëve pa përkujdesje prindërore, nga të cilët 17 janë fëmijë të kthyer nga zonat e konfliktit në Siri. Që të gjithë këta fëmijë janë trajtuar me shërbime sociale për riintegrim. Pra, këtyre fëmijëve iu janë ofruar format e mbrojtjes sociale në harmoni me legjislacionin në fuqi.

## 5.6. Fëmijët në punë të rënda

Bazuar në situatën aktuale të fëmijëve të përfshirë në punë të rënda dhe duke u bazuar në rekomandimet e dala nga disa aktorë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, konkretisht Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare në bashkëpunim me aktorët e tjerë që merren me fëmijët në punë të rënda, ka ndërmarre disa veprime konkrete për vitin 2019.

Komiteti i Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rënda të Fëmijëve (KKPEPRF), i cili është formuar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës në fillim të vitit 2016, e që drejtohet nga Ministri i MPMS-së ka vazhduar aktivitetin e vet, ku përmes anëtarëve të këtij komitetit janë koordinuar institucionet e nivelit qendror në hartimin e politikave nacionale për rritjen dhe përmirësimin e mirëqenies sociale për fëmijët në punë të rënda. Komiteti gjatë pjesës së parë të vitit 2019 ka mbajtur 4 takime, me qëllim të hartimit të Planit të Veprimit për KKPEPRF-në për vitin 2019. Ndërsa takimin e rregullt Komiteti e ka mbajtur më 12 qershor 2019, ku është miratuar Plani i Veprimit për vitin 2019, dhe është prezantuar situata aktuale e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda dhe masat që duhen ndërmarrë në realizimin e objektivave të Planit të Veprimit për vitin 2019.

Me rekomandim të Komitetit të Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rënda të Fëmijëve, edhe gjatë vitit 2019, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka vazhduar me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me kryetarët e atyre komunave që nuk i kanë nënshkruar akoma Marrëveshjet e Bashkëpunimit për Krijimin e Komiteteve Lokale për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rënda të Fëmijëve. Këto Marrëveshje të Bashkëpunimit, kanë për qëllim të rregullojnë dhe koordinojnë aktivitetet e institucioneve në nivelin qendror dhe lokal për mbrojtjen e fëmijëve nga eksploatimi ekonomik dhe nga kryerja e punëve që pengojnë edukimin e tyre ose që janë të dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin psiko-fizik, mendor, emocional, moral dhe shoqëror të fëmijëve, si dhe për parandalimin dhe eliminimin efektiv të punëve të fëmijëve, me fokus të veçantë ndaj formave të rënda dhe të rrezikshme të punës.

Gjatë vitit 2019, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me Organizatën Joqeveritare partnere “Terre des Hommes”, dhe OJQ-në “Word Vision”, si dhe është në bashkëpunim me ILO-n, ku këta partnerë do ta mbështesin MPMS-në në realizimin e objektivave të Planit të Veprimit për vitin 2019.

Qendrat për Punë Sociale, nëpër të gjitha komunat e Kosovës, në bashkëpunim edhe me Policinë e Kosovës (PK), gjatë vitit 2019 kanë identifikuar 129 fëmijë në punë të rënda, të cilët janë trajtuar nga QPS-të, si organe përgjegjëse për ofrimin direkt të shërbimeve sociale dhe familjare për kategoritë në nevojë sociale, me këto shërbime: shërbime shëndetësore, këshilla psiko-sociale, ndihmë sociale/kyçje familjes në Skemën e Ndihmës Sociale, akomodim dhe shërbime këshillimi dhe vetëdijësimi. Për më tepër shih figurat më poshtë:

*Figura 15: Numri i fëmijëvë të evidentuar në punë të rënda, 2019*




*Figura 16: Fëmijët në punë të rënda me përqindje, 2019*




Bazuar në figurat e mësipërme konstatohet se nga 129 fëmijët e evidentuar në punë të rënda, 88 fëmijë apo 68% janë fëmijë që kanë punuar në rrugë si lëmoshë kërkues, 27 fëmijë apo 21% fëmijë kanë punuar në rrugë me shitblerjen e gjësendeve të imta, dhe 14 fëmijë apo 11% kanë punuar në eksploatimin e pasurive natyrore.

## 5.7. Dhuna në familje

Pjesë e rëndësishme e punës së shërbimeve sociale dhe familjare, është puna për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, është përgjegjëse për draftimin e legjislacionit, zhvillimin e politikave, hartimin e standardeve minimale për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për viktimat e dhunës ne familje, monitorimin dhe inspektimin e kualitetit të shërbimeve, sigurimin e zbatimit të politikave, legjislacionit dhe minimumin e standardeve për ofrimin e shërbimeve sociale. MPMS-ja në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe institucionet e tjera relevante, sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, është e obliguar që të bëjë monitorimin dhe implementimin e Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje, si dhe monitorimin e implementimit të Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjegjësisht, Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjare edhe gjatë këtij viti ka vazhduar mbështetjen financiare për Organizatat Joqeveritare që në kuadër të tyre ofrojnë shërbime sociale për viktimat e dhunës në familje, në proces të mbrojtjes sociale dhe riintegrimit të tyre. Shuma monetare e mbështetjes për OJQ-të që trajtojnë rastet e dhunës në familje për vitin 2019, është 257,000 euro. Krahasuar me vitin paraprak ku kjo shumë ishte 132 mijë euro, del që në vitin 2019, shuma që ka ndarë MPMS-ja për të mbështetur këto OJQ është rritur për 125 mijë euro, apo plus 49%.

Me qëllim të rritjes së kualitetit të shërbimeve për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje, përveç shërbimeve sociale që ofrohen nga Qendrat për Pune Sociale që kanë shtrirje në tërë territorin e Republikës së Kosovës, MPMS/DPSF-ja ka krijuar dhe vazhdon ta forcojë partneritetin me OJQ-të të cilat kanë në programet e tyre: *strehimin*, *trajtimin*, *përkrahjen dhe fuqizimin e viktimave të dhunës në familje*.

MPMS/DPSF-ja ka realizuar marrëveshje dhe kontrata për blerjen e shërbimeve për mbrojtjen dhe strehimin e viktimave të dhunës në familje me 6 (gjashtë) strehimore në nivel nacional, të cilat janë:

1. OJQ-ja “*Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve*” - Strehimorja në Prishtinë;
2. OJQ-ja “*Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Raba Voca”* - Strehimorja në Mitrovicë;
3. OJQ-ja “*Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve*” – Strehimorja në Prizren;
4. OJQ-ja “*Qendra për Mirëqenien e Gruas”*- Strehimorja në Pejë;
5. OJQ-ja “*Shtëpia e Sigurtë”* - Strehimorja në Gjakovë;
6. OJQ-ja “*Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve*” - Strehimorja në Gjilan.
7. OJQ-ja “*Shtëpia ime* “- Strehimorja në Ferizaj.

Të gjitha këto strehimore gjatë vitit 2019 kanë strehuar dhe kanë trajtuar me shërbime të nevojshme viktimat e dhunës në familje të të gjitha moshave dhe nacionaliteteve. Partneriteti i krijuar me OJQ-të në ofrimin e shërbimeve, është shumë i rëndësishëm për procesin e mbrojtjes dhe ndihmës në procesin e përbashkët për riintegrimin e viktimave të dhunës në familje.

Në bazë të monitorimit të bërë në dosjet e rasteve të dërguara nga ana e Qendrave për Punë Sociale, dhe monitorimin e Bazës së të Dhënave për shërbime sociale dhe familjare, si dhe raporteve statistikore të dërguara nga OJQ-strehimoret lidhur me rastet e trajtuara, rezulton se gjatë periudhës kohore janar-dhjetor 2019 janë strehuar, trajtuar dhe u janë ofruar shërbime sociale 586 viktimave të dhunës në familje. Për më tepër shih tabelën numër më poshtë:

*Tabela 1: Numri i viktimave të dhunës në familje të strehuara në strehimore, 2019*

| OJQ/Strehimorja | Mosha | | Gjinia | | Vendi i prejardhjes | | Totali | Shuma e Grantit të fituar nga MPMS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nën 18 | Mbi 18 vjeç | F | M | Vendor/e | Ndërkombëtar/e | | |
| OJQ "QMGF"-Prishtinë | 64 | 50 | 89 | 25 | 112 | 2 | 114 | 30,000.00 € |
| OJQ "LIRIA"-Gjilan | 37 | 30 | 61 | 6 | 64 | 3 | 67 | 32,000.00 € |
| OJQ "SHTËPIA IME"-Ferizaj | 27 | 20 | 19 | 9 | 43 | 4 | 47 | 32,000.00 € |
| OJQ "QSGF-P"Prizren | 19 | 18 | 31 | 6 | 35 | 2 | 37 | 32,000.00 € |
| OJQ "SHTËPIA E SIGURT"-Gjakovë | 60 | 58 | 92 | 26 | 117 | 1 | 118 | 32,000.00 € |
| OJQ "QMG"- Pejë | 56 | 38 | 66 | 28 | 90 | 4 | 94 | 32,000.00 € |
| OJQ "QMGF" - Mitrovicë | 30 | 45 | 47 | 28 | 74 | 1 | 75 | 32,000.00 € |
| OJQ “SDSF”- Prishtinë | 34 | 0 | 21 | 13 | 32 | 2 | 34 | 35,000.00 € |
| **TOTALI** | **327** | **295** | **426** | **141** | **567** | **19** | **586** | **257,000.00 €** |

Në vitin 2018, në strehimoret e paraqitura në tabelën e mësipërme janë strehuar/trajtuar 454 viktima të dhunës në familje. Po të krahasohet ky numër me të dhënat e vitit 2019, konstatohet se gjatë vitit 2019 kemi një rritje të numrit prej 132 viktima më shumë, apo plus 22.53%.

### 5.7.1. Struktura gjinore dhe mosha e viktimave të dhunës në familje

Nga totali prej 586 viktimave të dhunës në familje, 327 viktima apo 56% janë të moshës nën 18 vjeç (fëmijë) dhe 259 viktima apo 44% janë mbi moshën 18 vjeç (të rritur/a). Shih tabelën 1 dhe figurën 17:

*Figura 17: Përqindja e viktimave të dhunës në familje sipas moshës, viti 2019*




Ndërsa sa i përket gjinisë së viktimave të dhunës në familje, nga totali prej 586 viktimave, 445 viktima apo 76% janë femra, ndërsa 141 viktima apo 24% janë meshkuj. *Shih tabelën 1 dhe figurën e më poshtme:*

*Figura 18: Përqindja e viktimave të dhunës në familje sipas gjinisë, 2019*



## 5.8. Trafikimi me qenie njerëzore

Sa i përket viktimave të trafikimit me qenie njerëzore[1], Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale së bashku me partnerët qeveritar dhe jo qeveritar, punon në sistem të referimit[2] në kuadër të mbrojtjes sociale, në mbrojtjen direkte të tyre duke përfshirë: *përmbushjen e nevojave imdediate të viktimave, strehimin, rehabilitimin, punën me familje, bashkimin familjar, riatdhesimin dhe riintegrimin afatgjatë të tyre.*

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është anëtare e Autoritetit Kombëtar kundër trafikimit me qenie njerëzore, autoritet i cili kryesohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, gjegjësisht, nga Zyra e Koordinatorit Nacional Kundër-Trafikim. Gjithashtu, MPMS-ja është hartuese dhe implementuese e shumë aktiviteteve në kuadër të Planit Nacional për luftimin e trafikimit me qenie njerëzorë në Kosovë, sa i përket fushës së mbrojtjes sociale.

### 5.8.1. Strehimi dhe trajtimi i viktimave të trafikimit

Në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale funksionon Strehimorja e Përkohshme e Sigurt në Lipjan, strehimore e cila strehon raste të trafikimit me nivel të mesëm dhe të lartë të rrezikshmërisë, si dhe viktima të trafikimit në cilësinë e dëshmitarit. Strehimorja për Strehimin e Viktimave të Trafikimit gjendet në Lipjan, punon 24 (njëzet e katër) orë në ditë dhe akomodon/strehon viktimat e trafikimit me rrezikshmëri të lartë dhe të mesëm të sigurisë, si dhe dëshmitarë/e të mbrojtur në cilësinë e viktimës së trafikimit.

Në bazë të Rregullores (MPMS) Nr. 01/2016 për Funksionimin dhe Punën në Strehimore për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, detyrat dhe përgjegjësitë e Strehimores për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit janë:

- ✓ *Sigurimi i akomodimit të viktimave të trafikimit për të mitur dhe të rritur;*
- ✓ *Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, të ushqimit, veshmbathjes dhe farmaceutike për viktimat e strehuara;*
- ✓ *Mirëmbajtja e të dhënave të viktimave të strehuara në kuadër të strehimores;*
- ✓ *Bashkëpunimi dhe komunikimi me të gjitha institucionet relevante, të cilat janë të angazhuara kundër trafikimit;*

[1] Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Ligji Nr. 04/L-81 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare.
[2] Strategjia Nacionale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore në Kosovë 2009-2014.

- ✓ *Hartimi dhe sigurimi i zbatimit të planit për riintegrimin e viktimave të strehuara dhe risocializimin e viktimave në familje dhe shoqëri;*
- ✓ *Përgatitja e raporteve të rregullta periodike mbi aktivitetet e zhvilluara;*
- ✓ *Informimi dhe ofrimi i këshillave profesionale për viktimat mbi të drejtat e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.*

Në bazë të monitorimit të bërë në dosjet e rasteve të dërguara nga ana e Qendrave për Punë Sociale, viktima të trafikimit të mitur dhe të rritur, vendor dhe të huaj dhe në bazë të barazimit të rasteve me Drejtoratin për Hetim të Trafikimit me Qenie Njerëzore në Policinë e Kosovës, dhe monitorimin e Bazës së të Dhënave për shërbime sociale dhe familjare, dhe në bazë të raporteve të Strehimores së Përkohshme të Sigurt në Lipjan, rezulton se gjatë vitit 2019 janë trajtuar dhe u janë ofruar shërbime sociale njëzet e pesë (25) viktimave të trafikimit. Sipas Formës Bazike të të Dhënave nga Policia e Kosovës/DHTQNJ, viktima të trafikimit ishin shtatëmbëdhjetë (17) ndërsa viktima potenciale tetë (8). Në ndikim të substancave narkotike ishin katër (4) viktima, prej tyre një (1) viktimë mashkull i moshës tetë (8) vjeç. Ndërsa në OJQ-në "Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalim të Trafikimit me Qenie Njerëzore" (QMVPTQNJ) në Prishtinë, gjatë vitit 2019 janë strehuar dhe trajtuar me shërbime të nevojshme 26 viktima të trafikimit. Shih tabelën e më poshtme:

*Tabela 2: Numri i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, 2019*

| OJQ-Strehimorja | Nën moshën 18 vjeç | Mbi 18 vjeç | Femra | Meshkuj | Vendore | Ndërkombëtare | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Strehimorja për Strehimin e Viktimave të Trafikimit -Lipjan | 17 | 8 | 24 | 1 | 20 | 5 | 25 |
| QMVPTQNJ-Prishtinë | 22 | 4 | 26 | 0 | 26 | 0 | 26 |
| **Totali** | **39** | **12** | **50** | **1** | **46** | **5** | **51** |

Gjatë akomodimit, të gjitha viktimave iu janë ofruar me kohë shërbimet mjekësore, psiko-sociale, të ushqimit, veshmbathjes dhe ato farmaceutike. Vlen të theksohet se një numër i viktimave të trajtuara në strehimore ishin përdorues të substancave narkotike, të cilat gjatë qëndrimit të tyre janë trajtuar edhe me terapinë e metadonit.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjegjësisht, Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar me mbështetjen e projekteve të organizatave joqeveritare që në kuadër të tyre ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit në proces të mbrojtjes dhe riintegrimit të tyre.

Sa i përket kësaj mbështetjes, konkretisht, gjatë vitit 2019, Organizata Joqeveritare Vendore “Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalim të Trafikimit me Qenie Njerëzore’’, ka vazhduar partneritetin me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe MPMS-ja për këtë vit ka mbështetur projektet e saj në vlerë prej 32,000.00 euro.

### 5.8.2. Numri i viktimave të trafikimit sipas moshës dhe gjinisë

Kur kemi të bëjmë me viktima të trafikimit fëmijë, Qendra për Punë Sociale në nivel lokal është ndër partnerët e parë që ofron format e mbrojtjes për viktimat e trafikimit në partneritet me policinë, mbrojtësit e viktimave dhe OJQ-strehimoret, të cilat ofrojnë strehim për këtë kategori si dhe me subjekte tjera të cilat punojnë në këtë fushë. Qendra për Punë Sociale në trajtimin e rasteve të viktimave të trafikimit fëmijë, është e obliguar të trajtojë rastin duke iu përmbajtur menaxhimit të rastit konform legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Qendra për Punë Sociale, merret edhe me trajtimin e viktimave të rritura, mbi moshën 18 vjeç, ky trajtim hyn në kuadër të mbrojtjes dhe riintegrimit, me ç’rast viktimave iu ofrohen shërbime sociale dhe familjare, si: shërbime psiko-sociale, ndërmjetësim për kthim në familje, shërbime ndërlidhëse me agjencitë e tjera për mundësi riaftësimi profesional, mundësi punësimi, etj.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën 2, konstatojmë se nga 41 viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, 39 viktima apo 76% janë nën moshën 18 vjeç (fëmijë), ndërsa 12 viktima apo 24% janë mbi moshën 18 vjeç. Shih figurën më poshtë:

*Figura 19: Përqindja e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore sipas moshës, 2019*



Ndërsa, po të merret për bazë gjinia, atëherë kostatohet se nga 51 viktimat e trajtuara, 50 viktima apo 98% janë femra, ndërsa 1 viktimë apo 2% janë meshkuj. Shih figurën më poshtë:

*Figura 20: Përqindja e viktimat të trafikimit sipas gjinisë, 2019*




## 5.8.3. Numri i viktimave të trafikimit sipas vendit të prejardhjes

Bazuar në tabelën 2 nga 51 viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, 46 viktima apo 90% janë vendore, ndërsa 5 viktima apo 10% janë ndërkombëtare. Shih figurën e më poshtme:

*Figura 21: Përqindja e viktimave të trafikimt sipas vendit të prejardhjes, 2019*



## 5.9. Mbrojtja e viktimave të krimeve seksuale-fëmijë

Në kuadër të monitorimit të bërë gjatë vitit 2019, Qendrat për Punë Sociale në gjithë Kosovën kanë trajtuar, menaxhuar dhe iu kanë ofruar shërbime sociale dhe familjare njëmbëdhjetë (11) viktimave të krimeve seksuale të cilët kanë qenë fëmijë. Në të gjitha këto raste, abuzuesit kanë qenë të moshës madhore.

Mbrojtja për këtë kategori ka konsistuar në ofrimin e shërbimeve, si:

- *Koordinimi për ofrim të shërbimeve shëndetësore;*
- *Strehim në strehimore për tejkalim të traumës;*
- *Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale;*
- *Puna më familjen;*
- *Puna me komunitetin, etj.*

## 5.10. Të miturit që hyjnë në martesë të parakohshme

Bazuar në legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, personi që akoma nuk i ka mbushur 18 vjeç nuk mund të lidh martesë, me përjashtim të rasteve kur i mituri me kërkesë i drejtohet Gjykatës kompetente, e cila mund t'i lejojë martesën personit të mitur, më të vjetër se 16 vjet, nëse konstaton se ai/ajo ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike për të ushtruar të drejtat e veta martesore dhe për të përmbushur detyrimet martesore. Gjykata  vendos më Vendim, mirëpo paraprakisht kërkon mendimin edhe të:

- *Organit të Kujdestarisë, i cili funksionon në kuadër të Qendrave për Punë Sociale*,
- *të prindërve/kujdestarit të tij/saj*,
- *të personit me të cilin lidhet martesa, si dhe*
- *mendimin e institucionit përkatës shëndetësor.*

### 5.10.1. Numri i kërkesave për martesë para moshës madhore

Bazuar në të dhënat e regjistruara nga ana e Qendrave për Punë Sociale, në Bazën e të Dhënave të Shërbimeve Sociale, konstatohet se gjatë vitit 2019 nga Organi i Kujdestarisë janë trajtuar 16 raste për martesë para moshës madhore, të gjitha rastet janë femra, nga të cilat 14 janë të nacionalitetit shqiptar, 1 e nacionalitetit ashkali dhe 1 e nacionalitetit egjiptian.

## 5.11. Këshilla martesore

Bazuar në të dhënat e evidentuara në Bazën e të Dhënave të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, gjatë vitit 2019, me këshilla martesore janë trajtuar 344 raste. Nga të cilat, 303 apo 88% janë të nacionalitetit shqiptar, ndërsa 41 apo 22% janë të nacionaliteteve të tjera. Shih figurën më poshtë:

*Figura 22: Numri i rastevet të trajtuar me këshilla martesore sipas nacionalitetit, 2019*




## 5.12. Komisioni për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në Shkallë të Dytë

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në Shkallë të Dytë për Shërbimet Sociale dhe Familjare, i cili vepron në kuadër të DSHS/DPSF-së edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar të veprojë me kompetencë dhe duke u bazuar në ligjet dhe udhëzimet administrative që janë në fuqi, e që kanë të bëjnë me shërbimet sociale dhe familjare, pastaj në Ligjin e Procedurës Administrative, Ligjin për të Miturit, etj.

Gjatë vitit 2019, nga ana e këtij Komisioni janë shqyrtuar 76 lëndë/ankesa, të cilat kanë të bëjnë me shërbime sociale dhe familjare. Nga ky total, 70 apo 92% e ankesave kanë të bëjnë me Skemën e Familjeve që kanë Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përhershme 0-18 vjeç, kurse 6 apo 8% e ankesave kanë të bëjnë me shërbime të tjera sociale dhe familjare.

## 5.13. Bashkëpunimi me Organizatat Jo Qeveritare

Edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar bashkëpunimin me OJQ-të, të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për individë/familje në nevojë sociale e që MPMS/DPSF-ja ka marrëveshje bashkëpunimi me to. Bashkëpunimi ka vazhduar dhe është realizuar me sukses me:

- OJQ-në “OFAP” (më heret “Amiçi de Bambini”) – Prishtinë,
- SOS Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës,
- 6 OJQ-të që Strehojnë Viktimat e Dhunës në Familje (gra dhe fëmijë),
- 2 OJQ-të për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit të Fëmijëve të Keqtrajtuar,
- “Caritas Umbria”- Klinë,
- Koalicioni i OJQ-ve për të Drejtat e Fëmijëve,
- OJQ-ja “Terr Des Hommes” – Prishtinë, etj.

## 5.14. Avancimi i Infrastrukturës Juridiko-profesionale

Me qëllim të avancimit të standarteve të cilat do të mundësonin ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në formë cilësore, në formë alternative dhe inovative nga sektori publik dhe jopublik, me qëllim të përafrimit të legjislacionit me atë të BE, gjatë vitit 2019 është aprovuar Konceptidokumentit për Shërbime Sociale dhe Familjare. Pas aporvimit të këtij Konceptdokumenti nga ana e Qeverisë, MPMS-ja ka formuar Grupin Punues për Hartimin e Draftit të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare. Grupi Punues ka arritur që të hartojë draftin e parë të këtij Ligji. Parashihet që gjatë vitit 2020 të finalizohet procesi i hartimit të draftit dhe të aprovohet Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.

# 6. DIVIZIONI PËR AFTËSINË E KUFIZUAR DHE PERSONAT E MOSHUAR

## 6.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar (DAKPM), funksionon në kuadër të DPSF-së. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Divizioni janë:

- ✓ *Propozimi, hartimi dhe sigurimi i zbatimit të dokumenteve të politikave/strategjive për çështjet e ndërlidhura me personat me aftësi të kufizuara dhe personat e moshuar;*
- ✓ *Propozimi, hartimi dhe sigurimi i zbatimit të legjislacionit për zhvillimin e shërbimeve për persona me aftësi të kufizuara dhe persona të moshuar;*
- ✓ *Ofrimi i mbështetjes në menaxhimin e shërbimeve për persona me aftësi të kufizuara dhe persona të moshuar;*
- ✓ *Analizimi dhe raportimi mbi nevojat vjetore buxhetore për shërbimet e personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuar;*
- ✓ *Koordinimi i aktiviteteve me institucionet relevante;*
- ✓ *Bashkëpunimi me organizata jo qeveritare për zhvillimin e aktiviteteve.*

Udhëheqësi i Divizionit për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar, raporton tek Udhëheqësi i Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare.

## 6.2. Aktivitetet e realizuara nga Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar

Puna dhe aktivitetet e realizuara nga DAKPM-ja, gjatë vitit 2019 ka konsistuar në përmbushjen e kërkesave të dala nga institucionet dhe shtëpitë me bazë në komunitet, të cilat trajtojnë 24 orë *personat e moshuar pa përkujdesje familjare, fëmijët e braktisur dhe me aftësi të kufizuara dhe personat e rritur, po ashtu, me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor.* Për t'u realizuar këto aktivitete, ka funksionuar një bashkëpunim i mirëfilltë në mes të zyrtarëve të Divizionit me drejtorët dhe menaxheret e institucioneve dhe shtëpive me bazë në komunitet. Ky bashkëpunim ka ndikuar që kujdesi, trajtimi dhe ofrimi i shërbimeve në të mirë të klientëve, të bëhet në përputhshmëri me standardet e cilësisë, si nga institucionet por edhe nga OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale.

Mbrojtja e kategorive të cekura më lartë, konsiston në ofrimin e shërbimeve 24 orëshe, duke përfshirë: strehimin, ushqimin, veshmbathjen, ofrimin e shërbimeve shëndetësore, akomodimin dhe të gjitha shërbimet e tjera të vlerësuara si të nevojshme për personat e moshuar pa përkujdesje familjare, fëmijët e braktisur me aftësi të kufizuara, si dhe personat e rritur me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor.

Me qëllim të mbrojtjes së personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) funksionon: Shtëpia për Personat e Moshuar dhe Pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë (SHPMPF) si dhe Shtëpitë me Bazë në Komunitet në Istog, Skenderaj dhe në Graçanicë. Ndërsa për fëmijët e braktisur me aftësi të kufizuara dhe personat e rritur me aftësi të kufizuara mendore- ngecje në zhvillim, funksionon: Instituti Special në Shtime (ISSH), Shtëpia e Fëmijëve në Shtime, si dhe 8 Shtëpitë me Bazë në Komunitet, të cilat funksionojnë në kuadër të nivelit komunal.

DAKPM-ja, gjatë periudhës raportuese ka dhënë kontributin e vet  në ngritjen e kualitetit jetësor për të gjithë klientët pa dallim, gjë e cila është arritur dhe arrihet përmes vizitave të shumta direke dhe kontakteve indirekte, duke e monitoruar punën e stafit punonjës, si dhe duke i ndihmuar profesionalisht në sferën e aplikimit të formave të shërbimeve sa më të avancuara. Përveç vizitave monitoruese, gjatë vitit 2019 janë kryer edhe inspektime nëpër këto institucione, ku pas çdo inspektimi është hartuar raport me rekomandime përkatëse.

Për  t'u vërtetuar kualiteti i shërbimeve që ofrohen nga stafi punues i institucioneve, vizita janë realizuar edhe nga organizata të tjera si IAP-i dhe KMDLNJ-ja, të cilat pas çdo vizite kanë hartuar raport pune me rekomandime për secilin institucion. Kjo gjë ka ndihmuar që me kohë të mund të realizohen rekomandimet e tyre.

Gjatë vitit 2019, me leje paraprake nga MPMS-ja, kanë bërë vizita në të dy institucionet (SHPMPF dhe ISSH) shumë agjenci të informimit, si televizione dhe agjenci tjera, të cilat kanë realizuar reportazhe të ndryshme, lidhur me kushtet jetësore në këto institucione, në të cilat trajtohen të moshuarit, fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara. Po ashtu, me leje paraprake të marrë në MPMS, shumë institucioneve parashkollore, shkollore, organizata të ndryshme dhe qytetarë vullnet mirë, iu është dhënë leje për vizitë në institucione, ku janë ofruar donacione të ndryshme me interes për klientë, si dhe janë ofruar programe argëtuese për ta.

Gjatë këtij viti më buxhet të DAKPM-së  janë bërë renovime dhe furnizime të prekshme në dy institucionet dhe në shtëpinë e fëmijëve. Këto renovime dhe furnizime kanë ngritur cilësinë e jetës së klientëve dhe janë avancuar kushtet e punës për stafin, si dhe ka ndikuar në ngritjen e cilësisë dhe të shërbimeve që ofrohen 24 orë.

Gjatë vitit 2019, ka vazhduar bashkëpunimi edhe me OJQ të ndryshme të licencuara, të cilat ofrojnë shërbime për fëmijët dhe të rriturit në gjendje të nevojës sociale. Këto organizata kryesisht ofrojnë shërbime në shtëpi –familje, si dhe shërbime përmes qëndrimit ditor.

Vlen të ceket se gjatë këtij viti si përfaqësues të MPMS-së kemi qenë pjesë e grupit punues për hartimin e Projektligjit të Përgjithshëm të Aftësisë së Kufizuar në Kosovë, përmes të cilit do të bëhet trajtimi dhe kategorizimi i personave me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu, gjatë këtij viti kemi bashkëpunuar me ministritë e linjës, posaçërisht me Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku është hartuar Rregullorja e Punës për Trajtim të Qytetarëve të Huaj, të cilët në procedura të rregullta zyrtare, e kanë fituar të drejtën e qëndrimit në Kosovë. Po ashtu, me MPB-në jemi duke u koordinuar për zgjidhje të strehimit dhe trajtimit të qytetarëve të Kosovës të cilët riatdhesohen nga vendet jashtë Kosovës. Falë këtij bashkëpunimi, është arritur që një i moshuar, i cili ka qenë me qëndrim në shtetin e Kroacisë, të riatdhesohet dhe i njëjti tani është duke u trajtuar në SHPMPF-në në Prishtinë.

## 6.3. Numri i kërkesave të shqyrtuara për strehimi institucional/rezidencial

Gjatë vitit 2019, DAKPM-ja ka pranuar 40 kërkesa për strehim institucional-rezidencial, të cilat janë parashtruar nga Qendrat për Punë Sociale të shpërndara nëpër tërë territorin e Republikës së Kosovës. Nga totali prej 40 kërkesave të parashtruara, 34 kërkesa apo 85% ishin për vendosje në SHPMPF, ndërsa 6 kërkesa apo 15% ishin për vendosje në ISSH. Shih figurën më poshtë:

*Figura 23: Përqindja e kërkesave për strehim institucional/rezidencial, 2019*




Kërkesat e parashtruara janë shqyrtuar nga komisionet përkatëse të DAKPM-së, të cilët kanë nxjerrë vendime në përputhshmëri të plotë me Udhëzimet Administrative në fuqi (U.A. Nr.10/2014 dhe 11/2014).

Pra, nga 40 kërkesat e parashtruara, 35 kërkesa apo 87.5% janë aprovuar, ndërsa 5 kërkesa apo 12.5% janë refuzuar, pasi që nuk i kanë plotësuar kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi. Vlen të theksohet se 9 kërkesa të aprovuara nuk janë realizuar akoma për shkak të mungesës së kapaciteteve. *Shih figurën numër më poshtë:*

*Figura 24: Numri i kërkesavë të shqyrtuara për strehim institucional/rezidencial, 2019*




Vlen të ceket se në pamundësi të kthimit në familje apo farefis, iu është vazhduar qëndrimi në institucione 67 klientëve, nga të cilët 46 klientë janë të ISSH-së në Shtime dhe 26 klientë janë të SHPMPF-së në Prishtinë.

Gjatë vitit 2019 janë regjistruar 20 raste të vdekjes, të gjitha vdekje natyrore, 4 vdekje janë regjistruar në ISSH ndërsa 16 në SHPMPF në Prishtinë.

Gjatë vitit 2019, 1 klient është larguar vullnetarisht nga ISSH-ja.

Muaji dhjetor 2019, është mbyllur me 274 klientë të vendosur në dy institucionet dhe në 11 Shtëpitë me Bazë në Komunitet.

### 6.3.1. Struktura gjinore dhe nacionale e klientëve në SHPMPF-Prishtinë

Në muajin dhjetor 2019, në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë, ishin të vendosur 81 klientë, nga të cilët 33 klientë apo 41% ishin të gjinisë mashkullore ndërsa 48 klientë apo 59% ishin të gjinisë femërore. Për më tepër shih tabelën më poshtë:

*Tabela 3: Struktura gjinore dhe nacionale e klientëve në SHPMPF-së, Prishtinë, dhjetor 2019*

| **Nacionaliteti** | **Shqiptar** | | **Serb** | | **Mysliman** | | **Kroat** | | **Rom** | | **Hungarez** | | **Total** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjinia | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | |
| Numri | 29 | 34 | 1 | 7 | 1 | 5 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 81 |
| **Totali** | **63** | | **8** | | **6** | | **1** | | **2** | | **1** | | |

Bazuar në tabelën e më sipërme, konstatohet se nga 81 klientët e vendosur në SHPMPF-në në Prishtinë, 63 klientë apo 78% janë të nacionalitetit shqiptar, ndërsa 18 klientë apo 22% janë të nacionaliteteve të tjera. Shih figurën më poshtë:

*Figura 25: Struktura nacionale e klienteve në SHPMPF- Prishtinë, dhjetor 2019*




Në muajin dhjetor 2018 në SHPMPF ishin të vendosur 71 klientë. Atëherë del që në vitin 2019 kemi një rritje prej 10 klientëve apo 12% më shumë në krahasim me të dhënat e njëjta të vitit paraprak.

## 6.3.2. Struktura gjinore dhe nacionale e klientëve në Institutin Special në Shtime

Në Institutin Special në Shtime në muajin dhjetor 2019 ishin të vendosur 64 klientë, 41 klientë apo 64% ishin të gjinisë mashkullore, kurse 23 klientë apo 36% ishin të gjinisë femërore. Shih tabelën 4:

*Tabela 4: Struktura gjinore dhe nacionale e klientëve në ISSH - Shtime, dhjetor 2019*

| **Nacionaliteti** | **Shqiptar** | | **Serbë** | | **Mysliman** | | **Goran** | | **Rom** | | **Hungarez** | | **Totali** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjinia | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | |
| Numri | 22 | 20 | 9 | 2 | 1 | 0 | 1 | 0 | 7 | 1 | 1 | 0 | 64 |
| **Totali** | **42** | | **11** | | **1** | | **1** | | **8** | | **1** | | |

Bazuar në tabelën e mësipërme konstatohet se 42 klientë apo 66% e tyre ishin të nacionalitetit shqiptar, ndërsa 22 klientë apo 34% e kilentëve ishin të nacionaliteteve të tjera. Shih figurën 26:

*Figura 26: Struktura nacionale e klienteve në ISSH-Shtime, dhjetor 2019*




Në muajin dhjetor 2018 në ISSH ishin të vendosur 67 klientë. Atëherë del që në vitin 2019 kemi një rënie për 3 klientë më pak apo minus 5% në krahasim me të dhënat e njëjta të vitit paraprak.

### 6.3.3. Struktura gjinore dhe nacionale e klientëve në Shtëpinë e Fëmijëve në Shtime

Në Shtëpinë e Fëmijëve me Bazë në Komunitet në Shtime, në muajin dhjetor 2019 ishin të strehuar 10 klientë, nga të cilët 4 klientë apo 40% ishin të gjinisë mashkullore, ndërsa 6 klientë apo 60% ishin të gjinisë femërore. *Shih tabelën 5:*

*Tabela 5: Struktura gjinore dhe nacionale e klientëve në Shtëpinë e Fëmijëve - Shtime, dhjetor 2019*

| **Nacionaliteti** | **Shqiptar** | | **Serb** | | **Mysliman** | | **Kroat** | | **Rom** | | **Hungarez** | | **Turq** | | **Total** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjinia | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | |
| Numri | 3 | 6 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **10** |
| **Totali** | **9** | | **0** | | **0** | | **0** | | **1** | | **0** | | **0** | | |

Bazuar në tabelën e mësipërme konstatohet se nga 10 klientët e vendosur në Shtëpinë e Fëmijëve në Shtime, 9 kilentë apo 90% janë shqiptar, ndërsa 1 klient apo 10% janë të nacionalitetit rom. Për më tepër, shih figurën më poshtë:

*Figura 27: Struktura nacionale e klienteve në Shtëpinë e Fëmijëve-Shtime, dhjetor 2019*




Në muajin dhjetor 2018 në ISSH ishin të vendosur 67 klientë. Atëherë del që në vitin 2019 kemi një rënie për 3 klientë më pak, apo minus 5% më pak në krahasim me të dhënat e njëjta të vitit paraprak.

## 6.4. Skema për Përkrahje Materiale të Familjeve me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përhershme

Skema për Përkrahje Materiale të Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme nga mosha 1-18 vjeç (FFAKP) në Kosovë, për herë të parë ka filluar të funksionojë në muajin qershor të vitit 2009, ndërsa pagesa është bërë në mënyrë retroaktive nga 01.01.2009. Kjo Skemë është skemë publike, universale dhe e financuar nga fondet publike, e cila është ngritur më qëllim të mbështetjes materiale për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme.

Skema e FFAKP-së rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-22 për Përkrahje Materiale të Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme. E drejta për të përfituar nga kjo Skemë u takon fëmijëve më aftësi të kufizuara të përhershme të moshës 1-18 vjeçare, që janë qytetarë të Republikës së Kosovës, janë me aftësi të kufizuara të përhershme, që nuk mund të lëvizin në mënyrë të pavarur dhe t'i kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore dhe për këta persona është i nevojshëm kujdesi 24 orësh. Shuma materiale për një fëmijë është 100 euro në muaj.

### 6.4.1. Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së, sipas muajve

Në muajin dhjetor 2019, nga Skema e FFAKP-së kanë përfituar 2.276 fëmijë. Po të krahasohet ky numër me numrin e fëmijëve që kanë përfituar në muajin janar 2019, konstatojmë që në muajin dhjetor 2019 numri i fëmijëve përfitues është rritur për 113 fëmijë më shumë, apo plus 5%.

Gjithashtu, edhe shuma e mjeteve e muajit dhjetor 2019 në krahasim me atë të muajit janar 2019, ka shënuar rritje plus 59,600 euro, apo 22% më shumë. *Për më tepër shih tabelën më poshtë:*

*Tabela 6: Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së, 2019*

| Muaji | Numri i fëmijëve | Shuma e mjeteve |
|---|---|---|
| Janar | 2.163 | 216,800.00 € |
| Shkurt | 2.137 | 214,100.00 € |
| Mars | 2.217 | 262,800.00 € |
| Prill | 2.180 | 219,500.00 € |
| Maj | 2.158 | 219,000.00 € |
| Qershor | 2.124 | 212,900.00 € |
| Korrik | 2.103 | 211,300.00 € |
| Gusht | 2.088 | 209,100.00 € |
| Shtator | 2.193 | 281,100.00 € |
| Tetor | 2.177 | 224,400.00 € |
| Nëntor | 2.180 | 227,900.00 € |
| Dhjetor | 2.276 | 276,400.00 € |
| **Totali:** | | **2,775,300.00 €** |

Bazuar në tabelën e mësipërme, konstatohet se në muajin dhjetor 2019, kemi numrin më të madh të fëmijëve përfitues, në këtë muaj kanë përfituar 2.276 fëmijë ndërsa numri më i vogël i fëmijëve përfitues, është shënuar në muajin gusht 2019, në këtë muaj kanë përfituar 2.088 fëmijë. *Shih figurën më poshtë:*

*Figura 28: Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së, 2019*



Në muajin dhjetor 2018 nga Skema e FFAKP-së kanë përfituar 2.206 fëmijë. Andaj, konstatojmë se në muajin dhjetor 2019, kemi një rritje prej 70 fëmijëve përfitues më shumë, apo plus 3% në krahasim me të dhënat e njëjta të vitit paraprak.

### 6.4.2 Buxheti i shpenzuar për Skemën e FFAKP-së

Sa i përket shumës së mjeteve të procesuara edhe këtu kemi ngritje dhe rënie. Bazuar në tabelën e mësipërme konstatohet se në muajin shtator 2019 është procesuar shuma më e madhe. Në këtë muaj janë procesuar 281,100 euro, ndërsa shuma më e vogël është procesuar në muajin gusht 2019, në këtë muaj janë procesuar 209,100 euro. Buxheti i shpenzuar për pagesën e Skemës së FFAK-së për vitin 2019 është 2,775,300 euro. *Për më tepër shih figurën më poshtë:*

*Figura 29: Shuma e mjeteve të procesuar për pagesën e Skemës së FFAKP-së, 2019*




Buxheti i shpenzuar për pagesën e Skemës së FFAKP-së për vitin 2018 ka qenë 2,973,200 euro. Andaj, konstatojmë se buxheti i shpenzuar për vitin 2019, ka shënuar rënie për 197,900 euro më pak, apo minus 7% në krahasim me të dhënat e njëjta të vitit paraprak.

### 6.4.3. Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së sipas vijueshmërisë së procesit mësimor

Përmes Bazës së të Dhënave, nga viti 2017 ka filluar të bëhet përcjellja e vijueshmërisë së procesit mësimor nga ana e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët janë përfitues të Skemës së FFAKP-së.

Bazuar në të dhënat e kësaj baze, konstatohet se nga totali prej 2.276 fëmijëve me aftësi të kufizuara përfitues të Skemës, në kopsht janë 39 fëmijë apo 2%, në institucionet parashkollore 234 fëmijë apo

10%, në institucionet shkollore fillore 376 fëmijë apo 17%, në shkollë të mesme 7 fëmijë apo 0.31%, ndërsa që nuk e vijojnë mësimin janë 1.620 fëmijë apo 71%.

*Tabela 7: Numri i fëmijëve sipas vijueshmërisë së procesit mësimor, 2019*

| Numri | Në kopësht | Në arsim parashkollor | Në arsim fillor | Në arsim të mesëm | Nuk janë në shkollë | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 39 | 234 | 376 | 7 | 1.620 | 2.276 |
| % | 1.71% | 10.28% | 16.52% | 0.31% | 71.18% | 100% |

*Figura 30: Fëmijët përfitues të FFAKP-së sipas vijueshmërisë së procesit mësimor, 2019*




## 6.5. Numri i kërkesave të shqyrtuara për paaftësi nga Komisioni i Shkallës I

Gjatë vitit 2019, Komisioni Mjekësor i Shkallës së Parë ka vlerësuar/shqyrtuar 909 kërkesa të familjeve që kanë aplikuar për të përfituar nga Skema e FFAKP-së. Nga ky total, 382 kërkesa apo 42% janë aprovuar, 320 kërkesa apo 45% janë refuzuar, 138 kërkesa apo 15% janë kthyer për plotësim dhe 69 kërkesa/aplikantë apo 8%, nuk janë paraqitur në seancë. *Shih figurat 31 dhe 32:*

*Figura 31: Numri i kërkesave të shqyrtuara nga Komisioni Mjekësor i Shkallës I, 2019*




*Figura 32: Kërkesat e shqyrtuara nga Komisioni Mjekësor i Shkallës I, me përqindje*




Gjatë vitit 2018, Komisioni i Shkallës së Parë, në total ka shqyrtuar 783 kërkesa. Andaj, konstatojmë se gjatë vitit 2019, kemi një rritje të numrit të kërkesave të shqyrtuara nga ana e komisionit për 126 kërkesa më shumë, apo plus 14%.

## 6.6. Numri i ankesave të shqyrtuara për paaftësi nga Komisioni i Shkallës II

Edhe Komisioni i Shkallës II, gjatë vitit 2019 ka vazhduar punën e vet. Gjatë vitit 2019, ky Komision ka shqyrtuar 131 ankesa, nga të cilat 21 ankesa apo 16% janë aprovuar, 81 ankesa apo 62% janë refuzuar, dhe 29 apo 22% e ankesave janë kthyer për plotësim. *Shih figurat 32 dhe 33:*

*Figura 33: Numri i ankesave të vlerësuara nga Komisioni Mjekësor i Shkallës II, 2019*




*Figura 34: Ankesat e vlerësuara nga Komisioni Mjekësor. shkalla II-të, me përqindje*




Gjatë vitit 2018, Komisioni i Shkallës së Dytë në total ka shqyrtuar 193 ankesa. Andaj, konstatojmë se gjatë vitit 2019, kemi një rënie të numrit të ankesave të shqyrtuara nga ana e këtij Komisioni për 63 ankesa më pak, apo minus 47%.

# 7. DIVIZIONI I NDIHMËS SOCIALE

## 7.1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Ndihmës Sociale

Divizioni i Ndihmës Sociale (DNS) funksionon dhe vepron në kuadër të Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes (DPSF), gjegjësisht, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), i cili ka për detyrë që në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare të grumbullojë dhe analizojë të dhëna mbi gjendjen shoqërore dhe ekonomike në Kosovë, veçmas, në vlerësimin e varfërisë dhe marrjen e hapave konkret  në zbutjen e saj. Tërë këtë punë, DNS-ja e zhvillon në bazë të politikave dhe strategjive të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Strategjisë Sektoriale të MPMS-së, Planit dhe Programit të punës së DPSF/DNS-së, dhe është përgjegjëse për planifikimin, organizimin dhe monitorimin e tërë Skemës së Ndihmës Sociale (ndihmat sociale, ndihmat emergjente dhe subvencionet e tjera për të ndihmuar familjet në nevojë sociale dhe ekonomike). DNS-ja  bën monitorimin dhe mbikëqyrjen e punës profesionale të nëpunësve të Skemës së Ndihmës Sociale (SNS) dhe Qendrave për Punë Sociale (QPS), të cilët i ofrojnë këto shërbime-mbrojtje sociale për familjet e varfra në Kosovë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Ndihmës Sociale, janë:

- ✓ *Propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve të politikave/strategjive për ndihma sociale;*
- ✓ *Grumbullon, analizon dhe raporton për të dhënat mbi varfërinë në Kosovë, në bashkëpunim me institucionet e tjera relevante;*
- ✓ *Propozon, harton dhe siguron zbatimin e legjislacionit për ndihmë sociale;*
- ✓ *Koordinon aktivitetet me institucionet relevante;*
- ✓ *Monitoron procesin e pagesave nga Skema e Ndihmave Sociale dhe harton raporte të rregullta periodike;*
- ✓ *Bashkëpunon me organizata jo-qeveritare për zhvillimin e aktiviteteve;*
- ✓ *Mirëmban sistemin elektronik të të dhënave për aplikuesit-përfituesit e SNS-së.*

Udhëheqësi i Divizionit të Ndihmës Sociale raporton tek Udhëheqësi i Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes. Numri i të punësuarve në këtë Divizion, në fund të vitit 2019 ishte tetë (8) të punësuar.

Divizioni i Ndihmës Sociale  (DNS) përbëhet nga:

- Njësia e Ndihmave Sociale,
- Njësia për Ankesa e Shkallës II, dhe
- Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes.

## 7.2. Struktura Organizative e Skemës së Ndihmës Sociale

Skema e Ndihmës Sociale, është e organizuar në dy nivele:

1. **Niveli qendror:**
    - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS),
    - Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes (DPSF);
2. **Niveli lokal:**

- Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DKSHMS),
- Qendrat për Punë Sociale (38 QPS-së).

## 7.3. Delegimi (Dekoncentrimi) i Skemës së Ndihmës Sociale

Delegimi dhe përcaktimi i përgjegjësive të nivelit qendror (MPMS-DPSF) dhe nivelit lokal (komuna-DKSHMS-QPS) për Skemën e Ndihmës Sociale, gjegjësisht, dekoncentrimi i SNS-së ka ndodhë në janar të vitit 2009 dhe është bërë në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; Marrëveshjen e Mirëkuptimit për bartjen e kompetencave të shërbimeve sociale dhe delegimin e përgjegjësive të ndihmave sociale në nivel komunal; Udhëzimin Administrativ Nr.01/2010 për procedurat lidhur me delegimin e përgjegjësive për Skemën e Ndihmës Sociale në nivel komunal. Këtë proces të bartjes së përgjegjësive dhe dekoncentrimin e Skemës së Ndihmës Sociale e kanë marrë përsipër MPMS-ja, Ministria e Financave (MF), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Komunat.

## 7.4. Përgjegjësitë e nivelit qendror - MPMS-së për Skemën e Ndihmës Sociale

Përgjegjësitë e nivelit qendror - MPMS-së për Skemën e Ndihmës Sociale, janë:

- ✓ *Hartimi i politikave dhe planeve strategjike për zhvillimin dhe funksionimin e Skemës së Ndihmës Sociale;*
- ✓ *Hartimi i infrastrukturës ligjore dhe rregullave nacionale për Skemën e Ndihmës Sociale;*
- ✓ *Hartimi i standardeve minimale për ofrim të shërbimeve për ndihma sociale;*
- ✓ *Monitorimi, kontrollimi dhe inspektimi i cilësisë së këtyre shërbimeve, zbatimin e Ligjit dhe rregullave nacionale për SNS-në;*
- ✓ *Në bashkëpunim me MF-në planifikon dhe alokon mjetet e nevojshme buxhetore për pagesat e ndihmave sociale, sipas kërkesave të komunave-QPS-ve;*
- ✓ *Në rrethana të veçanta, kur niveli komunal (DKSHMS-QPS) nuk përmbush standardet minimale për ofrimin e ndihmave sociale, atëherë MPMS-ja mund ta kthejë përgjegjësinë e deleguar, për aq kohë sa e shef të nevojshme (jo më tepër se një vit).*

## 7.5. Përgjegjësitë e nivelit komunal për Skemën e Ndihmës Sociale

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka caktuar Qendrat për Punë Sociale për të administruar Skemën e Ndihmës Sociale.[3] Aktualisht në çdo komunë të Kosovës ka nga një QPS, gjithsej 38 QPS, mirëpo me qëllim që këto shërbime të jenë edhe më afër qytetarëve, funksionojnë edhe dy njësi: Kodra e Trimave dhe Kodra e Diellit në Prishtinë (QPS-të në Prishtinë); dhe pesë (5) nënzyra: Gorazhdec (Pejë); Prilluzhë (Vushtrri); Qabër (Zubin Potok); Lipa-Kelmend (Zveçan) dhe Cerajë (Leposaviq).

Përgjegjësitë e nivelit lokal, janë:

- ✓ *Të themelojnë dhe mirëmbajnë Qendrat për Punë Sociale, të cilat mund të kenë një apo më shumë degë;*
- ✓ *Të vlerësojnë dhe identifikojnë nevojat në nivel komunal;*
- ✓ *Të menaxhojnë me asetet dhe stafin e QPS-së;*
- ✓ *Të zbatojnë infrastrukturën ligjore, rregullat nacionale dhe standardet minimale për ofrimin e shërbimeve për ndihma sociale;*
- ✓ *Të ofrojnë kushte, të dhëna dhe dokumentacion për kontroll dhe inspektim të Shërbimit të SNS-së për Njësinë e Auditorit të Brendshëm (NJAB) dhe Njësinë e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes (NJKM);*
- ✓ *Të pranojnë, shqyrtojnë dhe nxjerrin aktvendime për njohjen apo mosnjohjen e të drejtës së parashtruesve të kërkesës për ndihmë sociale;*
- ✓ *Të hartojnë plane dhe raporte mujore, periodike dhe vjetore për SNS-në, të cilat i shqyrtojnë dhe miratojnë DPSF/MPMS-në;*
- ✓ *Të ndajnë buxhet të mjaftueshëm për funksionimin normal të QPS-ve.*

### 7.5.1. Administrimi i SNS-së në nivelin komunal

Shërbimet e ndihmës sociale brenda Qendrave për Punë Sociale, të caktuara për të administruar Skemën e Ndihmës Sociale, menaxhohen nga udhëheqësi i shërbimit të ndihmës sociale, i cili zgjidhet nga komuna, në bashkëpunim me Ministrinë.[4]

Udhëheqësi i Skemës së Ndihmës Sociale për realizimin e detyrave dhe përgjegjësive, i përgjigjet drejtorit (drejtorisë përkatëse) në komunë dhe i raporton Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.[5]

---

[3] Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë.

[4] Ligji Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, paragrafi 3.2

Autoriteti përgjegjës për zhvillimin e proceduarve, përgatitjen e lëndës, verifikimin e gjendjes socio-ekonomike dhe përzgjedhjen apo refuzimin e familjes në Skemën e Ndihmës Sociale është nëpunësi i Skemës së Ndihmës Sociale (menaxheri i rastit), ndërsa përgjegjësinë për vendimmarrje e ka udhëheqësi i Shërbimit të Skemës së Ndihmës Sociale.[6]

Ministria në rast të konstatimit të shkeljeve të rënda të administrimit të Skemës së Ndihmës Sociale, mund ta marrë në administrim të drejtpërdrejtë Skemën e Ndihmës Sociale në atë komunë, për një periudhë jo më të gjatë se një (1) vit.[7]

## 7.6. Kriteret - kushtet për të realizuar ndihmën sociale

Skema e Ndihmës Sociale në Kosovë**,** për herë të parë është prezantuar në vitin 2000 dhe është rishqyrtuar më vitin 2003 dhe 2012. Skema është publike, universale dhe e financuar nga fondet publike. Kjo skemë është ngritur më qëllim të mbështetjes dhe ofrimit të ndihmës së përkohshme financiare për familjet që janë në varfëri.[8]

Skema e Ndihmës Sociale në Kosovë rregullohet me Ligjin bazë Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, me Ligjin Nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, dhe me një numër të caktuar të Udhëzimeve Administrative, të cilat janë përmendur te pjesa e infrastrukturës ligjore (aktet nënligjore) të Skemës së Ndihmës Sociale.

Bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë SNS-në, për të realizuar të drejtën në ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës, përjashtimisht, edhe shtetasit e huaj të cilët:

*a) kanë leje qëndrimi,*

*b) personat në cilësinë e azilkërkuesit,*

*c) personat në cilësinë e refugjatit, dhe*

*d) personat të cilët gëzojnë mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese, dhe t`i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërën prej kategorive vijuese:*

**Kategoria e parë -** Familja në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar; dhe

[5] Po aty, neni 3, paragrafi 3.3
[6] Po aty, neni 3, paragrafi 3.5
[7] Po aty, neni 3, pargrafi 3.4
[8] Po aty, neni 1

**Kategoria e dytë** - Familja me një anëtar të aftë për punë, me të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeç apo që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën 15 vjeç.

Përveç këtyre kritereve bazë, familjet (e të dy kategorive I dhe II) për të përfituar ndihmën sociale, nuk duhet të kenë në pronësi më shumë 0.5 hektarë tokë, të hyra financiare dhe të mira materiale të llogaritshme, ashtu siç është e përcaktuar me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë Skemën e Ndihmës Sociale.

*Kutia 1- Nocioni "**familje**" dhe "**bashkësi familjare**" sipas Ligjit për Skemën e Ndihmës Sociale*

**Sipas Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, neni 2, paragrafi 2.1, thuhet:**

**"Familja"** - përbëhet prej atyre personave, nevojat e të cilëve merren parasysh me rastin e vendosjes së përzgjedhshmërisë dhe shumës së ndihmës sociale, dhe përkufizohet si një bashkësi që përbëhet prej paraqitësit të kërkesës ose marrësit të ndihmës dhe të gjithë anëtarëve të tjerë të familjes, të cilët janë në bashkësi familjare: bashkëshorti/ja e tij /saj ose partnerët që jetojnë bashkë, prindërit dhe fëmijët, përfshirë fëmijët e birësuar (bijëzuar) fëmijët në strehim familjar apo fëmijët e njërit partner. Prandaj, familja mund të përbëhet nga paraqitësi i kërkesës ose marrësit të ndihmës dhe një, dy, tre, a më shumë anëtarëve që jetojnë në një bashkësi familjare. Individi pa asnjë anëtar tjetër të familjes në bashkësinë familjare, sipas këtij Ligji, konsiderohet një familje.

**Ndërsa në paragrafin 2.4 të po këtij neni thuhet:**

**"Bashkësia familjare" -** përkufizohet si një grup individësh që jetojnë bashkë nën një kulm dhe që bashkërisht ndajnë shpenzimet e jetesës. Sipas këtij Ligji, bashkësia familjare mund të përfshijë personat që nuk janë anëtarë të familjes.

Personat që kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe që kanë mbaruar shkollimin e mesëm, konsiderohen si të aftë për punë dhe në gjendje për të punuar edhe nëse vazhdojnë shkollimin e rregullt në universitet ose në ndonjë program trajnues.[9]

Personat që: a) banojnë; ose b) janë në institucione të tipit të mbyllur, si: institucionet psikiatrike, shtëpitë e pleqve, institucionet religjioze, shkollat rezidenciale dhe burgjet, nuk mund të përfitojnë ndihmë sociale, sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore të Skemës së Ndihmës Sociale.

Autoriteti përgjegjës për zhvillimin e procedurave, përgatitjen e lëndës, verifikimin e gjendjes socio-ekonomike dhe përzgjedhjen apo refuzimin e familjes në Skemën e Ndihmës Sociale, është nëpunësi i Skemës së Ndihmës Sociale (menaxheri i rastit), ndërsa përgjegjësinë për vendimmarrje e ka udhëheqësi i Shërbimit të Skemës së Ndihmës Sociale[10], do të thotë niveli lokal - Qendra për Punë

[9] Po aty, Neni 4, paragrafi 4.10
[10] Ligji Nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, Neni 3, paragrafi 3.5

Sociale në komunën përkatëse. Ndërsa, niveli qendror (MPMS) harton politikat dhe strategjitë, infrastrukturën ligjore, ushtron kontroll dhe mbikëqyrje dhe siguron buxhetin për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë.

Shuma mujore e ndihmës sociale për një familje përcaktohet sipas numrit të pikave, numrit të anëtarëve të familjes dhe kostos së çmimeve të konsumit të shportës së ushqimit, e cila rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministria[11]. Kjo i bie që personi i vetëm – familja njëanëtarëshe merr 60 euro në muaj (minimalja), dhe familja me 15 anëtarë (maksimalja) për një muaj merr 180 euro në muaj.[12] Përveç ndihmës bazë “familja e përzgjedhur për Skemën e Ndihmës Sociale për çdo fëmijë të moshës zero (0) e deri në tetëmbëdhjetë 18 vjeç”, realizon një përfitim financiar prej 5 eurosh si shtesë për fëmijë, me qëllim të nxitjes së arsimimit dhe përmirësimit të shëndetit.[13]

Kohëzgjatja e shfrytëzimit të ndihmës sociale për familjet në Kategorinë I është 12 muaj[14], ndërsa për familjet në Kategorinë II është gjashtë muaj, me kusht që gjatë gjithë kësaj periudhe familjet në Kategorinë e I dhe të II, të jenë të përzgjedhshme, ashtu siç është paraparë me dispozita ligjore dhe nënligjore të SNS-së.

*Çdo individ apo familje që e konsideron se i/e plotëson kriteret për ndihmë sociale dhe ka nevojë për informacione shtesë për Skemën e Ndihmës Sociale, mund t’i drejtohet Qendrës për Punë Sociale në komunën përkatëse.*

## 7.7. Numri i familjeve dhe anëtarëve të familjes në SNS

Bazuar në legjislacionin në fuqi për SNS-në, gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2019, nëpunësit dhe udhëheqësit e SNS-së, kanë qenë të përkushtuar që të zbatojnë aktet ligjore dhe nënligjore, me të cilat rregullohet Skema e Ndihmës Sociale në Kosovë, përkatësisht, në zbatimin Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, Ligjin Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, si dhe të Udhëzimeve Administrative për këtë Skemë.

Sipas kushteve dhe kritereve që parashihen me aktet ligjore dhe nënligjore të Skemës së Ndihmës Sociale, ndihmën sociale për periudhën raportuese (janar-dhjetor 2019), e kanë realizuar numri i familjeve si më poshtë: Shih tabelën 8:

---

[11] Po aty, neni 8, paragrafi 9.1.

[12] Vendimi nr.15/24 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, dt.12.01.2018.

[13] Ligji Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, neni 9 A.

[14] Po aty, neni 7, paragrafi 1.

*Tabela 8: Numri i familjeve - anëtarëve të familjes të përfshirë në SNS, 2019*

| Muaji | Numri i familjeve | Numri i anëtarëve të familjes | Shuma e procesuar |
|---|---|---|---|
| Janar | 25,186 | 102,596 | 2,684,862.50 € |
| Shkurt | 25,192 | 102,712 | 2,662,885.00 € |
| Mars | 26,995 | 102,035 | 2,667,502.50 € |
| Prill | 24,964 | 101,855 | 2,671,142.50 € |
| Maj | 24,884 | 101,535 | 2,652,285.00 € |
| Qershor | 24,767 | 100,995 | 2,634,275.00 € |
| Korrik | 24,608 | 100,427 | 2,614,485.00 € |
| Gusht | 24,562 | 100,044 | 2,611,070.00 € |
| Shtator | 24,526 | 99,718 | 2,603,022.50 € |
| Tetor | 24,465 | 99,407 | 2,592,857.50 € |
| Nëntor | 24,195 | 98,169 | 2,565,617.50 € |
| Dhjetor | 24,352 | 98,756 | 2,582,340.00 € |
| **Totali:** | | | **31,542,345.00 €** |

Nëse i krahasojmë të dhënat e vitit 2019 me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (dhjetor 2018), ku numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale në nivel vendi ishte: 25.345 familje, me 103.399 anëtarë të familjes, me shumë mujore 2,373,381.25 euro, konstatohet se në vitin 2019 numri i familjeve në Skemën e Ndihmës Sociale është zvogëluar, ka rënë për 992 familje më pak apo minus 4%, numri i anëtarëve të familjes ka rënë për 4.643 anëtarë të familjes më pak, apo minus 5% dhe shuma e mjeteve të procesuara për pagesën e ndihmës sociale ka rënë për 1,316,300 euro më pak, apo minus 4%.

Numri më i madh i familjeve në SNS gjatë vitit 2019 është shënuar në muajin mars, me 26,995 familje, kurse numri më i vogël i familjeve në SNS është shënuar në muajin nëntor, me 24.195 familje.

Nëse iu referohemi të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), nga regjistrimi i fundit i popullsisë dhe ekonomive familjare në Kosovë, del se në Kosovë jetojnë 1.820.631 banorë, të shpërndarë në 308.212 ekonomi familjare.

Andaj, nëse krahasohet numri i familjeve në Skemën e Ndihmës Sociale (24,352 familje-dhjetor 2019) me numrin e ekonomive familjare në Kosovë (308.212), rezulton se 26.995 ose 8% të familjeve në Kosovë janë përfshirë në Skemën e Ndihmës Sociale. Ndërsa, nëse krahasohet numri i anëtarëve të familjes në Skemën e Ndihmës Sociale (98.756 anëtarë-dhjetor 2019) me numrin e popullsisë në Kosovë (1.820.631 banorë), rezulton se 5% e popullsisë në Kosovë shfrytëzojnë ndihmë sociale.

Numri i familjeve dhe anëtarëve të tyre në Skemën e Ndihmës Sociale, për periudhën janar-dhjetor 2019 është paraqitur në tabelën 8 dhe figurat 35 dhe 36:

Figura 35: Numri i familjeve të përfshira në SNS, 2019




Figura 36: Numri i anëtarëve të familjeve të përfshirë në SNS, 2019




Po të krahasohet shuma e mjeteve të procesuara sipas muajve gjatë vitit 2019, konstatohet se në muajin janar 2019 është procesuar shuma më e madhe e mjeteve për të paguar shumën e ndihmë sociale. Në këtë muaj janë procesuar 2,684,862.50 euro, ndërsa shuma më e vogël e mjeteve është procesuar në muajin nëntor, në këtë muaj janë procesuar 2,565,617.50 euro. Për më tepër shih figurën më poshtë:

*Figura 37: Pagesat e ndihmës sociale sipas muajve, 2019*




Bazuar në tabelën e mësipërme konstatohet se në muajin dhjetor kemi një rënie të shumës së mjeteve të procesuara në rahasim me muajin janar për 102,522.50 euro më pak, apo minus 4%.

### 7.7.1. Numri i familjeve-anëtarëve të familjes në SNS, sipas komunave/QPS-ve

Në figurën më poshtë është paraqitur numri i familjeve sipas Qendrave për Punë Sociale/komunave, përfituese të Skemës së Ndihmës Sociale në muajin dhjetor 2019. Nga figura, konstatohet se numrin më të madh të familjeve në SNS e ka komuna/QPS-ja e Mitrovicës me 2.337 familje, ndërsa komuna/QPS me numrin më të vogël të familjeve në SNS është komuna-QPS-ja e Mamushës me 20 familje. Shih figurën më poshtë:

*Figura 38: Numri i familjeve në SNS, sipas komunave/QPS-ve, dhjetor 2019*



## 7.7.2. Familjet në SNS sipas numrit të anëtarëve të familjes

Nga gjithsej 24.352 familjet, me 98.756 anëtarë të familjes në SNS, sa ishin në dhjetor 2019, numrin më të madh e përbëjnë familjet 4 anëtarëshe me 5.708 familje apo 23%, familjet 5 anëtarëshe me 5.053 familje apo 21%, familjet tri anëtarëshe me 3.794 apo 16%, e kështu me radhë. Ndërsa, numrin më të vogël të familjeve e përbëjnë familjet 13 anëtarëshe gjithsej 3 familje apo 0.01%, familjet 12 anëtarëshe me 5 familje apo 0.02% e kështu me radhë. Shih tabelën 9 dhe figurën 38:

*Tabela 9: Familjet në SNS, sipas numrit të anëtarëve të familjes, dhjetor 2019*

| Familjet sipas numrit të anëtarëve | Numri i familjeve | % |
|---|---|---|
| Familjet me 1 anëtar | 1,836 | 7.54 |
| Familjet me 2 anëtarë | 3,277 | 13.46 |
| Familjet me 3 anëtarë | 3,794 | 15.58 |
| Familjet me 4 anëtarë | 5,708 | 23.44 |
| Familjet me 5 anëtarë | 5,053 | 20.75 |
| Familjet me 6 anëtarë | 2,914 | 11.97 |
| Familjet me 7 anëtarë | 1,110 | 4.56 |
| Familjet me 8 anëtarë | 419 | 1.72 |
| Familjet me 9 anëtarë | 162 | 0.67 |
| Familjet me 10 anëtarë | 57 | 0.23 |
| Familjet me 11 anëtarë | 14 | 0.06 |
| Familjet me 12 anëtarë | 5 | 0.02 |
| Familjet me 13 anëtarë | 3 | 0.01 |
| **TOTALI:** | **24,352** | **100.00** |

*Figura 39- Familjet në SNS sipas numrit të anëtarëve të familjes, 2019*



### 7.7.3. Bartësit e ndihmës sociale, sipas kategorive dhe strukturës gjinore

Nga gjithsej 24.352 familjeve sa ishin në SNS (dhjetor 2019), 16.728 ose 69% e familjeve ishin në Kategorinë e Parë (I), ndërsa 7.624 familje ose 31% ishin në Kategorinë e Dytë (II) të SNS-së. *Shih tabelën 10 dhe figurën 39.*

*Tabela 10: Bartësit e ndihmës sociale sipas kategorive dhe strukturës gjinore, dhjetor 2019*

| TOTAL | | | Kategoria I | | | Kategoria II | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| M | F | Total | M | F | Total | M | F | Total |
| 16,100 | 8,252 | 24,352 | 9,154 | 7,574 | 16,728 | 6,946 | 678 | 7,624 |
| 66.11% | 33.89% | | 54.72% | 45.28% | | 91.11% | 8.89% | |

Struktura gjinore e bartësve të ndihmës sociale, në të dy kategoritë e SNS-së në dhjetor 2019 ishte: 8.252 apo 34% të bartësve të ndihmës sociale ishin femra, dhe 16.100 apo 66% të bartësve të ndihmës sociale ishin meshkuj. Në Kategorinë I të SNS-së: 7.574 ose 45% ishin femra dhe 9.154 apo 55% ishin meshkuj. Ndërsa në Kategorinë II ishin: 678 ose 9% femra dhe 6.946 apo 91% meshkuj.

*Figura 40: Përqindja e familjeve në SNS sipas kategorive, dhjetor 2019*



*Figura 41: Bartësit e ndihmës sociale sipas kategorive dhe strukturës, dhjetor 2019*




## 7.7.4. Struktura e statusit të bartësve të ndihmës sociale në SNS

Bazuar në kriterin-statusin bazë të bartësit të ndihmës sociale, numrin dhe përqindjen më të lartë e përbën kriterin 8 - i papunësuar, me gjithsej 7.192 apo 30%; pastaj bartësit me kriterin 7- person mbi 18 vjeç, i paaftë për punë mbi 80%, me 6.424 apo me 26%; bartësit me kriterin 9-kujdestar, me 6.254 apo me 26%; bartësit me kriterin 6-prind vetushqyes, me 2.293 apo 9%, e kështu me radhë. Ndërsa numrin më të vogël e përbëjnë bartësit me kriterin 19-kujdestar (*person me pension bazë)*, vetëm 6 bartës apo me 0.02%. Shih tabelën 11:

*Tabela 11: Bartësit e ndihmës sociale sipas statusit, dhjetor 2019*

| Kriteri | Meshkuj | Femra | Total | % |
|---|---|---|---|---|
| 5 - Person i moshës 15-18 vjeç, në shkollim të rregullt | - | 1 | 1 | 0.00 |
| 6 - Prind vetushqyes | 404 | 1,889 | 2,293 | 9.42 |
| 7 - Person mbi 18 vjeç, i paaftë për punë mbi 80% | 4,451 | 1,973 | 6,424 | 26.38 |
| 8 - I papunësuar | 6,900 | 292 | 7,192 | 29.53 |
| 9 – Kujdestar | 3,371 | 2,883 | 6,254 | 25.68 |
| 10 - Person me Pension të Aftësisë së Kufizuar (PPAK) | 196 | 30 | 226 | 0.93 |
| 15 - Person me Pension Bazë (PB) | 78 | 19 | 97 | 0.40 |
| 18 – Kujdestar – Person me Pension të Aftësisë së Kufizuar (PPAK) | 9 | 2 | 11 | 0.05 |
| 19 - Kujdestar - Person me Pension Bazë (PB) | 4 | 2 | 6 | 0.02 |
| 21 - Person i vetëm - Person mbi 18 vjeç, i paaftë për punë mbi 80% | 687 | 1,161 | 1,848 | 7.59 |
| **TOTAL:** | **16,100** | **8,252** | **24,352** | **100** |

### 7.7.5. Struktura nacionale e familjeve në ndihmë sociale

Kosova është e angazhuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili garanton të drejtat, lirinë qytetare dhe barazinë para ligjit për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë. Kushtetuta e Kosovës përcakton se "të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose tjetër, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar apo ndonjë statusi tjetër personal".[15]

Përveç kësaj, për të siguruar barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve, Kushtetuta inkurajon miratimin e masave adekuate (p.sh. diskriminimin pozitiv) në favor të grupeve të rrezikuara dhe të margjinalizuara në shoqëri.

Të drejtën për shfrytëzimin e ndihmës sociale në Republikën e Kosovës e kanë të gjithë individët/familjet që jetojnë në varfëri dhe që i plotësojnë kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi. Andaj, për të paraqitur strukturën nacionale të familjeve në Skemën e Ndihmës Sociale, po japim të dhënat e muajit dhjetor 2019, të cilat me numër dhe përqindje janë të përafërta edhe me muajt e tjerë të këtij viti. Shih tabelën 12:

*Tabela 12: Struktura nacionale e familjeve në SNS, dhjetor 2019*

| Nacionaliteti | Numri i familjeve | % | Numri i anëtarëve | % | Shuma | % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shqiptar | 18,648 | 76.58 | 78,049 | 79.03 | 2,008,600.00 | 77.79 |
| Serb | 2,387 | 9.80 | 6,040 | 6.12 | 204,380.00 | 7.91 |
| Rom | 978 | 4.02 | 4,390 | 4.45 | 110,165.00 | 4.27 |
| Ashkali | 1,393 | 5.72 | 6,731 | 6.82 | 163,127.50 | 6.32 |
| Egjiptian | 371 | 1.52 | 1,813 | 1.84 | 43,690.00 | 1.69 |
| Turk | 67 | 0.28 | 193 | 0.20 | 5,915.00 | 0.23 |
| Boshnjak | 247 | 1.01 | 779 | 0.79 | 22,575.00 | 0.87 |
| Malazez | 3 | 0.01 | 6 | 0.01 | 257.50 | 0.01 |
| Kroat | 14 | 0.06 | 40 | 0.04 | 1,292.50 | 0.05 |
| Goran | 178 | 0.73 | 493 | 0.50 | 15,800.00 | 0.61 |
| Të tjera- | 66 | 0.27 | 222 | 0.22 | 6,437.50 | 0.25 |
| **TOTAL:** | **24,352** | **100** | **98,756** | **100** | **2,582,240.00** | **100** |

Bazuar në tabelën e mësipërme konstatohet se numrin dhe përqindjen më të madhe e përbëjnë familjet/banorët shqiptarë, me gjithsej 18.648 familje apo 77% dhe me 78.049 anëtarë të familjes apo 79%, pastaj vijnë familjet serbe me 2.387 familje apo 10%.

[15] Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Pra, familjet jo shqiptare në Skemën e Ndihmës Sociale marrin pjesë me 5.704 familje apo me 23% ( 2.387 apo 10% familje serbe dhe 3.317 apo 13% familje të komuniteteve tjera pakicë në Kosovë).

Andaj, bazuar nga statistikat regjistrimit të fundit të popullsisë të ASK-së, se në Kosovë jetojnë 1,739,825 banorë, në 297.090 ekonomi familjare, ku struktura nacionale e popullsisë në Kosovë është 93% shqiptarë, 1.47% serbë dhe 6% të nacionaliteteve të tjera, rezulton që pjesëmarrja e të gjitha nacionaliteteve në Skemën e Ndihmës Sociale ka një shpërputhje me këto të dhëna, ku vërehet një diskriminim pozitiv në favor të ekonomive familjare jo shqiptare në Skemën e Ndihmës Sociale. Kjo shpërputhje përveç diskriminimit pozitiv mund të jetë edhe si shkak dhe pasojë se tek familjet jo shqiptare, veçmas tek ato të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian dhe të komuniteteve të tjera, niveli i varfërisë është më i theksuar. Shih tabelën 12 dhe figurat 42 dhe 43:

*Figura 42: Struktura nacionale e familjeve në SNS, dhjetor 2019*




*Figura 43: Struktura nacionale e anëtarëve të familjeve në SNS, dhjetor 2019*



### 7.7.6. Anëtarët e familjeve në SNS, sipas kategorive dhe strukturës gjinore

Në muajin dhjetor 2018, në Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë ishin gjithsej 24.352 familje, me 98.756 anëtarë të familjeve, nga të cilët 42.619 apo 57% ishin, femra dhe 31.800 apo 43% ishin meshkuj.

Në Kategorinë I ishin 45.049 anëtarë të familjes, nga të cilët 24.387 apo 54% ishin femra dhe 20.670 apo 46% ishin meshkuj.

Në kategorinë II kishte 29.362 anëtarë të familjes, nga të cilët 18.232 apo 62% ishin femra dhe 11.130 apo 38% ishin meshkuj. Shih tabela 13 dhe figurën 44:

*Tabela 13: Anëtarët e familjeve në SNS, sipas kategorive dhe strukturës gjinore*

| TOTAL | | | Kategoria I | | | Kategoria II | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| M | F | Total | M | F | Total | M | F | Total |
| 31,800 | 42,619 | 74,419 | 20,670 | 24,387 | 45,049 | 11,130 | 18,232 | 29,362 |
| 42.72% | 57.28% | | 45.87% | 54.13% | | 37.91% | 62.09% | |

**Në cilësinë e anëtarëve të familjes, në këtë talebë nuk janë të përfshirë edhe bartësit e ndihmave sociale, të paraqitur në tabelën 10.*

*Figura 44: Numri i anëtarëve të familjes sipas kategorive dhe strukturës gjinore, dhjetor 2019*



### 7.7.7. Anëtarët e familjeve në SNS, sipas grup-moshave

Shikuar nga aspekti i strukturës së moshës të anëtarëve të familjes në SNS (dhjetor 2019) rezulton se nga gjithsej 98.756 anëtarë të familjes në SNS, numrin dhe përqindjen më të madhe e përbëjnë grup-mosha 19-65 vjeç me gjithsej 48.295 anëtarë apo 49% të numrit total të anëtarëve, ndërsa numrin dhe përqindjen më të vogël e përbëjnë  grup-mosha mbi 65 vjeç me gjithsej 1.043 apo 1%.

Mirëpo, nëse kalkulohet mosha e anëtarëve të familjes në SNS nga 0 -18 vjeç, atëherë del që këtë grup-moshë e përbëjnë 49.457 anëtarë apo 50% e numrit total të anëtarëve të familjes në SNS, pra, është grup-mosha me përqindjen më të madhe në Skemë.

Bazuar në këto të dhëna konstatojmë se objekt i analizave dhe shqetësimve për institucionet e politikëbërëse dhe vendimmarrëse në Kosovë, duhet të jetë grupi i moshës 0-18 vjeç në Skemën e Ndihmës Sociale. Shih tabelën 13 dhe  figurën 45:

*Tabela 14: Numri dhe përqindja e anëtarëve të familjes në SNS sipas grup-moshave, dhjetor 2019*

| Grup-moshat | 0-5 | 6-14 | 15-18 | 19-65 | 65+ | TOTAL |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i anëtarëve në SNS | 14,927 | 24,833 | 9,697 | 48,295 | 1,043 | 98,795 |
| % | 15.115 | 25.14 | 9.82 | 48.88 | 1.06 | 100.00 |

*Figura 45: Anëtarët e familjes në SNS me përqindje sipas grup-moshave, dhjetor 2019*



## 7.8. Shuma mujore e ndihmës sociale

Shuma mujore e ndihmës sociale për familjet në SNS, përcaktohet sipas numrit të pikëve dhe numrit të anëtarëve të familjes dhe kostos së çmimeve të konsumit të shportës së ushqimit, e cila rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria. Lartësia e vlerës së përfitimeve për familje rregullohet me akt nënligjor, me ç 'rast Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nxjerrin vendim për lartësinë e pagesës së shumës mujore për familje. Shuma mujore e ndihmës sociale harmonizohet me indeksin e çmimeve të konsumit të shportës së ushqimit, të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.[16]

Me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 01.11.2015, ndihmat sociale janë rritur për 25%, që i bie minimalja e ndihmës sociale ishte 50 euro, ndërsa maksimalja 150 euro në muaj, kurse me Vendimin nr. 15/24, të dt. 12.01.2018 Qeveria e Republikës së Kosovës, i ka rritur ndihmat sociale për 20%. Pra, që nga 1 janari 2018, ndihma sociale (minimalja) është 60 euro në muaj dhe maksimalja është 180 euro në muaj.[17]

Shuma mujore e ndihmës sociale për një familje përcaktohet sipas numrit të pikave, numrit të anëtarëve të familjes dhe kostos së çmimeve të konsumit të shportës së ushqimit, e cila rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerrë Ministria.[18] Përveç ndihmës bazë, "familja e përzgjedhur për Skemën e Ndihmës Sociale për çdo fëmijë të moshës zero (0) e deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeç, realizon një përfitim financiar në formën e shtesës për fëmijë, me qëllim të nxitjes së arsimimit dhe përmirësimit të shëndetit[19]. Kështu nga tetori i vitit 2012, përveç shumës bazë të ndihmës sociale, familjet në Skemën e Ndihmës Sociale që kanë fëmijë të moshës 0-18 vjeç, marrin edhe nga 5 euro shtesë në emër të arsimimit dhe mbrojtjes shëndetësore.[20] Për më tepër shih tabelën më poshtë:

[16] Ligji Nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, Neni 8, paragrafi 9.1 dhe 9.2 dhe Udhëzimi Administrativ, nr.15/2012 për përllogaritjen e shumës mujore të ndihmës sociale, neni 11, paragrafët 1-7.

[17] Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.15/24, dt. 12.01.2018.

[18] Po aty, neni 8, paragrafi 9.1.

[19] Ligji Nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, Neni 9 A si dhe Udhëzimi Administrativ, Nr.15/2012 për Përllogaritjen e Shumës Mujore të Ndihmës Sociale, neni 12, paragrafët 1-4.

[20] Vendimi i Ministrit të MPMS-së, nr.453, dt. 17.12.2012.

*Tabela 15: Familjet në SNS sipas numrit të anëtarëve, pikëve dhe shumës mujore, dhjetor 2019*

| Familjet sipas numrit të anëtarëve | Numri i pikëve | Shuma në euro |
|---|---|---|
| Familjet me 1 anëtar | 40 | 60.00 |
| Familjet me 2 anëtarë | 55 | 82.50 |
| Familjet me 3 anëtarë | 60 | 90.00 |
| Familjet me 4 anëtarë | 65 | 97.50 |
| Familjet me 5 anëtarë | 70 | 105.00 |
| Familjet me 6 anëtarë | 75 | 112.50 |
| Familjet me 7 anëtarë | 80 | 120.00 |
| Familjet me 8 anëtarë | 85 | 127.50 |
| Familjet me 9 anëtarë | 90 | 135.00 |
| Familjet me 10 anëtarë | 95 | 142.50 |
| Familjet me 11 anëtarë | 100 | 150.00 |
| Familjet me 12 anëtarë | 105 | 157.50 |
| Familjet me 13 anëtarë | 110 | 165.00 |
| Familjet me 14 anëtarë | 115 | 172.50 |
| Familjet me 15 anëtarë | 120 | 180.00 |

### 7.8.1. Rritja e shumës së ndihmës sociale dhe mestarja për anëtarë dhe familje

*Tabela 16: Shuma dhe mesatarja e ndihmës sociale sipas numrit të anëtarëve të familjes (2003, 2009, 2012, 2015 dhe 2019)*

| Familjet sipas numrit të anëtarëve të familjes | Rritja e ndihmës sociale | | | | | Mesatarja e ndihmës sociale | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shuma mujore e ndihmës sociale në € në vitin 2003 | Shuma mujore ndihmës sociale në € pas rritjes nga 5 € për çdo familje 2009 | Shuma e ndihmës sociale në €, pas ndryshimeve të Ligjit të SNS (qershor 2012) | Shuma mujore e ndihmës sociale, në €, pas rritjes prej 25% nga dt. 01.11.2015 | Shuma mujore e ndihmës sociale, në €, pas rritjes prej 20% nga dt. 01.01.2018 | Familjet në SNS sipas nr. të anëtarëve të familjes (dhjetor 2019) | Mesatarja mujore e ndihmës sociale për anëtarë të familjes (dhjetor 2019) | Mesatarja ditore e ndihmës sociale, për anëtarë të familjes (dhjetor 2019) |
| Familje 1 anëtar | 35.00 | 40.00 | 40.00 | 50.00 | 60.00 | 1.836 | 60.00 | 1.97 |
| Familje 2 anëtarë | 50.00 | 55.00 | 55.00 | 68.75 | 82.50 | 3.277 | 41.25 | 1.35 |
| Familje 3 anëtarë | 55.00 | 60.00 | 60.00 | 75.00 | 90.00 | 3.794 | 30.00 | 0.98 |
| Familje 4 anëtarë | 60.00 | 65.00 | 65.00 | 81.25 | 97.50 | 5.708 | 24.37 | 0.80 |
| Familje 5 anëtarë | 65.00 | 70.00 | 70.00 | 87.50 | 105.00 | 5.053 | 21.00 | 0.69 |
| Familje 6 anëtarë | 70.00 | 75.00 | 75.00 | 93.75 | 112.50 | 2.914 | 18.75 | 0.61 |
| Familje 7 anëtarë | 75.00 | 80.00 | 80.00 | 100.00 | 120.00 | 1.110 | 17.14 | 0.56 |
| Familje 8 anëtarë | 75.00 | 80.00 | 85.00 | 106.25 | 127.50 | 419 | 15.93 | 0.52 |
| Familje 9 anëtarë | 75.00 | 80.00 | 90.00 | 112.50 | 135.00 | 162 | 15.00 | 0.49 |
| Familje 10 anëtarë | 75.00 | 80.00 | 95.00 | 118.75 | 142.50 | 57 | 14.25 | 0.46 |
| Familje 11 anëtarë | 75.00 | 80.00 | 100.00 | 125.00 | 150.00 | 14 | 13.63 | 0.44 |
| Familje 12 anëtarë | 75.00 | 80.00 | 105.00 | 131.25 | 157.50 | 5 | 13.12 | 0.43 |
| Familje 13 anëtarë | 75.00 | 80.00 | 110.00 | 137.50 | 165.00 | 3 | 12.69 | 0.41 |
| Familje 14 anëtarë | 75.00 | 80.00 | 115.00 | 143.75 | 172.50 | 0 | 0 | 0 |
| Familje 15 anëtarë | 75.00 | 80.00 | 120.00 | 150.00 | 180.00 | 0 | 0 | 0 |
| Mesatarja | 67.33 | 72.33 | 84.33 | 105.41 | 126.50 | 24.325 | 22.85 € | 0.74 € |

Nëse i referohemi të dhënave të fundit të Bankës Botërore dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 17% e popullsisë në Kosovë jetojnë në nivelin e varfërisë absolute me më pak se 1.82 euro në ditë për një person të rritur dhe 5% e popullsisë jetojnë në nivelin e varfërisë së skajshme me më pak se 1.30 euro në ditë[21], atëherë rezulton se një numër i familjeve në SNS edhe pse marrin ndihmë sociale vazhdojnë të jetojnë nën nivelin e varfërisë.

[21] Raporti i Bankës Botërore dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 2016.

## 7.9. Puna e Njësive-Komisioneve të Divizionit të Ndihmës Sociale

### 7.9.1. Komisioni Mjekësor i Shkallës I-re

Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e parë e realizon familja, në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur sipas përkufizimit të dhënë në nenin 2, pika 2.7 të Ligjit në fuqi, dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar.[22]

Një person do të konsiderohet se është me të meta të rënda dhe aftësi të kufizuara të përhershme, nëse është mbi moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe nën moshën 65 vjeç, dhe është me aftësi të kufizuara fizike apo mendore dhe është i paaftë për punë shpërblyese. Aftësia përherë e kufizuar dhe e meta e rëndë fizike dhe mendore, përkufizohet si aftësia përherë e kufizuar fizike dhe mendore në shkallë jo më pak se 80%, siç është aftësia e kufizuar që e bën personin të paaftë për punë në kohën kur ai paraqet kërkesën dhe për një periudhë vijuese, prej jo më pak se një vit.[23]

Familjet me një apo më shumë anëtarë të paaftë për punë, që paraqesin kërkesë për ndihmë sociale për kategorinë e parë, gjendjen shëndetësore të këtyre anëtarëve e ekzaminon dhe vlerëson Komisioni Mjekësor i Ministrisë. Procedurat e punës, kriteret dhe metodologjia për vlerësim dhe rishikim të nivelit dhe llojit të paaftësisë nga ana e Komisionit Mjekësor, përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.[24]

Komisioni Mjekësor **-** nënkupton një grup ekspertësh mjekësorë, i formuar dhe i miratuar nga Ministria përkatëse e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me qëllim të ekzaminimit dhe përcaktimit të gjendjes shëndetësore, duke përcaktuar shkallën e paaftësisë të çdo personi apo anëtari të familjes, i cili është i përfshirë në realizimin e të drejtave të përcaktuara sipas Ligjit nr. 04/L-096.[25]

Komisionet Mjekësore të Shkallës së Parë dhe të Dytë në MPMS, janë themeluar dhe funksionojnë në kuadër të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MPMS-së, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë Skemën e Ndihmës Sociale.

Në përputhje me Ligjin Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale, Ligjin Nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 3003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2009 për themelimin, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisioneve Mjekësore dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) nr. 11/2013 për Procedurat e Punës së Komisionit Mjekësor për aplikuesit për

[22] Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, neni 2.7 dhe Ligji Nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, neni 4.4.

[23] Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, neni 2.9.

[24] Ligji Nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, neni 6, paragrafi 6.2.

[25] Po aty, neni 2, paragrafi 4.

ndihmë sociale në Kategorinë e Parë, gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, Komisioni Mjekësor i Shkallës I, ka bërë vlerësimin e paaftësisë për punë (jo më pak se 80%) për 21.577 parashtrues të kërkesave për ndihmë sociale në Kategorinë I.

Nga 21.577 kërkesat e parashtruara për vlerësim mjekësor, 19.711 kërkesa ose 91% janë aprovuar ose vlerësuar si të paaftë për punë mbi 80%, 1.303 kërkesa ose 6% janë refuzuar ose janë vlerësuar si të aftë për punë, ndërsa 563 kërkesa ose 3% janë kthyer për plotësim dokumentesh. Shih tabelën 7.15 dhe 7.16, dhe figurat 7.11, 7.12 dhe 7.13:

*Tabela 17: Numri i kërkesave të vlerësuara nga Komisioni Mjekësor i Shkallës I, 2019*

| Muaji | Numri i vlerësimeve të Komisionit Mjekësor të Shkallës I për paaftësi për punë, jo më pak se 80 % | | | Totali |
|---|---|---|---|---|
| | Të aprovuara | Të refuzuara | Në plotësim | |
| Janar | 1,584 | 121 | 56 | 1,761 |
| Shkurt | 2,361 | 132 | 32 | 2,525 |
| Mars | 2,160 | 119 | 38 | 2,317 |
| Prill | 2,277 | 124 | 94 | 2,495 |
| Maj | 1,972 | 118 | 57 | 2,147 |
| Qershor | 1,522 | 93 | 38 | 1,653 |
| Korrik | 1,094 | 79 | 47 | 1,220 |
| Gusht | 1,168 | 94 | 42 | 1,304 |
| Shtator | 897 | 78 | 50 | 1,025 |
| Tetor | 1,303 | 116 | 34 | 1,453 |
| Nëntor | 1,470 | 146 | 32 | 1,648 |
| Dhjetor | 1,903 | 83 | 43 | 2,029 |
| Gjithsej | 19,711 | 1,303 | 563 | 21,577 |
| % | 91.35 % | 6.04 % | 2.61 % | 100 |

Krahasuar me vitin paraprak (2017) numri i kërkesave për vlerësim mjekësor për paaftësi për punë për ndihmë sociale në kategorinë e parë, është shtuar për 652 kërkesa apo 3% më shumë.

*Figura 46: Numri i kërkesave të vlerësuara nga Komisioni Mjekësor i Shkallës I, 2019*




## 7.10. Procesi dhe procedurat e ankimimit për ndihmë sociale

Kërkuesi i ndihmës sociale që është i pakënaqur me aktvendimin zyrtar të organit përkatës, mund të parashtrojë kërkesë me shkrim tek Udhëheqësi i Skemës së Ndihmës Sociale për rishqyrtim të aktvendimit. Kërkesa për rishqyrtim bëhet jo me vonë se pesë (5) ditë nga data e marrjes së aktvendimit. Ajo nuk e humb të drejtën për ankesë në shkallën e dytë në Komisionin për Ankesa në departamentin përkatës të Ministrisë, ndërsa udhëheqësi i Skemës së Ndihmës Sociale në afatin prej dhjetë (10) ditësh e shqyrton kërkesën për rishqyrtim, apo atë e bartë tek organi më i lartë, i cili vendos në lidhje me ankimimin.[26]

### 7.10.1. Njësia/Komisioni i Ankesave i Shkallës II në DNS/DPSF

Kërkuesi i ndihmës, që është i pakënaqur me aktvendimin e organit të shkallës së parë, gjegjësisht, të Qendrës për Punë Sociale-Udhëheqësit të Skemës së Ndihmës Sociale, mund t'i paraqesë ankesë me shkrim Komisionit të Ankesave, si organ i shkallës së dytë, në departamentin përkatës, i cili vepron nën autorizimin e Ministrisë.

[26] Ligji Nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, Neni 10, paragrafi 11.1.

Ankesat dorëzohen jo më vonë së pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e marrjes së aktvendimit nga organi përkatës i QPS-së. Komisioni i ankesave duhet ta shqyrtojë ankesën dhe ta njoftojë me shkrim parashtruesin e ankesës për aktvendimin e pranuar jo më vonë se njëzetenjë (21) ditë, pas marrjes së ankesës.[27]

Njësia për Ankesa dhe Zbatueshmëri të Legjislacionit që vepron në kuadër të DNS/DPSF-së, bën interpretime, sqarime dhe komente profesionale të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë lëmin e ndihmës sociale, shqyrton ankesat e palëve të pakënaqura me vendimet e shkallës së parë, pra QPS-ve. Në kuadër të kësaj njësie vepron Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, si organ i shkallës së dytë, i cili nxjerr vendime dhe direkt i përgjigjet drejtorit të DPSF-së.

Sipas nenit 11, paragrafët 11.1, 11.2 dhe 11.3 të Ligjit bazë të Skemës së Ndihmës Sociale dhe nenit 10 të Ligjit Nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë dhe akteve të tjera nënligjore, Komisioni për Ankesa i Shkallës II për ndihma sociale në DPSF/MPMS, gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2019 ka shqyrtuar 610 ankesa të paraqitura nga palët e pakënaqura me vendimin e shkallës së parë, gjegjësisht, me vendimin e lëshuar nga Udhëheqësit e Shërbimeve të SNS-së nëpër QPS-të përkatëse. Nga ky total, 124 ankesa apo 20% janë aprovuar ndërsa 486 ankesa apo 80% janë refuzuar, pasi që nuk i kanë plotësuar kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi. Shih tabelën 17 dhe figurën 46:

*Tabela 18: Numri i ankesave, vlerësimeve në shkallën II dhe kontestet administrative, 2019*

| Muaji | Ankesa, Shkalla II | | | Komisioni Mjekesor, II | | | Konteste administrative/Gjykata Themelore | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Totali | Aprov. | Refuz. | Totali | Aprov. | Refuz. | Totali | Aprov. | Refuz. | Riproc. | Proced. |
| Janar | 59 | 12 | 47 | 36 | 8 | 28 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Shkurt | 33 | 10 | 23 | 37 | 6 | 31 | 3 | 0 | 0 | 0 | 3 |
| Mars | 57 | 11 | 46 | 35 | 5 | 30 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Prill | 47 | 15 | 32 | 54 | 12 | 42 | 2 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| Maj | 86 | 14 | 72 | 36 | 10 | 26 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Qershor | 35 | 5 | 30 | 36 | 3 | 33 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Korrik | 51 | 11 | 40 | 36 | 10 | 26 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Gusht | 30 | 4 | 26 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Shtator | 50 | 14 | 36 | 58 | 14 | 44 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Tetor | 68 | 11 | 57 | 32 | 9 | 23 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Nëntor | 48 | 9 | 39 | 26 | 3 | 23 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Dhjetor | 46 | 8 | 38 | 42 | 10 | 32 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | 610 | 124 | 486 | 428 | 90 | 338 | 11 | 0 | 0 | 0 | 11 |

[27] Ligji Nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, Neni 10, paragrafi 11.2.

*Figura 47: Numri i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni i Ankesave i Shkallës II, 2019*




Krahasuar me vitin paraprak ku ishin gjithsej 732 ankesa në Shkallën II, numri i tyre gjatë vitit 2019 ka rënë për 122 ankesa më pak, apo minus 20%.

## 7.10.2 Komisioni Mjekësor i Shkallës II për paaftësi për punë

Në rastet kur ankesa ka të bëjë me vlerësimet e Komisionit Mjekësor, atëherë Komisioni për Ankesa i Shkallës II kërkon nga Komisioni i Mjekëve i Shkallës II, që të shqyrtojë dhe të rivlerësojë paaftësinë për punë (jo më pak se 80% i paaftë për punë) të anëtarit/anëtarëve të familjes, të cilët kanë aplikuar për ndihmë sociale. Gjatë periudhës janar dhjetor 2019, ky Komision ka shqyrtuar-rivlerësuar 428 ankesa, prej tyre 90 apo 19% janë aprovuar (aplikuesit janë vlerësuar si të paaftë për punë), kurse 338 apo 81% janë refuzuar, (janë vlerësuar të aftë për punë.) Shih. Tabelën 17 dhe figurën 47:

*Figura 48: Numri i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni Mjekësor i Shkallës II, 2019*




Krahasuar me vitin paraprak, ku numri i ankesave ishte 385, numri i kërkesave/ankesave për vlerësim në Komisionin Mjekësor të Shkallës II gjatë vitit 2019, është rritur për 43 ankesa më shumë, apo 10%.

### 7.10.3. Kontestet administrative

Pala e pakënaqur me aktvendimin e Komisionit për Ankesa të Shkallës II, ka të drejtë të parashtrojë padi në afatin prej tridhjetë (30) ditësh për inicimin e kontestit administrativ në Gjykatën kompetente, nga dita e marrjes së aktvendimit.[28]

Përmes Komisionit të Ankesave të Shkallës së Dytë të DNS/DPSF-së, për në Gjykatën Themelore në Prishtinë, gjatë vitit 2019 janë proceduar gjithsej 11 konteste administrative, ku që të gjitha janë në fazën e shqyrtimit. Shih tabelën 17 dhe figurën 48:

[28] Ligji Nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, Neni 10, paragrafi 11.3.

*Figura 49: Kontestet administrative të proceduara në Gjykatën Themelore, 2019*




Krahasuar me vitin 2018, ku ishin 16 konteste administrative, gjatë vitit 2019 kemi një rënie për 5 konteste administrative më pak, apo minus 45%.

## 7.11. Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes për Skemën e Ndihmës Sociale

Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes (NJKM) vepron në kuadër të DNS/DPSF-së dhe është përgjegjëse për të kontrolluar, inspektuar dhe mbikëqyrur në mënyrë sistematike funksionimin dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi të SNS-së, punën e QPS-ve, si institucione të cilave MPMS-ja ua ka deleguar të drejtën për të administruar me SNS, se sa dhe si zbatohet Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, dhe udhëzimet e tjera administrative që rregullojnë Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë.

Në kuadër të kompetencave dhe mandatit që ka Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes për Skemën e Ndihmës Sociale, gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, kjo njësi, ka ushtruar kontroll të rregullt në 13 QPS (shih Tab.16). Gjatë këtyre kontrolleve, NJKM-ja ka kontrolluar gjithsej 818 dosje-lëndë të shfrytëzuesve (familjeve) në ndihmë sociale.

Në vitin 2018, NJKM-ja ka kontrolluar 2025 lëndë/dosje, konstatojmë se gjatë vitit 2019 NJKM-ja ka kontrolluar 1.207 lëndë më pak se sa në vitin paraprak.

Nga numri i përgjithshëm i lëndëve të kontrolluara, 521 lëndë apo 64% e lëndëve-dosjeve ishin të kompletuara me dokumentet e nevojshme sipas akteve ligjore dhe nënligjore të Skemës së Ndihmës

Sociale, ndërsa 297 ose apo 36% e dosjeve-lëndëve të shfrytëzuesve të ndihmave sociale (familjeve) ishin jo komplete, ngase u mungonte ndonjë nga dokumentet që parashihet me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë Skemën e Ndihmës Sociale.

Përveç dokumenteve të kontrolluara në lëndët e shfrytëzuesve të ndihmave sociale, NJKM-ja ka bërë edhe verifikimin e drejtpërdrejt të 486 familjeve në vendbanimet e tyre. Nga këto verifikime ka rezultuar se 437 familje të verifikuara në terren apo 90% ishin të përzgjedhshme, në harmoni me kushtet dhe kriteret që parashihen me ligj, ndërsa 49 apo 10% e familjeve të verifikuara ishin të pa përzgjedhshme dhe në kundërshtim me kushtet dhe kriteret që parashihen me aktet ligjore dhe nënligjore të Skemës së Ndihmës Sociale. Shih tabelën 7.18 dhe figurën 7.16 dhe 7.17:

*Tabela 19: Numri i Qendrave për Punë Sociale të kontrolluara nga Njësia e Kontrollit dhe Mbikqyrjes, 2019*

| Nr | Komuna QPS-ja | Koha-periudha e kontrollit | Numri i lëndëve të kontrolluara | | | | | Numri i familjeve të verifikuara | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Nr. i lëndëve të kontrolluara | Nr. i lëndëve të kompletuara | % | Nr. i lëndëve jo të kompletuara | % | Nr. i familjeve të verifikuara | Nr. i familje të përzgjedhshme | % | Nr. i familjeve jo të përzgjedhshme | % |
| 1 | Prishtinë K T | 13.02-19.02.2019 | 120 | 31 | 25.83 | 89 | 74.17 | 56 | 35 | 62.50 | 21 | 37.50 |
| 2 | Prishtinë Q | 28.01-30.01.2019 | 87 | 37 | 42.53 | 50 | 57.47 | 38 | 37 | 97.36 | 1 | 2.64 |
| 3 | Prishtinë KD | 06.02-07.02.2019 | 49 | 32 | 65.30 | 17 | 34.70 | 24 | 23 | 95.83 | 1 | 4.17 |
| 4 | Kllokot | 30.04-03.05.2019 | 25 | 16 | 64.00 | 9 | 36.00 | 23 | 21 | 91.30 | 2 | 8.70 |
| 5 | Malishevë | 13.05-23.05.2019 | 84 | 76 | 90.47 | 8 | 9.23 | 61 | 59 | 96.72 | 2 | 3.28 |
| 6 | Paretesh | 24.05-24.05.2019 | 16 | 10 | 62.50 | 6 | 37.50 | 10 | 8 | 80.00 | 2 | 20.00 |
| 7 | Z. Potok-Qaber | 13.06-13.06.2019 | 18 | 12 | 66.67 | 6 | 33.33 | 10 | 8 | 80.00 | 2 | 20.00 |
| 8 | Shtërpcë | 18.06-20.06.2019 | 63 | 47 | 74.60 | 16 | 25.40 | 27 | 25 | 92.59 | 2 | 7.41 |
| 9 | Ferizaj | 03.07-17.07.2019 | 103 | 85 | 82.52 | 18 | 17.47 | 59 | 59 | 100 | 0 | 0 |
| 10 | Skenderaj | 26.08-05.09.2019 | 98 | 68 | 69.39 | 30 | 30.61 | 67 | 62 | 92.54 | 5 | 7.46 |
| 11 | Kamenicë | 24.07-17.09.2019 | 75 | 50 | 66.67 | 25 | 33.33 | 52 | 44 | 84.62 | 8 | 15.38 |
| 12 | Rahovec | 29.10-06.11.2019 | 75 | 63 | 84.00 | 12 | 16.00 | 36 | 36 | 100 | 0 | 0 |
| 13 | Deçan | 09.12-18.12.2019 | 60 | 41 | 68.34 | 19 | 31.66 | 23 | 20 | 86.96 | 3 | 13.04 |
| | | Totali | 818 | 521 | 63.69 | 297 | 36.31 | 486 | 437 | 89.92 | 49 | 10.08 |

Nga tabela e mësipërme rezulton se përqindjen më të lartë me lëndë jo komplete në SNS, Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes i ka gjetur tek QPS-ja në Prishtinë/Kodra e Trimave, ku nga 120 lëndët e kontrolluara 89 lëndë apo 74% ishin të pakompletuara; në QPS-në në Prishtinë/Qafa nga 87 lëndët e kontrolluara, 50 lëndë apo 57% ishin të pakompletuara, e kështu me radhë.

Edhe përqindjen më të lartë të familjeve të pa përzgjedhshme në SNS, NJKM-ja e ka gjetur-konstatuar në QPS Prishtinë/Kodra e Trimave, ku nga 56 familjet e verifikuara në terren, 37% e tyre ishin të papërzgjedhshme, pastaj në QPS e Parteshit dhe të Zubin Potokut ku nga totali i familjeve të verifikuara në terren 20% e tyre ishin të papërzgjedhshme.

Në vitin 2018, NJKM-ja ka verifikuar në terren 1.180 familje, atëherë konstatojmë se gjatë vitit 2019 NJKM-ja ka verifikuar në terren 694 familje më pak se sa në vitin paraprak.

*Figura 50: Numri i lëndëve të kompletuara dhe jo të kompletuara sipas QPS-ve*




Krahasuar me vitin e 2018, ku 30% e totalit të lëndëve/dosjeve të kontrolluar ishin të pakompletuara, konstatojmë se në vitin 2019 kjo përqindje është rritur për 7% më shumë se vitin paraprak.

*Figura 51: Numri i familjeve të përzgjedhshme dhe të papërzgjedhshme sipas QPS-ve, 2019*




Krahasuar me vitin e 2018, ku 6% e totalit të familjeve të verifikuara në terren ishin të papërzgjedhshme, konstatojmë se në vitin 2019 kjo përqindje është rritur për 4% më shumë se vitin paraprak.

## 7.12. Krahasimi i dhënave me Administratën Tatimore të Kosovës

Gjatë vitit 2019, pas krahasimit të bazës së të Dhënave të SNS-së me Administratën Tatimore të Kosovës, janë identifikuar gjithsej 1.963 raste/familje që kanë të hyra mujore. Nga ky total, 762 lëndë apo 39% janë lëndë që janë stopu para se t'i tërheqin mjetet e ndihmës sociale, pra, këto raste/familje nuk kanë obligim për kthim të mjeteve, ndërsa 1.201 raste/familje apo 61% kanë realizuar nga një pagesë të ndihmës sociale pa bazë ligjore. Për këto raste janë njoftuar QPS-të përkatëse dhe ndaj tyre është iniciuar procedura e kthimit të mjeteve të realizuara në mënyrë të paligjshme.

Nga gjithsej 1.201 rasteve që kanë përfituar ndihmë sociale pa bazë ligjore, 468 familje apo 40% i kanë kthyer mjetet e fituara pa bazë ligjore, me 154 raste/familje apo 13%, Qendrat për Punë Sociale nuk kanë mundur që të lidhin marrëveshje për kthimin e mjeteve të ndihmës sociale të realizuara pa bazë ligjore. Lëndët e këtyre rasteve/familjeve nga DPSF-ja janë përcjellë në Departamentin Ligjor (DL) të MPMS-së me qëllim të inicimit të procedurës gjyqësore dhe përcjelljes së tyre në Gjykatën kompetente, 515 raste/familje 42%, janë ende në procedurë për kthim të mjeteve të realizuara pa bazë ligjore. Ndërsa për 66 raste/familje apo 5%, QPS-të kanë konstatuar se gjendja socio-ekonomike e tyre është tepër e rëndë dhe të njëjta janë riaktivizuar në ndihmë sociale. Shih tabelën më poshtë:

*Tabela 20: Numri i lëndëve të verifikuara me ATK, 2019*

| Nr | QPS/Komuna | Familjet e identifikuara me ATK | Familjet që nuk kanë obligim kthimi të mjeteve | Familjet që kanë obligim kthimi të mjeteve | Familjet që i kanë kthyer mjetet | Lëndët e dërguar në DL për inicim të procedurës gjyqësore | Lëndët në procedurë në QPS (që nuk janë raportuar) | Lëndët e riaktivizuara nga QPS-të, ( pa i kthyer mjetet) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Prishtinë/K. e Trimave | 93 | 21 | 72 | 12 | 2 | 58 | 0 |
| 2 | Prishtinë/Qafa | 50 | 19 | 31 | 21 | 0 | 10 | 0 |
| 3 | Prishtinë/K Diellit | 50 | 18 | 32 | 14 | 13 | 3 | 2 |
| 4 | Zveçan | 24 | 14 | 10 | 3 | 0 | 6 | 1 |
| 5 | Zubin Potok | 44 | 14 | 30 | 1 | 0 | 30 | 1 |
| 6 | Viti | 29 | 14 | 15 | 7 | 2 | 6 | 0 |
| 7 | Suharekë | 23 | 8 | 15 | 13 | 0 | 2 | 0 |
| 8 | Skenderaj | 67 | 25 | 42 | 32 | 9 | 1 | 0 |
| 9 | Shtërpcë | 21 | 13 | 8 | 4 | 0 | 4 | 0 |
| 10 | Rahovec | 49 | 19 | 30 | 17 | 0 | 9 | 4 |
| 11 | Prizren | 63 | 22 | 41 | 14 | 0 | 27 | 0 |
| 12 | Podujevë | 73 | 29 | 44 | 21 | 22 | 1 | 0 |
| 13 | Pejë | 70 | 35 | 35 | 2 | 24 | 6 | 3 |
| 14 | Obiliq | 44 | 13 | 31 | 20 | 0 | 11 | 0 |
| 15 | Novobërdë | 33 | 17 | 16 | 11 | 0 | 5 | 0 |
| 16 | Mitrovicë | 197 | 73 | 124 | 49 | 25 | 37 | 13 |
| 17 | Mitrovice V | 57 | 28 | 29 | 4 | 0 | 23 | 2 |
| 18 | Malishevë | 44 | 14 | 30 | 19 | 0 | 8 | 3 |
| 19 | Lipjan | 113 | 35 | 78 | 35 | 22 | 19 | 2 |
| 20 | Leposaviq | 21 | 13 | 8 | 3 | 0 | 5 | 0 |
| 21 | Klinë | 45 | 21 | 24 | 2 | 0 | 17 | 5 |
| 22 | Kaçanik | 70 | 20 | 50 | 13 | 0 | 47 | 0 |
| 23 | Kamenicë | 35 | 17 | 18 | 12 | 2 | 3 | 1 |
| 24 | Hani I Elezit | 10 | 2 | 8 | 6 | 0 | 2 | 0 |
| 25 | Gracanicë | 7 | 6 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 |
| 26 | Gjilan | 82 | 26 | 56 | 36 | 4 | 14 | 2 |
| 27 | Gjakovë | 77 | 25 | 52 | 15 | 0 | 32 | 5 |
| 28 | Fushë Kosovë | 58 | 32 | 26 | 8 | 6 | 8 | 4 |
| 29 | Ferizaj | 57 | 27 | 30 | 17 | 8 | 5 | 0 |
| 30 | Drenas | 116 | 47 | 69 | 25 | 15 | 24 | 5 |
| 31 | Dragash | 25 | 11 | 14 | 9 | 0 | 5 | 0 |
| 32 | Deçan | 22 | 8 | 14 | 12 | 0 | 2 | 0 |
| 33 | Vushtrri | 116 | 47 | 69 | 4 | 0 | 60 | 5 |
| 34 | Kllokot | 13 | 9 | 4 | 0 | 0 | 3 | 1 |
| 35 | Mamushë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 36 | Paretesh | 2 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 37 | Ranillug | 11 | 5 | 6 | 0 | 0 | 3 | 3 |
| 38 | Istog | 15 | 0 | 15 | 5 | 0 | 6 | 4 |
| 39 | Junik | 2 | 1 | 1 | 0 | | 1 | 0 |
| 40 | Shtime | 35 | 12 | 23 | 11 | 0 | 12 | 0 |
| | Totali | 1963 | 762 | 1,201 | 478 | 154 | 515 | 66 |

Bazuar në tabelën e mësipërme dhe në figurën më poshtë, konstatohet se numri më i madh i rasteve të identifikuara që kanë përfituar ndihmë sociale pa bazë ligjore pas krahasimi të të dhënave me ato të ATK-së, e ka QPS-ja e Mitrovicës me 124 raste/familje apo 10% nga numri total i familjeve që janë të obliguara për kthimin e mjeteve të ndihmës sociale. Shih figurën më poshtë:

*Figura 52: Numri i familjeve që kanë përfituar ndihmë sociale pa bazë ligjore pas krahasimit me ATK-në, 2019*



## 7.13. Ndihmat e njëhershme-emergjente

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.1 dhe 12.2 të Ligjit nr. 04/L -096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 12/2013 për Përcaktimin e Procedurave për Pagesat e Ndihmave të Njëhershme Sociale, thuhet: Ndihmë e njëhershme sociale konsiderohet ndihma që ofrohet për individë apo familje për një nevojë momentale, të jashtëzakonshme, por jo edhe të vazhdueshme, siç janë: shpenzimet e varrimit të anëtarëve të familjes, dëmet dhe shkatërrimet e ekonomisë familjare të shkaktuar nga fatkeqësitë elementare (zjarri, tërmeti dhe vërshimi) për humbje të dokumentacionit bashkë me paratë e fundit, dhe nevoja të tjera të jashtëzakonshme.[29]

Të drejtë aplikimi për përfitimin e ndihmës së njëhershme kanë të gjitha familjet apo individët, pavarësisht se a janë apo nuk janë shfrytëzues të Skemës së Ndihmës Sociale, që i plotësojnë kriteret e parapara me nenin 12 të Ligjit nr. 04/L -096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë.[30]

Kushtet, kriteret dhe procedurat e tjera për realizimin e kësaj mbështetjeje financiare janë të rregulluara me Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr. 12/2013 për Përcaktimin e Procedurave për Pagesat e Ndihmave të Njëhershme Sociale, nga neni 4-15.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, Komisioni Vlerësues për ndihma momentale ka shqyrtuar i 232 kërkesa për ndihmë të njëhershme sociale. Mbështetje financiare me nga 100 euro kanë përfituar 109 individë/familje apo 47% nga totali i kërkesave të shqyrtuara, me gjithsej 10,900 euro, me nga 150 euro deri në 300 euro kanë përfituar 78 familje/individë apo 34%, me gjithsej 18,900 euro, ndërsa janë refuzuar 48 kërkesa apo 21% pasi që nuk i kanë plotësuar kriteret e parapara me legjislacionin e cekur me lartë. Gjithsej, shuma e shpërndarë për ndihma të njëhershme sociale gjatë periudhës janar-dhjetor 2019 është 29,800 euro. Shih tabelën 19, dhe figurën 51:

[29] Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 12/2013 për Përcaktimin e Procedurave për Pagesat e Ndihmave të Njëhershme Sociale.

[30] Po aty, neni 5.

*Tabela 21: Ndihmat e njëhershme-emergjente, 2019*

| Muaji | Numri i kërkesave | Aprovim 100 euro | Aprovim 150-300 | Refuzim | Shuma 100 euro | Shuma 300 euro | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | 10 | 4 | 5 | 1 | 400.00 € | 1,100.00 € | 1,500.00 |
| Shkurt | 21 | 16 | 1 | 4 | 1,600.00 € | 300.00 € | 1,900.00 |
| Mars | 35 | 18 | 10 | 7 | 1,800.00 € | 2,700.00 € | 4,500.00 |
| Prill | 19 | 9 | 3 | 7 | 900.00 € | 600.00 € | 1,500.00 |
| Maj | 29 | 15 | 7 | 7 | 1,500.00 € | 1,600.00 € | 3,100.00 |
| Qershor | 9 | 0 | 9 | 0 | 0 | 2,300.00 € | 2,300.00 |
| Korrik | 27 | 10 | 10 | 7 | 1,000.00 € | 2,500.00 € | 3,500.00 |
| Gusht | 9 | 4 | 2 | 3 | 400.00 € | 500.00 € | 900.00 |
| Shtator | 16 | 10 | 6 | 2 | 1,000.00 € | 1,700.00 € | 2,700.00 |
| Tetor | 18 | 8 | 7 | 4 | 800.00 € | 1,400.00 € | 2,200.00 |
| Nëntor | 19 | 8 | 7 | 4 | 800.00 € | 1,600.00 € | 2,400.00 |
| Dhjetor | 20 | 7 | 11 | 2 | 700.00 € | 2,600.00 € | 3,300.00 |
| Totali | 232 | 109 | 78 | 48 | 10,900.00 € | 18,900.00 € | 29,800.00 € |

Në vitin 2018, buxheti i shpenzuar për ndihma të njëhershme ishte 33,700 euro. Në vitin 2019 shuma e mjeteve ka rënë për 3,900 euro apo 13% më pak se viti paraprak.

*Figura 53: Numri i kërkesave për ndihmë të njëhershme, aprovim dhe refuzim, 2019*



Në vitin 2018, janë shqyrtuar 288 kërkesa për ndihmë të njëhershme. Në vitin 2019 konstatohet se kemi një rënie prej 56 kërkesave apo 24% me pak se viti paraprak.

## 7.14. Pëlqimet për autorizim për tërheqjen e ndihmës sociale

Në bazë të nenit 9, paragrafit 1, Udhëzimit Administrativ nr. 15/2012 për Përllogaritjen e Shumës Mujore të Ndihmës Sociale, shërbimi përkatës i DNS/DPSF-së ka bërë shqyrtimin e kërkesave për lëshimin e pëlqimeve për autorizime personave (bartësve të ndihmave sociale), të cilët për shkaqe të ndryshme objektive (sëmundje, vuajtje e dënimeve, zhvendosjes-emigrimit dhe vdekjes), nuk kanë qenë në gjendje që të tërheqin ndihmat e tyre sociale.

Siç shihet nga tabela 22 dhe figurat më poshtë, gjatë vitit 2019, janë shqyrtuar dhe aprovuar gjithsej 130 kërkesa të QPS-ve për dhënien e pëlqimeve për autorizime për tërheqjen e ndihmës sociale. Shih tabelën 20 dhe figurën 53:

Krahasuar me vitin paraprak (2018), numri i kërkesave për pëlqime nga 106 ka shënuar ngritje për 24 kërkesa apo 18% më shumë.

Bazuar në tabelën 20 dhe figurën 54, shihet se numri më i madh i kërkesave për pëlqim/autorizim për tërheqjen e ndihmës sociale është bërë nga QPS-ja e Obiliqit 15 kërkesa, pastaj QPS-ja e Prishtinës me 12 (Kodra e Trimave, 4 pëlqime, Prishtina-Qendra 7 pëlqime dhe Kodra e Diellit 1 pëlqim), e kështu me radhë. Ndërsa, asnjë kërkesë për pëlqime nuk kanë bërë QPS-të, në: Artanë, Junik, Graçanicë, Hani Elezit, Istog, Zubin Potok, Kllokot, Leposaviq, Mamushë, Mitrovicë e Veriut, Partesh dhe Zveçan, etj.

*Tabela 22: Numri i kërkesave të shqyrtuara për pëlqim/autorizim sipas QPS-ve, 2019*

| Nr. | QPS | Të aprovuara | Të refuzuara | Totali i kërkesave |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Artanë | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Dardanë | 2 | 0 | 2 |
| 3 | Deçan | 1 | 0 | 1 |
| 4 | Drenas | 14 | 0 | 14 |
| 5 | Ferizaj | 9 | 0 | 9 |
| 6 | Fushë Kosovë | 5 | 0 | 5 |
| 7 | Gjakovë | 5 | 0 | 5 |
| 8 | Gjilan | 1 | 0 | 1 |
| 9 | Gracanicë | 0 | 0 | 0 |
| 10 | H. Elezit | 0 | 0 | 0 |
| 11 | Istog | 0 | 0 | 0 |
| 12 | Junik | 0 | 0 | 0 |
| 13 | Prishtinë/K. e Trimave | 4 | 0 | 4 |
| 14 | Prishtinë/K. e Diellit | 1 | 0 | 1 |
| 15 | Kaçanik | 0 | 0 | 0 |
| 16 | Kastriot | 15 | 0 | 15 |
| 17 | Klinë | 1 | 0 | 1 |
| 18 | Kllokot | 0 | 0 | 0 |
| 19 | Leposaviç | 0 | 0 | 0 |
| 20 | Lipjan | 5 | 0 | 5 |
| 21 | Malishevë | 2 | 0 | 2 |
| 22 | Mamushë | 0 | 0 | 0 |
| 23 | Mitrovica V. | 0 | 0 | 0 |
| 24 | Mitrovicë | 3 | 0 | 3 |
| 25 | Partesh | 0 | 0 | 0 |
| 26 | Pejë | 6 | 0 | 6 |
| 27 | Podujevë | 3 | 0 | 3 |
| 28 | Prishtinë/Qendra | 7 | 0 | 7 |
| 29 | Prizren | 11 | 0 | 11 |
| 30 | Rahovec | 10 | 0 | 10 |
| 31 | Ranillug | 1 | 0 | 1 |
| 32 | Sharr | 2 | 0 | 2 |
| 33 | Shtërpcë | 3 | 0 | 3 |
| 34 | Shtime | 2 | 0 | 2 |
| 35 | Skenderaj | 7 | 0 | 7 |
| 36 | Therandë | 5 | 0 | 5 |
| 37 | Viti | 3 | 0 | 3 |
| 38 | Vushtrri | 1 | 0 | 1 |
| 39 | Z. Potok | 0 | 0 | 0 |
| 40 | Zveçan | 1 | 0 | 1 |
| | TOTAL: | 130 | 0 | 130 |

*Figura 54: Numri i kërkesave të shqyrtuara për pëlqim/autorizim sipas QPS-ve, 2019*



## 7.15. Buxheti i Skemës së Ndihmës Sociale, procedimi, shpërndarja, barazimi, kthimi i mjeteve dhe provizioni bankar për operatorët ekonomik

Gjatë vitit 2019 janë procesuar 31,542,532.50 euro për Skemën e Ndihmës Sociale, nga ky total janë shpërndarë 31,438,041.45 euro apo 99.67% e mjeteve të procesuara, ndërsa janë kthyer/nuk janë shpërndarë 101,491.05 euro apo 0.32% e mjeteve të procesuar. Shih tabelën 21:

*Tabela 23: Procedimi, shpërndarja, barazimi dhe kthimi i mjeteve nga BpB në buxhetin e MPMS-së, 2019*

| Muaji | Shuma e procesuar | Shuma e paguar | Mjetet e kthyera | Provizioni bankar |
|---|---|---|---|---|
| Janar | 2.684.862,50 € | 2.677.467,50 € | 7.395,00 € | 37.374,30 € |
| Shkurt | 2.662.885,00 € | 2.654.784,70 € | 8.100,30 € | 37.373,40 € |
| Mars | 2.667.502,50 € | 2.660.045,00 € | 7.457,50 € | 37.100,10 € |
| Prill | 2.671.142,50 € | 2.662.235,00 € | 8.907,50 € | 37.038,90 € |
| Maj | 2.652.472,50 € | 2.644.027,50 € | 8.445,00 € | 36.921,90 € |
| Qershor | 2.634.275,00 € | 2.627.090,00 € | 7.185,00 € | 36.760,30 € |
| Korrik | 2.614.485,00 € | 2.601.455,00 € | 13.030,00 € | 36.455,70 € |
| Gusht | 2.611.070,00 € | 2.601.367,00 € | 9.703,00 € | 36.418,50 € |
| Shtator | 2.603.022,50 € | 2,595,284.75 € | 7,737.75 € | 36,393.20 € |
| Tetor | 2,592,857.50 € | 2,582,957.50 € | 6,900.00 € | 36,304.10 € |
| Nëntor | 2,565,617.50 € | 2,558,307.50 € | 7,310.00 € | 35,891.70 € |
| Dhjetor | 2,582,340.00 € | 2,573,020.00 € | 9,320.00 € | 36,088.70 € |
| Totali | 31,542,532.50 € | 31,438,041.45 € | 101,491.05 € | 440,120.80 € |

Buxheti total i shpenzuar për pagesën e SNS-së gjatë vitit 2019 është 31,572,332.50 euro, pasi që në këtë total është përfshirë edhe shuma e mjeteve prej 29,800 eurosh e shpenzuar për pagesën e ndihmave të njëhershme sociale.

Për shërbimet e kryera (shpërndarjen e ndihmave sociale) gjatë vitit 2019 MPMS-ja, sipas çmimit të kontraktuar, në emër të provizionit bankar ka paguar gjithsej 440,120.80 euro. Shih tabelën 21 dhe figurën 55:

*Figura 55: Shuma e mjeteve të procesuara, të shpërndara dhe të kthyera, 2019*




Në vitin 2018, shuma e mjeteve të procesuara për pagesën e Skemës së Ndihmës Sociale ishte 32,858,645 euro, shuma e mjeteve të shpërndara 32,766,722 euro dhe shuma e mjeteve të kthyera, të pashpërndara ishte 91,923 euro. Nëse i krahasojmë këto të dhëna me ato të vitit 2019, konstatojmë se në vitin 2019, shuma e mjeteve të procesuara ka rënë për 1,316,122.50 euro më pak apo minus 4%, gjithashtu edhe shuma e mjeteve të shpërndara ka rënë për 1,328,680.55 euro apo minus 4%. Ndërsa shuma e mjeteve të pashpërndara/të kthyera në vitin 2019 është rritur për 9,568.05 euro apo 9% krahasuar me vitin paraprak.

## 7.15.1. Shpërndarja e ndihmave sociale

Sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes të MPMS-BPB-Postës së Kosovës-Sh. A., nr.268 gjegjësisht 411013 dhe 01-2118/17, dt.11.08.2017, që nga muaji tetor 2017 e deri në dhjetor 2018, ndihmat sociale për 28 komuna, me 97 pika postare, janë shpërndarë nga PK Sh. A., ndërsa në 10 komuna tjera ndihmat sociale i ka shpërndarë NLB (Kastriot, Hani Elezit, Deçan, Junik, Mitrovicë e Veriut, Graçanicë, Shtërpcë, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok).

Shpërndarja e ndihmave sociale përmes PK Sh. A., është treguar si shumë e suksesshme dhe me impakte pozitive. Në radhë të parë, ndihmat sociale u janë ofruar më afër qytetarëve më afër vendbanimit të tyre, dhe tani më nuk ka tollovi para sporteleve siç ishte rasti më herët me BPB, dhe së fundmi, shfrytëzuesit e ndihmës sociale nuk bëjnë shpenzime për transport, ngase i kanë më afër filialet-sportelet e PK Sh. A., etj. Shih tabelën 22:

*Tabela 24: Buxheti i SNS-së dhe shpërndarja e e ndihmave sociale sipas muajve, 2019*

| Muaji | Shuma e pranuar në € | Shuma e shpërndarë-PK në € | Shuma e shpërndarë – NLB, në € | Shuma e mjeteve të pashpërndara, në € |
|---|---|---|---|---|
| Janar | 2,785,952.50 | 2,451,177.50 | 325,547.50 | 9,227.50 |
| Shkurt | 2,784,232.50 | 2,498,340.00 | 278,087.50 | 7,805.00 |
| Mars | 2,790,597.50 | 2,503,880.00 | 276,340.00 | 10,377.50 |
| Prill | 2,768,605.00 | 2,488,955.00 | 270,807.00 | 8,843.00 |
| Maj | 2,777,245.00 | 2,497,787.50 | 273,247.50 | 6,210.00 |
| Qershor | 2,766,085.00 | 2,487,845.00 | 272,852.50 | 5,387.50 |
| Korrik | 2,738,432.50 | 2,459,820.00 | 271,372.50 | 7,240.00 |
| Gusht | 2,700,382.50 | 2,423,062.50 | 269,540.00 | 7,780.00 |
| Shtator | 2,686,217.50 | 2,409,392.50 | 270,340.00 | 6,485.00 |
| Tetor | 2,674,110.00 | 2,399,832.50 | 268,855.00 | 5,422.50 |
| Nëntor | 2,689,820.00 | 2,410,200.00 | 270,452.50 | 9,167.50 |
| Dhjetor | 2,696,965.00 | 2,419,430.00 | 269,557.50 | 7,977.50 |
| Totali: | 32,858,645.00 | 29,449,722.50 | 3,316,999.50 | 91,923.00 |

## 7.16. Subvencionimi i energjisë elektrike për vitin 2018

Qeveria e Republikës së Kosovës që nga viti 2005 e deri më vitin 2017, për çdo vit ka ndarë nga 4.5 milion euro për subvencionimin e një sasie të energjisë së shpenzuar elektrike (deri në 400 KW, gjegjësisht, deri në 300 KW në muaj) për shfrytëzuesit (familjet) në Skemën e Ndihmës Sociale dhe Skemës së Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile të Luftës (FDILVC).

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), për këtë periudhë, për çdo vit ka nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi me Ministrinë e Financave (MF), gjegjësisht, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) dhe Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), gjegjësisht, Kompaninë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), Kompaninë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) për subvencionimin e një sasie të energjisë së shpenzuar elektrike (deri në 400 KW në muaj), për shfrytëzuesit e Skemës së Ndihmës Sociale (SNS) dhe Skemës së Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile.

Për dallim nga vitet e mëparshme (2005-2016) ku në subvencionim të energjisë elektrike janë përfshirë vetëm dy Skema: Skema e Ndihmës Sociale dhe Skema e FDIL-së, për subvencionimin e energjisë elektrike për vitin 2017, e që është realizuar gjatë vitit 2018, për herë të parë janë përfshirë edhe dy skema: Skema për Personat e Verbër dhe Skema për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Marrëveshja e Mirëkuptimit e lidhur në mes MPMS-KEDS-KESCO për subvencionimin e energjisë elektrike për përfituesit e Skemës së Ndihmës Sociale dhe FDILVC-së, për vitin 2018, është bërë në përputhje me Ligjin Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale, Ligjin Nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, Ligjin Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre, Ligjin Nr.04-L-092 për Personat e Verbër, Ligjin Nr. 05/L—67 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, dhe Ligjin Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike.

Në tabelën 25 është paraqitur numri i personave/familjeve sipas pensioneve/skemave sociale të subvencionuara për vitin 2018.

*Tabela 25: Subvencionimi i energjisë elektrike për familjet në SNS, FDIL për vitin 2018*

| | SKEMAT | | | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| | SNS | FDIL | PPT | PV | |
| Numri i shifrave që janë subvencionuar | 22,504 | 10,053 | 1,247 | 673 | 34,477 |
| Numri i familjeve të subvencionuara | 23,226 | 10,418 | 1,267 | 697 | 35,608 |
| Shuma e mjeteve (subvencionim i rregullt) | 2,840,205.69 | 1,380,935.90 | 152,841.78 | 89,719.32 | 4,463,702.69 |
| Numri i familjeve (ANKESAT) | 78 | 24 | 2 | 139 | 243 |
| Shuma e mjeteve (subvencionim për ankesa) | 10,500.67 | 3,522.96 | 363.19 | 21,910.49 | 36,297.31 |
| Numri total i familjeve të subvencionuara | 23,304 | 10,442 | 1,269 | 836 | 35,851 |
| Shuma totale e mjeteve | 2,850,706.36 | 1,384,458.86 | 153,204.97 | 111,629.81 | 4,500,000.00 |

*Figura 56: Familjet e subvencionuara sipas Skemave, me përqindje, 2018*




Bazuar në tabelën dhe figurën e mësipërme, janë subvencionuar gjithsej 35.851 familje (SNS 23.304 familje apo 65% FDIL 10.442 familje apo 29%, PPT 1.269 persona apo 4% dhe PV 836 persona apo 2%). Çdo familje/person është subvencionuar mesatarisht nga 270 KWh apo 11.63 euro në muaj, gjegjësisht 139.61 euro në vit.

Subvencionimi i energjisë elektrike për familjet në SNS, FDIL, Personat e Verbër dhe Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, është bërë me buxhetin e vitit aktual (2019), por për vitin paraprak (2018).

## 7.17. Baza e të Dhënave (TI) për Skemën e Ndihmës Sociale

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) përcakton rregullat dhe procedurat për Skemën e Ndihmës Sociale (SNS) dhe zhvillon dhe e mirëmban sistemin e TI-së të SNS-së.

Sistemi i TI-së i SNS-së ka objektivin e dyfishtë të informimit, të hartimit të politikave dhe mbështetjes së zbatimit të metodës së shenjestrimit të SNS-së. Sistemi i menaxhimit dhe i informimit të SNS-së (baza e të dhënave ose regjistri), është i dizajnuar në qendër dhe mirëmbahet nga MPMS-ja. Funksionet e tij themelore përfshijnë mbështetjen e zbatimit të mekanizmit të shenjestrimit të TMT-së të SNS-së, gjenerimin e të dhënave për zhvillimin e politikave, monitorimin dhe vlerësimin. Sistemi i SNS-së është dizajnuar në mënyrë të tillë që të shkëmbejë të dhëna me çdo lloj sistemi me çdo lloj ndërfaqeje, nëse ka një identifikues të përbashkët personal.

Sistemi i TI-së i SNS-së është i lidhur dhe shkëmben të dhëna me shumicën e skemave të transferimit social të MPMS-së dhe Administratës Tatimore, nuk ka shkëmbim të të dhënave me programe të tjera. SNS-ja i kontrollon të dhënat në mënyrë elektronike (përmes sistemit të bazuar në ueb) me 10 bashkësi të dhënash elektronike të përfituesve në kuadër të MPMS-së dhe të ATK-së. Lidhja elektronike me bazën e të dhënave të përfituesve të MPMS-së, mundëson kontrollimin e pranimit të pensioneve dhe të disa përfitimeve në para të gatshme të kategorive.[31] Sidoqoftë, skemat e shërbimeve sociale që operohen nga QPS-të (si kujdesi rezidencial për të moshuarit dhe personat me paaftësi, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore) nuk janë të lidhura me SNS-në, edhe pse realizohen nga QPS-të. Disa nga këto shërbime të tjera aktualisht nuk kanë baza të të dhënave të bazuara në ueb që mundësojnë shkëmbimin e të dhënave.

Shkëmbimi i të dhënave me disa institucione është i kufizuar nga mungesa e sistemeve dhe marrëveshjeve formale me ato institucione. MPMS-ja ka një marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave me MPB-në që do të përdoret për lidhjen me Regjistrin Civil të MPB-së, për të verifikuar karakteristikat demografike të aplikuesve (p.sh. ID-të personale, madhësinë dhe përbërjen familjare), si dhe për lidhje me Regjistrin e Automjeteve për të verifikuar pronësinë e automjeteve nga përfituesit. Megjithatë, sistemet e MPB-së ende nuk janë funksionale, çka pengon shkëmbimin e të dhënave. Besojmë se në vitin 2020 të funksionalizohet sistemi i MPB dhe të fillohet shkëmbimi/krahasimi i të dhënave të bazës së SNS-së me të dhënat e MPB-së, që kanë të bëjnë me SNS-në.

[31] Këto skema janë si më poshtë: 1) pensionet për personat me paaftësi (mosha 18-64 vjeç); 2) pensioni bazik (skema e pensionit minimal) dhe pensioni kontributpagues; 3) përfitimet për kategoritë e luftës (familjet e dëshmorëve të luftës, familjet e anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, invalidët e luftës, familjet e invalidëve të luftës pas vdekjes së invalidëve, familjet e civilëve të zhdukur, invalidët civilë të luftës, familjet e invalidëve civilë pas vdekjes së tyre); 4) pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës; 5) pensionet për punonjësit e Trepçës; 6) pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës; 7) Skema e Mbështetjes Materiale për Familjet e Fëmijëve me Paaftësi (mosha 0-18 vjeç); 8) mbështetja materiale për familjet kujdestare (të afërm ose jo të afërm) të fëmijëve të braktisur; 9) veteranët e luftës; 10) skema e kompensimit për të verbrit.

# 8. DIVIZIONI PËR PLANIFIKIM DHE PËRFSHIRJE SOCIALE

## 8.1. Detyrat dhe Përgjegjësitë e Divizionit për Planifikim dhe Përfshirje Sociale

Divizioni për Planifikim dhe Përfshirje Sociale (DPPS), vepron në kuadër të DPSF/MPMS-së. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Planifikim dhe Përfshirje Sociale, janë:

- ✓ Koordinon aktivitetet në procesin e planifikimit buxhetor për shërbime dhe përfshirje sociale;
- ✓ Siguron që politikat për mirëqenien sociale prezantohen në bazë të të dhënave mbi varfërinë në Kosovë dhe që politikat buxhetore për rritjen e mirëqenies sociale të jenë kompatibile me mundësitë buxhetore;
- ✓ Propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve të politikave/strategjive për avancimin e shërbimeve të përfshirjes sociale;
- ✓ Raporton mbi efektin e pagesave sociale;
- ✓ Koordinon aktivitetet me Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Ministrinë e Financave (MF) për analizimin e lëvizjes së çmimeve të shportës së ushqimeve për caktimin e nivelit të vlerës së përfitimeve;
- ✓ Ofron mbështetje në procesin e planifikimeve buxhetore për përfshirje sociale në komuna;
- ✓ Identifikon nevojat për financim nga fondet e BE-së dhe donatorët e tjerë të cilët ofrojnë mbështetje për zhvillimin e sektorit të politikave sociale dhe të përfshirjes sociale;
- ✓ Menaxhon procesin e regjistrimit të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare.

Udhëheqësi i Divizionit për Planifikim dhe Përfshirje Sociale raporton tek Udhëheqësi i Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare. Numri i të punësuarve në këtë Divizion është gjashtë (6).

## 8.2. Planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit për vitin 2019

Procesi i planifikimit të buxhetit dhe bashkëpunimi me donatorë në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, gjatë vitit 2019, është realizuar në përputhje me objektivat e dala nga Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018-2020.

Gjatë vitit 2019, shërbimet sociale dhe familjare, janë financuar nga dy burime të Buxhetit të Kosovës:

1. *Financimet e shërbimeve nga niveli lokal (komunat) si pjesë e përgjegjësive vetanake të komunave, të cilët financohen nga Granti i Përgjithshëm dhe të Hyrat Vetanake të Komunave,* dhe

2. *Financimi i shërbimeve nga niveli qendror, MPMS-ja, si pjesë e financimit të skemave të pagesave sociale dhe kontraktimit apo bashkëfinancimit të projekteve të OJQ-ve me donatorë.*

Shuma e mjeteve për financimin e shërbimeve sociale nga niveli lokal edhe gjatë vitit 2019 ka qenë një shumë e mjeteve jo shumë e madhe, e cila është alokuar apo ndarë nga Granti i Përgjithshëm apo të Hyrat Vetanake. Kjo shumë e mjeteve buxhetore është shfrytëzuar për mbulimin e kostos së stafit dhe disa shpenzimeve operative të Qendrave për Punë Sociale, ndërsa një shumë minimale është shfrytëzuar për bashkëfinancim të projekteve me OJQ-të.

Financimi i shërbimeve sociale dhe familjare nga niveli qendror edhe për vitin 2019, ka qenë mjaftë i rëndësishëm, për ruajtjen e kualitetit të ofrimit të shërbimeve dhe mbështetjen e OJQ-ve të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme sociale dhe familjare. Programet të cilat janë mbuluar dhe bashkëfinancuar gjatë vitit 2019 janë:

- ✓ Programi i mbështetjes së familjeve të varfra, që është zbatuar përmes Skemës së Ndihmës Sociale;
- ✓ Programi i mbështetje së familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, që është zbatuar përmes Skemës së Përkrahjes Materiale për Familjet me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara 1-18 vjeç;
- ✓ Programi i mbrojtjes së fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe të braktisur, që është zbatuar përmes dy formave të strehimit familjar (*strehimi familjar brenda familjes dhe strehimit familjar alternativ/jashtë familjes);*
- ✓ Programi i mbështetje së viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, që është zbatuar përmes kontraktimit dhe blerjes së shërbimeve nga OJQ-të, që merren me ofrimin e shërbimeve sociale për këto kategori;
- ✓ Programi i ofrimit të shërbimeve rezidenciale për personat e moshuar dhe me aftësi të kufizuar, që është zbatuar përmes ofrimit të shërbimeve 24 orëshe në institucionet rezidenciale;
- ✓ Programi i ofrimit të shërbimeve ditore dhe në familje për fëmijë dhe të rritur, që është zbatuar në bashkëfinancim të projekteve të OJQ-ve nga MPMS-ja, donatorët apo komunat.

## 8.3. Përfshirja Sociale

Me përfshirje sociale nënkuptojmë përkrahjen e atyre që ndodhen në vështirësi, si dhe fuqizimin e njerëzve, të cilët vuajnë si pasojë e ndonjë kufizimi natyror apo shoqëror.

Përfshirja sociale është një koncept që synon të krijojë, të ruajë dhe të forcojë proceset ku individët dhe grupet, pavarësisht dallimeve mes tyre, mund të bëjnë një jetë më të mirë, të jenë qytetarë aktiv dhe pjesëmarrës në vendimmarrje, të jenë një shoqëri më e informuar. Pra, përfshirja sociale d.m.th refuzim i prirjeve diskriminuese, të cilësdo formë dhe në cilindo nivel brenda shoqërisë.

Sistemi i mbrojtjes sociale në Republikën e Kosovë përbëhet nga transferet monetare dhe shërbimet sociale dhe familjare. Në përgjithësi ky sistem i mbrojtjes sociale për nivelin qendror dhe lokal financohet nga Buxheti i Shtetit.

Politikat e MPMS-së gjatë viteve të fundit kanë qenë të orientuara në zhvillimin e programeve të cilat ndihmojnë familjet dhe individët, të cilët janë të rrezikuar nga varfëria dhe përjashtimi social. Programet e përfitimeve nga të gjitha skemat dhe shërbimet mbulojnë rreth 284.326 familje/individë apo 16% të popullsisë, ndërsa shpenzimet e mbrojtjes sociale, në buxhetin e vitit 2019 kanë marrë pjesë me mbi 18% (mbi 446,555,731.16 euro).

Programet kryesore që zbatohen janë të fokusuara në realizimin e përfitimeve dhe shërbimeve të paraqitura në skemat ekzistuese, siç janë:

**Skema e Ndihmës Sociale -** është një mbështetje dhe ofrim i ndihmës së përkohshme financiare për familjet që jetojnë në varfëri dhe i plotësojnë kriteret dhe kushtet e përcaktuar me Ligjin Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, Ligjin Nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë. Kjo skemë ka filluar të funksionojë prej vitit 2000. Pagesa mujore për këtë skemë bëhet sipas numrit të anëtarëve të familjes. Shuma minimale gjatë vitit 2019 ishte 60.00 euro (për një anëtar) dhe maksimalja 180.00 euro (për pesëmbëdhjetë anëtarë). Në muajin dhjetor 2019 nga kjo skemë kanë përfituar 24.352 familje.

**Pensionet Bazike të Moshës -** është skemë e përgjithshme, jokontributive, e financuar nga Buxheti i Kosovës. Është konceptuar si tarifë e fiksuar mujore, për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që janë mbi moshën 65 vjeç, pavarësisht se a kanë punuar më parë apo jo. Kjo skemë ka filluar të aplikohet që nga mesi i vitit 2002. Shuma e përfitimit për një person, përfitues i kësaj skeme në fillim ka qenë 28 euro në muaj ndërsa tani është 90 euro në muaj. Në muajin dhjetor 2019 këtë pension e kanë shfrytëzuar 133.917 qytetarë të Kosovës, buxheti i shpenzuar për vitin 2019 është 145,469,085 euro.[32]

**Pensionet Kontributpagues të Moshës** - kjo skemë iu dedikohet personave që kanë mbushur 65 vjeç dhe të cilët dëshmojnë se kanë qenë në marrëdhënie pune mbi 15 vjet, para dt. 01.01.1999. Kjo skemë ka filluar të aplikohet që nga viti 2008. Në fillim shuma e pensionit kontributpagues të moshës ka qenë 140.00 euro në muaj. Shuma e pensionit kontribut pagues të moshës nga muaji janar 2016 ka pësuar ndryshime, ku pensionet paguhen sipas kategorizimeve në bazë të shkollimit. Pagesa mujore bëhet duke filluar nga 158.00 euro e deri në 230.00 euro në muaj. Në muajin dhjetor 2019 këtë pension e kanë shfrytëzuar 47,486 qytetarë të Kosovës, buxheti i shpenzuar është 115,296,748 euro.[33]

---

[32] Të dhënat për shfrytëzuesit e Skemave, të cilat nuk menaxhohen nga DPSF-ja janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

[33] Të dhënat për shfrytëzuesit e Skemave, të cilat nuk menaxhohen nga DPSF-ja janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

**Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara -** ky pension apo mbështetje financiare iu ofrohet personave të rritur mbi moshën 18 vjeç apo më pak se 65 vjeç, të cilët janë plotësisht dhe përherë me aftësi të kufizuara dhe të paaftë për çfardo pune të shpërblyeshme. Kjo Skemë ka filluar të aplikohet që nga viti 2004. Diganozën mjekësore, gjendjen fizike, ndijore, mendore apo aftësinë e kufizuar të aplikuesit për këtë pension e vlerëson Komisioni i Mjekësor, i caktuar nga MPMS-së, ndërsa Aktvendimin për njohje apo refuzim të kësaj të drejteje, e nxjerrë MPMS-ja, gjegjësisht, Administrata Pensionale e Kosovës. Shuma mujore e këtij pensioni është 75 euro. Në muajin dhjetor 2019 këtë pension e kanë shfrytëzuar 17.791 qytetarë të Republikës së Kosovës, buxheti i shpenzuar është 17,630,572 euro..[34]

**Pensionet familjare -** pensioni i rregullt mujor i paguar për anëtarët e familjes në rast të vdekjes së të punësuarit, që ka qenë në marrëdhënie pune, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me ligjin në fuqi. Të drejtën për pension familjar e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit familjar të cilët janë nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare dhe të cilët realizimin e kësaj të drejte e dëshmojnë me Vendim apo fletëpagesë të pensionit që tregon se kanë qenë shfrytëzues të pensionit familjar, para datës 01.01.1999, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83). Shuma mujore për këtë pension është 90 euro në muaj. Në muajin dhjetor 2019 këtë pension e kanë shfrytëzuar 3.940 shfrytëzues.[35]

**Pensionet invalidore të punës –** pensioni i rregullt mujor, i paguar për personat që pësojnë lëndime në punë apo fitojnë sëmundje profesionale gjatë marrëdhënies së punës, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë Ligj, si dhe invalidët e punës sipas Ligjit Pensional dhe Invalidor, të aplikuar para datës 01.01.1999. Të drejtën në pension invalidor të punës e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit invalidor, nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare, të cilët e dëshmojnë realizimin e kësaj të drejte me Vendim apo (fletëpagesë) të pensionit që tregon se kanë qenë shfrytëzues të pensionit invalidor të punës, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor. E drejta në pension invalidor të punës iu njihet edhe të gjithë të punësuarve aktual, tek të cilët është shfaqur paaftësia e plotë për punë, si pasojë e lëndimit në punë apo e sëmundjes profesionale. Lartësia e pensionit invalidor të punës është në shumë të njëjtë me pensionin bazik të moshës. Shuma mujore e këtij pensioni është 90 euro. Në muajin dhjetor 2019 këtë pension e kanë shfrytëzuar 108 shfrytëzues.[36]

**Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike** - pensioni për personat paraplegjik përfitojnë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik, kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme, ndërsa pensioni për personat tetraplegjik përfitojnë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik, kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të

---

[34] Po aty.
[35] Po aty.
[36] Po aty.

ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme. Përfituesit e këtij Ligji janë Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, Ndërsa, Kompensimi - nënkupton shumën e pagesës mujore për mbulimin e shpenzimeve të domosdoshme ditore. Për kompensimin e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik shuma mujore me shoqërues është 375 euro (Grupi I), kurse pa shoqërues është 150 euro (Grupi II).Nga kjo skemë në muajin dhjetor 2019 kanë përfituar 3.106 përfitues.[37]

**Skema e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile -** kjo skemë ka për qëllim ofrimin e përfitimeve për kategoritë e qytetarëve të cilët kanë pësuar nga maltretimet dhe lufta që ka ndodhur gjatë viteve 1998/99 në Kosovë. Kjo skemë ka filluar të implementohet për disa kategori nga viti 2001, ndërsa me aprovimin e Ligjit nga vitit 2008 janë përfshirë edhe disa kategori të cilat më parë nuk ishin përfituese. Në muajin dhjetor 2019 nga kjo skemë kanë përfituar 10,493 familje/individë, buxheti i shpenzuar 41,234,222. 46 euro, shih tabelën me poshtë:

*Tabela 26: Numri i përfituesve të skemës së FDIL-së sipas kategorive, dhjetor 2019* [38]

| Kategoria | Numri i përfituesve (dhjetor 2019) |
|---|---|
| Familje e Dëshmorit të UÇK-së | 1,805 |
| Familje e Invalidit Civil pas Vdekjes | 82 |
| Familje e Invalidit të Luftës pas Vdekjes | 161 |
| Familje e të Zhdukurit Civil | 255 |
| Familje e të Zhdukurit të UÇK-së | 14 |
| Familje e Viktimave Civile | 2,917 |
| Invalid Civil i Luftës | 1,370 |
| Invalid i Luftës | 3,798 |
| Kujdestar për Invalid Civil të Luftës | 23 |
| Kujdestar për Invalid të Luftës | 68 |
| Totali | 10,493 |

**Skema e Pensioneve për Veteranët e Luftës -** të drejtën e këtij pensioni e ka individi që është qytetar i Republikës së Kosovës dhe shtetas i huaj, i cili është rreshtuar në radhët e UÇK-së dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës. Në muajin dhjetor 2019 nga kjo skemë kanë priftuar 38.101 individë/familje. Nga ky total 36.193 ishin veteranë të UÇK-së, shuma mujore 170 euro dhe 1.908 ishin familje të veteranit (pas vdekjes së veteranit) shuma mujore 119 euro. Buxheti i shenzuar 76,769,873.50 euro.[39]

---

[37] Të dhënat për shfrytëzuesit e Skemave, të cilat nuk menaxhohen nga DPSF-ja janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

[38] Po aty

[39] Të dhënat për shfrytëzuesit e Skemave, të cilat nuk menaxhohen nga DPSF-ja janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovë.

**Skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) -** është pagesë e rregullt mujore që i bëhet ish pjesëtarit të TMK-së gjatë tërë jetës, ose trashëgimtarit pas vdekjes së ish pjesëtarit të TMK-së. Ky pension ka filluar të aplikohet që nga viti 2009. Shuma mujore e pagesës së pensioneve të TMK-së përcaktohet nga 50%, 60% dhe 70% të pagesës mesatare për tri vitet e fundit, pra, nga 100.00 deri në 347.00 euro në muaj. Në muajin dhjetor 2019 këtë pension e kanë përfituar 1.098 persona, buxheti i shpenzuar 3,032,679 euro.[40]

**Skema e pensioneve të Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK) -** është pension i rregullt mujor që i paguhet pjesëtarit të FSK-së, i cili i plotëson kriteret e parapara në Ligjin për Pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (Ligji Nr. 04/L-084) dhe trashëgimtarit pas vdekjes së pjesëtarit të FSK-së. Kjo skemë ka filluar së zbatuari që nga viti 2012. Shuma e pagesës së pensioneve të FSK-së përcaktohet 50%, 60% dhe 70% të pagesës mesatare për tri vitet e fundit. Në muajin dhjetor 2019 këtë pension e kanë përfituar 546 pjesëtarë, buxheti i shpenzuar është 2,407,201 euro.[41]

**Skema e pensioneve të Minatorëve të Trepçës -** të drejtën për të përfituar këtë pension e kanë të gjithë të punësuarit në kompleksin "Trepça", të cilët e kanë humbur vendin e punës deri në fund të vitit 2004. Ky pension ka filluar të implementohet nga data 01.07.2003. Gjatë vitit 2003/2004 shuma mujore e këtij pensioni ishte 40 euro në muaj, ndërsa tani është 126 euro në muaj. Bazuar në gjendjen e muajit dhjetor 2019, numri i përfituesve nga Skema e Pensioneve të Trepçës ishte 2.635 persona, buxheti i shpenzuar 4,214,668 euro.[42]

**Skema e kompensimeve për personat e verbër -** të drejtën për realizimin e këtij pensioni e kanë personat me humbje të plot të të pamurit, të lindur ose të fituar sipas Ligjit Nr. 4/L-92 për Personat e Verbër. Shuma e pagesës për personat e verbër është 125.00 euro në muaj, si dhe 125.00 euro për shoqëruesit e personave të verbër. Në muajin dhjetor 2019 nga ky pension kanë përfituar 1.976 persona, buxheti i shpenzuar 5,409,800 euro.[43]

**Skema për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme 1-18 vjeç -** kjo përkrahje materiale iu ofrohet familjeve, të cilat kanë në përkujdesje të plot 24 orëshe fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme 1 deri në 18 vjeç, të cilët janë plotësisht të paaftë të kryejnë aktivitetet e tyre të përditshme jetësore, pa përkujdesin e personit tjetër. Kjo Skemë ka filluar të funksionojë në vitin 2009. Shuma mujore për një fëmijë është 100.00 euro në muaj. Në muajin dhjetor 2019 nga kjo skemë kanë përfituar 2.276 fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, buxheti i shpenzuar 2,775,300 euro.

---

[40] Po aty.
[41] Po aty.
[42] Po aty.
[43] Të dhënat për shfrytëzuesit e Skemave, të cilat nuk menaxhohen nga DPSF-ja janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

**Strehimi familjar -** strehimi familjar i fëmijëve të braktisur dhe pa përkujdesje prindërore, realizohet në dy forma të cilat janë:

- Strehimi familjar i fëmijëve brenda familjes/tek farefisi, në muajin dhjetor 2019 në këtë formë të strehimit ishin 496 fëmijë, buxheti i shpenzuar 617,600 euro dhe
- Strehimi familjar i fëmijëve jashtë familjes/alternativ, në muajin dhjetor 2019 ishin të vendosur 53 fëmijë, buxheti i shpenzuar 155,450 euro.

***Shërbimet Profesionale dhe Këshilluese* -** këto shërbime ofrohen për mbrojtjen e fëmijëve të braktisur dhe pakujdes prindëror, për të rritur dhe të moshuar, pra, ekzistojnë rreth 50 forma të shërbimeve sociale dhe profesionale të cilat iu ofrohen individëve dhe familjeve në nevojë sociale.

Të gjitha skemat e paraqitura më lartë, kanë ndikuar në ngritjen e mirëqenies së familjeve/ individëve dhe në reduktimin e varfërisë apo plotësimin e nevojave ditore për ushqim dhe disa shërbime tjera elementare për jetesë.

## 8.4. Përjashtimi Social

Përjashtimi social është një proces ku individë dhe grupe sociale, duke qenë të cenuar nga varfëria, mospërgatitja e duhur arsimore, mungesa e shkathtësive profesionale, fizike apo intelektuale janë të shtyrë që pjesërisht apo plotësisht të jetojnë në margjinat e shoqërisë. Kjo situatë ata i largon nga mundësia për punë, të ardhura dhe edukim, sikurse që i largon edhe nga përfitimet nga komunikimi dhe rrjetëzimi social. Për më keq, gjendja e disfavorshme sociale i kufizon ata që të ndikojnë në vendimmarrje, në politikat dhe përmirësimin e jetës së tyre.

Varfëria është faktori kryesor i përjashtimit social. Bazuar në Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) të vitit 2015, është vlerësuar se 17.6% e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë (21.1% në vitin 2014), me 1.82 euro në ditë dhe se 5.2% e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë së skajshme.[44]

Bazuar në të dhënat e kësaj ankete (ABEF 2015), varfëria është me e theksuar tek: familjet që banojnë në vendbanimet rurale (73%), familjet me më shumë anëtarë, ku shkalla më e lartë e varfërisë është gjetur tek familjet me shtatë e më shumë anëtarë (39.1%), familjet që burim kryesor të të ardhurave kanë ndihmën sociale (70.7%), familjet me burim kryesor të të ardhurave nga puna me mëditje (33.8%), familjet që burim kryesore të të ardhurave kanë pensionet (27.8%), të punësuarit në punë të rastësishme (26.0%), personat me aftësi të kufizuara (23.5%), nxënësit/studentët (20.3%), të papunësuarit (16.7%), familjet që kryesohen nga femrat (23.7%), individët me shkallë të ulët të arsimimit (29.7%), individët që

[44] Banka Botërore/ASK (Prill 2017) *"Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në periudhën 2012-2015"*; Shih: http://ask.rks-gov.net/media/3186/stat-e-varferise-2012-2015.pdf

nuk e kanë përfunduar shkollën fillore dhe 18.8% individët që e kanë përfunduar shkollën fillore), fëmijët (20.7%) si dhe familjet me 3 e më shumë fëmijë (22.2%).[45]

Qeveria e Kosovës i ka identifikuar grupet që janë më të rrezikuara, dhe që e ndjejnë përjashtimin më shumë se të tjerët dhe duhet të jenë prioritet i politikave sociale në Kosovë. Këto grupe janë: *të papunësuarit afatgjatë, fëmijët dhe të rinjtë e pa favorizuar, posaçërisht vajzat nga viset rurale dhe fëmijët e pakicave kombëtare, femrat nga viset rurale, nënat vetushqyese, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët përveç shkallës më të lartë të papunësisë dhe varfërisë, kanë nivel të ulët të shkollimit dhe shkallën më të lartë të analfabetizmit dhe personat me aftësi të kufizuara, shumica e të cilëve nuk kanë qasje fizike në objektet shëndetësore dhe arsimore - dhe familjet e tyre, të cilat janë ofruesit kryesorë të përkujdesjes për këta persona.*

Institucionet kryesore që janë të përfshira në hartimin dhe zbatimin e këtyre politikave janë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në nivelin qendror, Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale përmes Qendrave për Punë Sociale në nivelin lokal, të cilat kanë kaluar në kompetenca të komunave nga viti 2009 dhe ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim moshe, gjinie, nacionaliteti apo përkatësie fetare, por që i plotësojnë kriteret e parapara me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Përveç institucioneve publike të lartpërmendura, një rol të rëndësishëm kanë edhe OJQ-të, të cilat merren me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

## 8.5. Licencimi i Organizatave Jo Qeveritare

Korniza ligjore e aprovuar për shërbimet sociale, ka mundësuar që të zhvillohet dhe zbatohet procesi i licencimit të subjekteve juridike, OJQ-ve dhe kompanive private, të cilat merren me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

Gjatë vitit 2019, Komisioni i licencimit të Subjekteve juridike /Organizatave Joqeveritare, i cili funksionon në kuadër të DPSF/MPMS-së, bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.17/2013 për Licencimin e Subjekteve Juridike/Organizatave që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare, ka shqyrtuar 20 kërkesa për licencim dhe rilicencim, nga të cilat 18 apo 90% janë aprovuar (licencuar/rilicencuar), ndërsa 2 kërkesa apo 10% janë refuzuar pasi që nuk ia kanë plotësuar kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi. Shih figurën më poshtë:

---

[45] Banka Botërore/ASK (Prill 2017) *"Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në periudhën 2012-2015"*; Shih: http://ask.rks-gov.net/media/3186/stat-e-varferise-2012-2015.pdf

*Figura 57: Numri i kërkesave për licencim të OJQ-ve të shqyrtuara, 2019*




OJQ-të e licensuara, fushëveprimtari të tyre e kanë mbrojtjen sociale të personave në nevojë për shërbime sociale dhe familjare. Organizatat Joqeveritare licencohen sipas zonave dhe fusheveprimtarisë që e ushtrojnë nga niveli nacional, regjional, lokal dhe duke bërë profilizimin e tyre lidhur me strehimin, trajtimin dhe rehabiletimin e kategorive në nevojë sociale dhe familjare. Vlefshmëria e licencës është e plotë dhe e kushtëzuar. E plot për periudhën tri vjeçare dhe e kushtëzuar për periudhën 1 vjeçare.

Nga 18 OJQ-të e licencuara/rilicencuara gjatë vitit 2019, prej tyre 8 OJQ apo 45% janë licencuar për të ofruar shërbime në nivel lokal, 4 OJQ apo 22% për të ofruar shërbime në nivel regjional dhe 6 OJQ apo 33% për të ofruar shërbime në nivel nacional. Shih figurën më poshtë:

*Figura 58: OJQ-të e licencuara sipas nivelit ku i ofrojnë shërbimet, 2019*



Në total numri i OJQ-ve të licencuara/rilicencuara është 43 OJQ (14 në nivelin lokal, 13 regjional dhe 16 në nivel nacional).

## 8.6. Njësia për Monitorim dhe Inspektim

Njësia për Monitorimin/Inspektimin (NJMI) e Shërbimeve Sociale dhe Familjare, e cila funksionon në kuadër të DPSF/MPMS-së, gjatë vitit 2019 ka zhvilluar aktivitetet bazuar në legjislacionin në fuqi dhe Planin Vjetor të Punës 2019. Mandati ligjor i NJMI-së është inspektimi i zbatimit të drejtë të legjislacionit në fuqi, zbatimi i Standardeve Minimale të cilësisë dhe respektimi i Kodit të Etikës, në sektorin publik dhe jo publik, me qellim të rritjes së cilësisë së ofrimit të shërbimeve për qytetarët në nevojë sociale (fëmijë dhe të rritur).

Për zhvillimin dhe avancimin e shërbimeve sociale dhe familjare, duke u bazuar në të gjeturat në terren, NJMI-ja në raportet e inspektimit ka dhënë rekomandime për organizatën e inspektuar, autoritetet e nivelit komunal dhe nivelit qendror.

Në periudhën raportuese, NJMI-ja ka realizuar dhjetë (10) inspektime/riinspektime: pesë (5) inspektime të rregullta sipas Planit Vjetor të Punës të vitit 2019, tri (3) inspektime të paplanifikuara/të jashtëzakonshme dhe dy (2) riinspektime të rregullta/planifikuara me planin vjetor lidhur me zbatimin e rekomandimeve.

Inspektimet/riinspektimet janë realizuar në tri (3) Qendra për Punë Sociale (QPS), në një (1) institucion publik për persona me aftësi të kufizuar (fëmijë) - Shtëpi me Bazë në Komunitet dhe në gjashtë (6) OJQ. Shih tabelën më poshtë:

*Tabela 27: Institucionet Publike dhe Organizatat Joqeveritare të inspektuara, 2019*

| Nr | Emri i institucionit/organizatës | Lloji i inspektimit |
|---|---|---|
| 1 | OJQ-ja Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës "Nënë Tereza"- Prishtinë | **Inspektim i rregullt** (sipas Planit Vjetor të Punës së NJMI, 2019). |
| 2 | Qendra për Punë Sociale-Drenas | **Inspektim i jashtëzakonshëm** (lidhur me raportimin e një rasti të keqtrajtimit). |
| 3 | OJQ – "HANDIKOS"-Pejë | **Inspektim i rregullt** (sipas Planit Vjetor të Punës së NJMI, 2019). |
| 4 | OJQ "Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP", në Prishtinë | **Inspektim i rregullt** (sipas Planit Vjetor të Punës së NJMI, 2019). |
| 5 | Qendra për Punë Sociale-Drenas | **Inspektim i jashtëzakonshëm** (bazuar në kërkesën e një klienti për mënyrën e realizimit të kontaktimit me fëmijë). |

| | | |
|---|---|---|
| 6 | OJQ – “HUMANITETI”- Rahovec | **Riinspektim** (i planifikuar në Planin Vjetor të Punës së NJMI, 2019). |
| 7 | Qendra për Punë Sociale-Prishtinë<br><br>Qendra për Punë Sociale- Ferizaj | **Inspektim i jashtëzakonshëm** (për vlerësimin dhe konstatimin e zbatimit të procedurave ligjore dhe profesionale për adoptim, lidhur me rastin e një fëmije nga komuna e Prishtinës dhe kërkesës për adoptim të çiftit bashkëshortor, nga komuna e Ferizajt dhe shtetas të Maqedonisë së Veriut). |
| 8 | OJQ “Qendra për Jetë të Pavarur” në Vitomiricë – Pejë | **Inspektim i rregullt** (sipas Planit Vjetor të Punës së NJMI, 2019). |
| 9 | Shtëpia e Komunitetit për Personat me Aftësi të Kufizuara Mendore-Ngecje në Zhvillimin Mendor-Kamenicë | **Inspektim i rregullt** (sipas Planit Vjetor të Punës së NJMI, 2019). |
| 10 | OJQ Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës - “Raba Voca”- Mitrovicë | **Riinspektim** (i planifikuar në Planin Vjetor të Punës së NJMI, 2019) |

## 9.1. DIVIZIONI I POLITIKAVE SOCIALE

### 9.1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Politikave Sociale

Divizioni i Politikave Sociale funksionon në kuadër të DPSF/MPMS-së. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Politikave Sociale, janë:

- ✓ *Hulumtimi në fushën e shërbimeve sociale e familjare dhe efekti i skemave të pagesave sociale në reduktimin e varfërisë;*
- ✓ *Hulumtimi i dukurive të ndryshme sociale dhe përgatitja e rekomandimeve në fushën e politikave sociale;*
- ✓ *Koordinimi i aktiviteteve me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, për sigurimin e të dhënave dhe përpunimin e tyre, të cilat përdoren për publikimin e raporteve hulumtuese;*
- ✓ *Publikimi i doracakëve për shërbimet që ofrohen nga MPMS-ja dhe i raporteve për politika sociale;*
- ✓ *Bashkëpunimi me strukturat profesionale vendore dhe të jashtme me qëllim të ngritjes së kualitetit të shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Përmbledhja e të arriturave në fushën e politikave sociale dhe publikimi i tyre në ueb-faqet e Departamentit apo Ministrisë.*

Udhëheqës i Divizionit te Politikave Sociale, raporton tek Udhëheqësi i Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes. Numri i të punësuarve në këtë divizion është dhjetë (10).

### 9.2. Përgatitja e hulumtimeve për publikim

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive që aktualisht ka Divizioni i Politikave Sociale për përmbushjen e misionit dhe në zbatimin e objektivave të përcaktuar në Programin Vjetor të Punës të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe në zbatimin e Planit Vjetor të Punës së Divizionit, plan ky i miratuar nga Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjare për vitin 2019, stafi i Divizionit për Politika Sociale, gjatë vitit 2019 ka punuar në realizimin e katër (4) hulumtimeve, të cilat janë paraqitur në tabelën më poshtë:

*Tabela 28: Numri i hulumtimeve të realizuar nga Departamenti i Politikave Sociale, 2019*

| Nr. | Emri i hulumtimit | Përshkrimi |
|---|---|---|
| 1 | Analiza e Kostos së Shportës së Ushqimit | Hulumtimi është një analizë e të ardhurave minimale për familje. Procesi për realizimin e këtij hulumtimi ka filluar në vitin 2018. Procesi rreth finalizimit të këtij hulumtimi ka vazhduar edhe gjatë vitit 2019. Gjatë vitit që po raportojmë ka përfunduar Drafti I i hulumtimit, |
| 2 | Gjendja e moshës së tretë | Hulumtimi është një analizë për gjendjen socio-ekonomike të personave të moshës së tretë, mbi 65 vjeç. Gjatë vitit 2019, janë kryer akivitetet e nevojshme për realizimin e këtij hulumtimi. Në fund të vitit 2019, është arritë që të finalizohet Drafti i parë, ndërsa gjatë vitit 2020 është paraparë të përfundojë finalizimi i hulumtimit. |
| 3 | Fëmijët në punë | Hulumtii ka të bëjë me pasqyrimin real të gjendjes lidhur me përfshirjen e fëmijëve në punë dhe dhënien e rekomandimeve për institucionet që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve se si duhet vepruar në largimin e këtyre fëmijëve nga puna dhe integrimin e tyre në shoqëri.<br><br>Gjatë vitit 2019, grupi punues ka perfunduar Draft-hulumtimin, i cili është duke u analizuar nga një ekspert lokal. |
| 4 | Pjestarët e TMK-së | Gjatë vitit 2019 janë kryer intervista, vizita në terren, si dhe aktivitete të tjera të nevojshme për finalizimin e hulumtimit dhe dhënien e rekomandimeve të nevojshme për institucionet përgjegjëse. Hulumtimi ka përfunduar dhe është në DPSF. |

Stafi i Divizionit për Politika Sociale gjatë vitit 2019, ka kryer edhe një varg aktivitetesh të tjera, si dhe ka bashkëpunuar edhe me institucione dhe me OJQ-të e ndryshme.

## 10. DIVIZIONI PËR MBËSHTETJE ADMINISTRATIVE I KPSHSF-së

### 10.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Divizioni për Mbështetje Administrative i KPSHSF-së, funksionon në kuadër të DPSF/MPMS-së. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Divizioni, janë:

- ✓ *Përgatitja e mbledhjeve në bashkëpunim me kryetarin apo zëvendëskryetarin, duke caktuar agjendën e takimeve të KPSHSF-së;*
- ✓ *Organizimi dhe caktimi i vendit të mbajtjes së takimeve, si dhe kujdesia për hartimin e ekstraktit të procesverbalit nga mbledhjet e KPSHSF-së;*
- ✓ *Udhëheqja dhe menaxhimi me të gjithë arkivin dhe dokumentacionin e hartuar dhe aprovuar nga KPSHSF-ja;*
- ✓ *Përgatitja e raporteve për punën dhe aktivitetet e zhvilluara të KPSHSF-së si dhe të komiteteve punuese të cilat veprojnë në kuadër të Këshillit;*
- ✓ *Kujdesi për regjistrin e punëtorëve social të licencuar dhe mirëmbajtja e shënimeve në formë të shkruar dhe elektronike;*
- ✓ *Kujdesi për ekzekutimin e vendimeve të KPSHSF-së dhe komisioneve të themeluara nga Këshilli;*
- ✓ *Përgjegjësia për menaxhimin e ueb-faqes dhe kujdesi për publikimet e dokumenteve të ndryshme;*
- ✓ *Hartimi dhe planifikimi i kërkesave buxhetore për KPSHSF-në, dhe prezantimi i tyre para organeve përgjegjëse brenda dhe jashtë MPMS-së;*
- ✓ *Hartimi dhe procedimi i të gjitha kërkesave dhe pagesave për zhvillimin e aktiviteteve të KPSHSF-së;*
- ✓ *Kujdesi dhe organizimi i punëtorive dhe koordinimi i aktiviteteve me donatorë mbështetës të KPSHSF-së;*
- ✓ *Raportimi i Udhëheqësit të Divizionit, tek Ministri i MPMS-së.*

# 11. KËSHILLI I PËRGJITHSHËM PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

## 11.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare (KPSHSF), funksion sipas Ligjit Nr.02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe është përgjegjës për mirëmbajtjen e standardeve dhe disiplinës profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, dhe në këtë vazhdë shërben si një organ regjistrues dhe licensues për profesionistët që punojnë në këtë lëmi.[46]

Këshilli gjithashtu është përgjegjës edhe për:

- ✓ *Hartimin e rregulloreve që i konsideron të nevojshme për sigurimin e licencimit, regjistrimin e specialistëve dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional adekuat;*
- ✓ *Hartimin e kodit etik për profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Mbajtjen e regjistrit të profesionistëve të shërbimeve sociale dhe familjare, të cilët janë të licencuar për ta ushtruar veprimtarinë në Republikën e Kosovës;*
- ✓ *Këshilli ka kompetencë që të vendosë se kush mund të jetë i licencuar si profesionist apo specialist i shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Shqyrton ankesat kundër profesionistëve të shërbimeve sociale dhe familjare dhe vendos për sanksionet disiplinore që duhen zbatuar, duke përfshirë anulimin e licencës që njeh kompetencën e ofruesit të shërbimeve sociale dhe familjare, heqjen e profesionistit të shërbimeve sociale dhe familjare nga regjistri;*
- ✓ *Këshilli është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha pretendimeve për shkelje të obligimeve nga profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Licencon trajnerë në fushën e shërbimeve sociale dhe mund të autorizojë ekspertë vendorë nga radhët e veta dhe jashtë tij, në ofrimin e trajnimit për profesionistë të shërbimeve sociale dhe familjare;*
- ✓ *Këshilli për licencimin apo certifikimin e trajnimeve mund të ketë rolin edukativo- arsimor për të gjithë profesionistët, OJQ-të dhe organizatave qeveritare te cilët merren me shërbime sociale dhe familjare.*[47]

[46] Neni 5, paragrafi, 5.2 i Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare; https://gzk.rks-gov.net.
[47] Neni 5, paragrafi, 5.2 i Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare; https://gzk.rks-gov.net

## 11.2. Përbërja e Këshillit

Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare (KPSHSF) është themeluar më 1 prill 2006. Në parim Këshilli është organ që monitoron dhe analizon ngritjen e kualitetit në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë. Këshilli përbëhet nga njëzetë e një anëtarë (21):

- njëmbëdhjetë anëtarë zgjidhen nga radhët e profesionistëve të shërbimeve sociale dhe familjare, që gjenden në regjistrin e Këshillit;
- dy anëtarë emërohen nga Asociacioni i Komunave;
- dy anëtarë i emëron Universiteti i Prishtinës;
- një anëtar i emëruar nga Këshilli i Përgjithshëm Shëndetësor;
- një anëtar nga komuniteti dhe organizatat joqeveritare, dhe
- katër anëtarë të emëruar nga Ministria.

Pra, në përbërjen e vet Këshilli ka përfaqësues nga Asociacioni i Komunave, përfaqësues nga shoqëria civile, profesorë, profesionistë të shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe partnerë të tjerë relevantë, të cilët me përvojat e tyre të fituara, mundësojnë që Këshilli të jetë ekuivalent me kërkesat që dalin nga rrjedhat e vazhdueshme të shoqërisë, dhe mbi të gjitha të ofrojë përgatitje profesionale në ngritjen e kualitetit dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë.

Në fillim kohëzgjatja e një mandati të Këshillit ka qenë 3 vjeçar, ndërsa që nga viti 2012, kur është bërë Plotësimi dhe Ndryshimi i Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, kohëzgjatja e një mandati të Këshillit është 4 vjeçar.

## 11.3. Aktivitetet e realizuara

Në fillim të vitit 2019, Këshilli ka hartuar dhe aprovuar Planin Vjetor të Punës për vitin 2019. Bazuar në objektivat e përcaktuara në këtë plan, Këshilli e ka zhvilluar punën e vet gjatë vitit 2019, ku janë mbajtur takime të rregullta të punës së Këshillit, takime të komisioneve të përhershme, të grupeve punuese, gjithashtu ka patur edhe angazhime individuale të anëtarëve të Këshillit në detyra të caktuara për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të që kanë të bëjnë realizimin e aktiviteteve të Këshillit.

### 11.3.1. Takimet e rregullta të Këshillit të mbajtura gjatë vitit 2019

Gjatë vitit 2019 Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, ka mbajtur gjithsej tri (3) takime të rregullta të punës. Gjatë këtyre takimeve është bërë:

- Zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarit të KPSHSF-së, (*kjo është bërë pasi që kryetari i mëparshëm i Këshillit ka mbushur moshën 65 vjeç dhe ka kaluar në pension);*
- Raportimi i herëpashershëm i komisioneve të përhershme të Këshillit, sidomos i komisionit për licencimin e punëtorëve social në nivelin superior dhe i komisionit për licencim në nivelin bazik, të mesëm dhe të lartë;
- Përgatitja për proces të Akreditimit të moduleve të trajnimit për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, duke përfshirë edhe mbrojtjen e fëmijëve dhe çështje të tjera që ndërlidhen me shërbime sociale dhe familjare.

### 11.3.2. Takimet e komisioneve të përhershme të mbajtura gjatë vitit 2019

Në kuadër të Këshillit funksionojnë pesë (5) komisione të përhershme, të cilat gjatë vitit 2019 kanë përmbushur punën e tyre të paraparë në planin e vjetor të Punës së Këshillit. Këto komisione kanë mbajtur gjithsej 31 takime. Shih tabelën më poshtë:

*Tabela 29: Numri i takimeve të komisioneve të përhershme të Këshillit, 2019*

| Nr. | Komisioni | Numri i takimeve |
|---|---|---|
| 1 | Komisioni për licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjere, **NIVELI SUPERIOR** | 9 |
| 2 | Komisioni për licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare, **NIVELI I BAZIK, I MESËM DHE I LARTË** | 9 |
| 3 | Komisioni i **ANKESAVE** | 13 |
| 4 | Komisioni për **LEGJISLACION** | 0 |
| 5 | Komisioni për **ÇËSHTJE ORGANIZATIVE DHE FINANCA** | 0 |
| | TOTALI: | **31** |

## 11.4. Komisioni për licencim: niveli superior

### 11.4.1. Numri i kërkesavë të shqyrtuara

Komisioni për Licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare të nivelit superior, është formuar në takimin e dytë të Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, të mbajtur më datën 21.03.2018. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë: kryetari dhe katër (4) anëtarët e Komisionit.

Komisioni gjatë vitit 2019 ka mbajtur nëntë (9) takime, gjatë të cilave janë shyrtuar 184 kërkesa për licencim dhe rilicencim të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare në nivelin superior. Shih tabelën me numër 30:

*Tabela 30: Numri i kërkesave të shqyrtuara të nivelit superior, 2019*

| | Aprovim | Refuzim | Plotësim | Totali |
|---|---|---|---|---|
| Numri i kërkesave | 142 | 25 | 17 | 184 |

*Figura 59: Përqindja e numrit të kërkesva të shqyrtuara të nivelit superior, 2019*




Bazuar në tabelën dhe figurën e mësipërme komisioni për licencimin, niveli superior ka shyrtuar 184 kërkesa, nga të cilat 142 apo 77% janë aprovuar, 25 kërkesa apo 14% janë refuzuar dhe 17 kërkesa apo 9% janë kthyer për plotësim.

### 11.4.2. Numri i ofruesve të licencuar dhe rilicencuar, 2019

Nga numri i përgjithshëm prej 142 kërkesave të aporovuara për licencim të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare, 82 apo 58% e ofruesve janë licencuar për herë të parë ndërsa 60 apo 42% janë rilicencuar. Për më tepër shih tabelën dhe figurën e mëposhtme:

*Tabela 31: Numri i ofruesve të licencuar dhe rilicencuar sipas gjinisë, 2019*

| | Licencim | | Ri-licencim | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| Gjinia | F | M | F | M | |
| Numri | 66 | 16 | 36 | 24 | 142 |
| Totali | 82 | | 60 | | |

*Figura 60: Përqindja e ofruesve të nivelit superior të licencuar dhe rilicencuar, 2019*




## 11.4.3. Numri i ofruesve të licencuar dhe të rilicencuar, sipas gjinisë

Siç vërehet edhe nga tabela 31, nga 82 ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare që janë licencuar, prej tyre 66 apo 80% janë femra, ndërsa 16 apo 20% janë meshkuj. Kurse nga 60 ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare që janë rilicencuar, prej tyre 36 apo 60% janë femra ndërsa 24 apo 40% janë meshkuj. Shih tabelën 31 dhe figurën 61:

*Figura 61: Numri i ofruesve të licencuar dhe rilicencuar sipas gjinisë, 2019*



Siç u pa edhe nga tabela 3, gjatë vitit 2019 janë licencuar dhe rilicencuar 142 ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare në nivelin superior, nga të cilët del që 102 apo 72% e ofruesve janë femra, ndërsa 40 apo 28% e ofruesve janë meshkuj. Shih figurën më poshtë:

*Figura 62: Përqindja e ofruesve të licencuar/rilicencuar sipas gjinisë, 2019*




## 11.5. Komisioni për licencim: niveli bazik, i mesëm dhe i lartë

### 11.5.1. Numri i kërkesave të shqyrtuara gjatë vitit 2019

Edhe Komisioni për licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare nivli bazik, i mesëm dhe i lartë, është formuar në takimin e dytë të Këshillit të mbajtur në fillim të vitit 2018. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë (Kryetari i Komisionit dhe 4 anëtarë).

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, ky komision ka mbajtur nëntë (9) takime. Gjatë këtyre takimeve ka shqyrtuar 306 kërkesa të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare në nivelin bazik, të mesëm dhe të lartë. Shih tabelën 32:

*Tabela 32: Numri i kërkesave të shqyrtuara të nivelit bazik, të mesëm dhe të lartë, 2019*

| | Aprovim | Refuzim | Plotësim | Totali |
|---|---|---|---|---|
| Numri i kërkesave | 119 | 20 | 25 | 164 |

*Figura 63: Numri i kërkesave të shqyrtuara të nivelit bazik, të mesëm dhe të lartë me përqindje, 2019*




Bazuar në tabelën dhe figurën e mësipërme komisioni për licencimin, niveli bazik, i mesëm dhe superior ka shyrtuar 164 kërkesa, nga të cilat 119 apo 73% janë aprovuar, 20 kërkesa apo 12% janë refuzuar dhe 25 kërkesa apo 15% janë kthyer për plotësim.

## 11.5.2. Numri i ofruesve të licencuar dhe rilicencuar, 2019

Nga numri i përgjithshëm prej 119 kërkesave të aporovuara për licencim dhe rilicencim të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare, 82 apo 58% e ofruesve janë licencuar për herë të parë, ndërsa 60 apo 42% janë rilicencuar. Për më tepër shih tabelën dhe figurën e mëposhtme:

*Tabela 33: Numri i ofruesve të licencuar dhe rilicencuar sipas gjinisë, 2019*

| Gjinia | Licencim | | Ri-licencim | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| | F | M | F | M | |
| Numri i kërkesave | 41 | 21 | 27 | 30 | 119 |
| Totali | 62 | | 57 | | |

*Figura 64: Ofruesit sherbimeve të licencuar dhe rilicencuar me përqindje, 2019*




## 11.5.3. Numri i ofruesve të licencuar dhe rilicencuar, sipas gjinisë

Siç vërehet edhe nga tabela 5, nga 62 ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare që janë licencuar, në nivlin bazik, të mesëm dhe të lartë, prej tyre 41 apo 66% janë femra, ndërsa 21 apo 34% janë meshkuj. Kurse nga 57 ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare që janë rilicencuar, prej tyre 27 apo 47% janë femra ndërsa 30 apo 53% janë meshkuj. Shih tabelën 5 dhe figurën 7:

*Figura 65: Numri i ofruesve të licencuar dhe rilicencuar sipas gjinisë, 2019*



Siç u pa edhe nga tabela 32, gjatë vitit 2019 janë licencuar dhe rilicencuar 119 ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare në nivelin bazik, të mesëm dhe të lartë, nga të cilët 68 apo 57% e ofruesve janë femra ndërsa 51 apo 43% e ofruesve janë meshkuj. Shih figurën 66:

*Figura 66: Ofruesit e licencuar/rilicencuar sipas gjinisë, 2019*




## 11.6. Komisioni i Ankesave

### 11.6.1. Numri i ankesave të shqyrtuara gjatë vitit 2019

Komisioni i Ankesave është formuar në fillim të vitit 2018, në mbledhjen e dytë të Këshillit dhe përbëhet nga 3 anëtarë (Kryetari i Komisionit dhe 2 anëtarë).

Komisioni i Ankesave gjatë vititi 2019 ka mbajtur 13 takime ku ka shqyrtuar 15 ankesa të parashtruara nga ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare, të cilët kanë qenë të pakënaqur me vendimet e Komisioneve për licencim në nivelin superior dhe kominsionit për licencim niveli bazik, i mesëm dhe i lartë. Shih tabelën e më poshtme:

*Tabela 34: Numri i ankesave të shqyrtuara sipas niveleve, 2019*

| Numri i ankesave | Niveli supreior | | Totali | Niveli bazik, i mesëm dhe i lartë | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Aprovim | Refuzim | | Aprovim | Refuzim | |
| 15 | 8 | 0 | 8 | 6 | 1 | 7 |

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën më lartë, del se Komisioni i Ankesave, ka shqyrtuar 15 ankesa, nga të cilat 8 kanë qenë të nivelit superior, ndërsa 7 kanë qenë të nivelit bazik, të mesëm dhe të

lartë. Nga totali prej 15 ankesave të shqyrtuara, 14 ankesa apo 93% janë aprovuar, ndërsa 1 ankesë apo 7%, është refuzuar pasi që nuk i ka përmbushur kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi. Shih figurën më poshtë:

*Figura 67: Numri i ankesave të shqyrtuara me përqindje, 2019*




### 11.6.2. Numri i ankesave të shqyrtuara, niveli superior

Siç u pa edhe nga të dhënat e paraqitura më lartë, Komisioni i Ankesave ka shyrtuar dhe aprovuar 8 ankesa të nivelit superior, ku të gjitha ankesat e aprovuara janë për licencim. Nga totali prej 8 ankesash të shqyrtuara dhe aporovuara, 1 ankesë apo 12% është parashtruar nga Sektori Qeveritar ndërsa 7 ankesa apo 88% janë parashtruar nga Sektori Joqeveritar. Shih tabelën dhe figurën e mëposhtme:

*Tabela 35: Numrii ankesave të shqyrtuara të nivelit superior, 2019*

| Numri i ankesave | Licencim | Rilicencim | Sektori Qeveritar | Sektori Jo Qeveritar | Gjinia | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | M | F |
| 8 | 8 | 0 | 1 | 7 | 0 | 8 |
| Refuzim | | | | | | |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Figura 68: Përqindja e ankesave të shqyrtuara të nivelit superior sipas sektorëve, 2019




Ndërsa sa i përketë gjinisë, të 8 ankesat e shqyrtuara dhe të aprovuara janë parashtruar nga ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare të gjinisë femërore. Shih tabelën 35.

## 11.6.3. Numri i ankesave të shqyrtuara, të nivelit bazik, të mesëm dhe të lartë

Bazuar në tabelën 36 del që Komisioni i Ankesave ka shqyrtuar 7 ankesa të nivelit bazik, të mesëm dhe të lartë, nga të cilat 6 janë aprovuar ndërsa 1 është refuzuar. Të gjitha ankesat e aprovuara janë parashtruar nga ofrues të shërbimeve për licencim, 2 ankesat e aprovuara apo 33% i takojnë ofruesve të Sektorit Qeveritar, ndërsa 4 ankesa të aprovuara apo 67% i takojnë Sektorit Jo Qeveritar. Shih tabelën dhe figurën e mëposhtme:

Tabela 36: Numri i ankesave të shqyrtuara të nivelit bazik, të mesëm dhe të lartë, 2019

| | Licencim | Rilicencim | Sektori Qeveritar | Sektori Jo-Qeveritar | Gjinia | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | M | F | |
| Numri i ankesave të aprovuara | 6 | 0 | 2 | 4 | 2 | 4 | 6 |
| Numri i ankesave të refuzuara | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 |

*Figura 69: Ankesat e shqyrtuara të nivelit bazik,të mesëm, të lartë sipas sektorëve, 2019*




Sa i përket gjinisë, 3 ankesa apo 33% janë parashtruar nga ofrues të gjinisë mashkullore ndërsa 4 ankesa apo 67% janë parashtruar nga ofrues të gjinisë femërore. Shih tabelën 36 dhe figurën 69.

*Figura 70: Ankesat e shqyrtuara të nivelit bazik, të mesëm dhe të lartë sipas gjinisë, 2019*




## 11.7. Bashkëpunimi me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë

Edhe gjatë vitit 2019, Këshilli ka bashkëpunuar ngushtë me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë. Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare vendore, ka qenë i orientuar sidomos në procesin e licencimit dhe rilicencimit të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare. Organizatat Joqeveritare (OJQ), të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi me MPMS/KPSHSF-në, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në sensibilizimin e punës së Këshillit, duke i njoftuar organizatat e tjera për procesin e licencimi/rilicencimit.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi, gjatë vitit 2019 janë licencuar/rilicencuar mbi 80 punëtorë socialë nga organizatat joqeveritare vendore.

Në vazhdën e punës së vet, Këshilli ka mirëpritur mbështetjen e Organizatave Ndërkombëtare "Save the Children" dhe "Terre des Hommes", ku qëllimi i kësaj mbështetjeje ka qenë përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit social, duke siguruar asistencë për institucionet e Kosovës në zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të shërbimeve sociale, për të plotësuar nevojat e popullatës së cenueshme në vend. Ky bashkëpunim dhe kjo asistencë nga këto Organizatave Ndërkombëtare do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2020.

# 12. TË ARRITURAT KRYESORE TË DEPARTAMENTIT GJATË VITIT 2019

## 12.1. Zbatimi i përfitimeve dhe kompensimeve nga Skemat që menaxhohen nga DPSF-ja

- **Skema e Ndihmës Sociale (SNS) -** gjatë vitit 2019 nga kjo skemë për çdo muaj kanë përfituar rreth 24.352 familje me 98.756 anëtarë në shumë mujore prej 2,582,340.00 euro. Ndërsa buxheti total që është shpenzuar për SNS-në është 31,542,532.50 euro. Shuma mujore bazë për një familje një anëtarëshe është 60.00 euro (minimalja) dhe për familjen 15 anëtarëshe 180.00 euro (maksimalja).

  Gjatë vitit 2019 është hartuar Drafti i Konceptdokumentit për Skemën e Ndihmë Sociale, i cili parasheh reformimin komplet të SNS-së.
- **Strehimi Familjar i Fëmijëve të Braktisur dhe Pa Përkujdesje Prindërore** - edhe gjatë vitit 2018 ka vazhduar realizimi i pagesës për dy format e strehimit familjar, ku:
  1. **Në strehim familjar brenda familjes** - çdo muaj kanë përfituar rreth 496 fëmijë, nga 100.00 euro në muaj. Shuma mujore e mjeteve të procesuara për pagesë, ka qenë rreth 49,600.00 euro, ndërsa shuma totale e buxhetit të shpenzuar është: 617,600.00 euro.
  2. **Në strehim familjar alternativ/jashtë familjes -** çdo muaj kanë përfituar rreth 53 fëmijë, të cilët janë paguar nga 250.00 euro në muaj apo 350.00 euro në muaj nëse fëmija është me aftësi të kufizuar. Shuma mujore e mjeteve të procesuara për pagesë ka qenë rreth 815,425.00 euro, ndërsa shuma totale e buxhetit të shpenzuar është: 155,450.00 euro.
- **Skema për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme (FFAKP) –** gjatë vitit 2019, nga kjo Skemë për çdo muaj kanë përfituar rreth 2.276 fëmijë me aftësi të kufizuara, nga 100.00 euro në muaj. Shuma mujore e mjeteve të procesuara për pagesën e FFAKP-së është rreth 276,400.00 euro. Buxheti i shpenzuar për FFAKP-në për vitin 2019 është 2,775,300.00 euro.
- **Ndihmë e njëhershme/emergjente -** gjatë vitit 2019 janë përkrahur 186 individë/familje. Shuma materiale për këtë lloj përkrahje është minimalja 100.00 euro dhe maksimalja 300.00 euro. Buxheti i shpenzuar është: 29,800.00 euro.

## 12.2. Zbatimi i programit të subvencionimit për energji MPMS/DPSF

Qeveria e Republikës së Kosovës që nga viti 2005 e deri më vitin 2019, për çdo vit ka ndarë nga 4.5 milion euro për subvencionimin e një sasie të energjisë së shpenzuar elektrike (deri në 400 KW,

gjegjësisht, deri në 300 KWh në muaj) për shfrytëzuesit (familjet) në Skemën e Ndihmës Sociale dhe Skemës së Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile të Luftës (FDILVC). Ky program është paraparë të realizohet gjatë pjesës së parë të vitit 2020.

### 12.3. Zbatimi i programit të mbështetjes financiare të OJQ-ve të licencuara

- Gjatë vitit 2019 nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), gjegjësisht, Departamentit të Politikave Sociale dhe Familjes (DPSF), janë subvencionuar me grante projektet e 26 OJQ-ve, që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare në shumë prej: 362,000.00 euro.

### 12.4. Shërbimet sociale dhe familjare

Gjatë vitit 2019 me shërbime të nevojshme sociale dhe familjare, janë trajtuar:

- 681 fëmijë pa përkujdesje familjare,
- 25 fëmijë të keqtrajtuar,
- 176 fëmijë me sjellje asociale,
- 485 fëmijë me sjellje delikuente,
- 129 fëmijë të evidentuar në punë të rënda,
- 14 fëmijë të vendosur në adoptim vendor,
- 2 fëmijë të vendosur në adoptim ndërkombëtar,
- 586 viktima të dhunës në familje *(327 viktima të moshës nën 18 vjeç dhe 259 viktima të moshës mbi 18 vjeç),* etj.

Gjatë vitit 2019, ka filluar filluar hartimi i Ligjit të Shërbimeve Sociale dhe Familjare dhe është në proces Drafti i Projektligjit për Shërbimet Sociale.

Është aprovuar Konceptdokumenti për Financat e Pushteti Lokal, në kuadër të të cilit është përfshirë propozimi i MPMS-së për krijimin e Grantit të Veçantë për Shërbime Sociale.

Janë nënshkruar 34 marrëveshje bashkëpunimi me kryetarët e komunave të Republikës së Kosovës për parandalimin dhe eliminimin e punëve të rënda të fëmijëve, të cilat kanë për qëllim të rregullojnë dhe të koordinojnë aktivitetet e institucioneve në nivelin qendror dhe lokal për mbrojtjen e fëmijëve nga eksploatimi ekonomik dhe nga kryerja e punëve që pengojnë edukimin e tyre, ose që janë të dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin psiko-fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror të fëmijës, si dhe parandalimin dhe eliminimin efektiv të punës së fëmijëve, me fokus të veçanta ndaj formave të rënda dhe të rrezikshme të punës së tyre.

## 12.5. Strehimi rezidencial i personave të moshuar pa përkujdesje familjare, fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor

Numri i klientëve të vendosur në shtëpitë me karakter nacional, të cilat menaxhohen nga niveli qendror MPMS/DPSF, gjatë vitit 2019 ka qenë:

- Shtëpia për Personat e Moshuar pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë – 81 klientë;
- Instituti Special në Shtime – 64 klientë;
- Shtëpia e Fëmijëve me bazë në komunitet në Shtime -10 klientë.

Numri i klientëve të vendosur në Shtëpitë me Bazë në Komunitet, të cilat që nga vitit 2016 menaxhohen nga niveli komunal, gjatë vitit 2019 ka qenë:

- Shtëpia e Komunitetit për Personat e Moshuar në Skenderaj -18 klientë;
- Shtëpia e Komunitetit për Personat e Moshuar në Gurakoc-Istog - 17 klientë;
- Shtëpia e Komunitetit për Personat e Moshuar në Graçanicë - 8 klientë;
- Shtëpia e Komunitetit për Personat e me Aftësi të Kufizuara Mendore-Ngecje në Zhvillimin Mendor në Shtime - 14 klientë;
- Shtëpia e Komunitetit për Personat e me Aftësi të Kufizuara Mendore në Lipjan - 10 klientë;
- Shtëpia e Komunitetit për Personat e me Aftësi të Kufizuara Mendore në Ferizaj - 10 klientë;
- Shtëpia e Komunitetit për Personat e me Aftësi të Kufizuara Mendore në Vushtrri - 13 klientë;
- Shtëpia e Komunitetit për Personat e me Aftësi të Kufizuara Mendore në Dardanë - 12 klientë;
- Shtëpia e Komunitetit për Personat e me Aftësi të Kufizuara Mendore në Deçan - 9 klientë;
- Shtëpia e Komunitetit për Personat e me Aftësi të Kufizuara Mendore në Graçanicë - 10 klientë.

## 12.6. Strehimi rezidencial i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore

Në strehimoren për Strehimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore në Lipjan, gjatë vitit 2017 janë strehuar dhe trajtuar me shërbimet e nevojshme 35 viktima (*20 viktima të mitura dhe 15 të moshës madhore).*

## 12.7. Licencimi i ofruesve individual dhe i subjekteve juridike (OJQ-ve)

Gjatë viti 2019 janë licencuar:

- 261 ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare;
- 14 subjekte juridike, OJQ që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.

## 12.8. Ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi i ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare

Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare në bashkëpunim me Zyrën e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovës, përmes Organizatës KMOP "Save the Children", organizatave dhe fondacioneve të ndryshme, ka organizuar dhe mbajtur trajnime në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare. Këto trajnime kryesisht kanë pasur për qëllim trajnimin e punëtorëve social të cilët ofrojnë shërbime direkte për personat dhe familjet në gjendjen e nevojës sociale. Deri më tani, janë trajnuar mbi 350 ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare në të gjitha nivelet e licencimeve.

## PËRMBLEDHJE ME TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

- **Numri total i fëmijëve në kujdestari (dhjetor 2019) ..........................................................................................681**
- Numri i fëmijëve pa përkujdesje prindërore/të braktisur (raste të paraqitura gjatë vitit 2019).................................28

- **Numri i fëmijëve në strehim familjar te farefisi (dhjetor 2019) ............................................................................496**
- Numri i familjeve strehuese.......................................................................................................................................351
- Shuma mujore e përfitimit për një fëmijë në strehim familjar te farefisi.........................................................100.00€
- Shuma e mjeteve e procesuar për muajin dhjetor 2018...........................................................................49,600.00€
- Buxheti i shpenzuar për strehim familjar te farefisi.................................................................................617,600.00€

- **Numri i fëmijëve në strehim familjar jashtë farefisit (dhjetor 2019)......................................................................53**
- Numri i familjeve strehuese (dhjetor 2019).................................................................................................................26
- Shuma mujore e përfitimit për një fëmijë në strehim familjar jashtë farefisit.............................................250.00€
- Shuma mujore e përfitimit për një fëmijë me aftësi të kufizuar në strehim familjar jashtë farefisit..................350.00€
- Shuma e mjeteve e procesuar për muajin dhjetor 2019...........................................................................15,425.00€
- Buxheti i shpenzuar për strehim familjar jashtë farefisit......................................................................... 155,450.00€

- **Numri i fëmijëve në adoptim vendor.........................................................................................................................14**
- Numri i fëmijëve në adoptim ndërkombëtar.....................................................................................................................2

- **Numri i fëmijëve të vendosur në strehimoren “SOS-Familje”.......................................................................................43**
- Numri i fëmijëve të vendosur në strehimoren “Caritas Umbria”.......................................................................................17

- **Numri i fëmijëve të keqtrajtuar .....................................................................................................................................25**
- Numri i fëmijëve me sjellje asociale ...........................................................................................................................176
- Numri i fëmijëve në konflikt me ligjin...........................................................................................................................485

- **Numri i fëmijëve pa përkujdesje prindërore të riatdhesuar...............................................................................25**
- Numri i fëmijëve pa përkujdesje prindërore të kthyer nga zonat e konfliktit në Siri................................................17

- **Numri i fëmijëve në punë të rënda.........................................................................................................................129**

- **Numri i viktimave të dhunës në familje.......................................................................................................................586**
- Numri i viktimave të dhunës në familje, mbi moshën 18 vjeç ...............................................................295 apo 44%
- Numri i viktimave të dhunës në familje, nën moshën 18 vjeç...............................................................327 apo 56%
- Numri i viktimave të dhunës në familje (femra) ......................................................................................426 apo 76%
- Numri i viktimave të dhunës në familje nën moshë 18 vjeç (meshkuj) ..................................................141 apo 24%
- Buxheti i ndarë nga MPMS-ja për OJQ-të që trajtojnë rastet e dhunës në familje..................................257.000.00€

- **Numri i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.........................................................................................................51**
- Numri i viktimave të trafikimit mbi moshën 18 vjeç..........................................................................................12 apo 24%
- Numri i viktimave të trafikimit nën moshën 18 vjeç.........................................................................................39 apo 76%
- Numri i viktimave të trafikimit (femra) .................................................................................................................50 apo 98%
- Numri i viktimave të trafikimit (meshkuj) ...............................................................................................................1 apo 2%
- Numri i viktimave vendore të trafikimit...............................................................................................................46 apo 90%
- Numri i viktimave ndërkombëtare të trafikimit .........................................................................................................5 apo 10%

- **Numri i viktimave të krimeve seksuale-fëmijë...........................................................................................................11**

- **Numri i kërkesave për martesë të parakohshme...........................................................................................................16**
- Numri i kërkesave për martesë të parakohshme (femra).................................................................................................16
- Numri i kërkesave për martesë të parakohshme të nacionalitetit shqiptar ...............................................14 apo 87%
- Numri i kërkesave për martesë të parakohshme të nacionaliteteve të tjera..............................................2 apo 13%

- **Numri i rasteve të trajtuar me këshilla martesore.......................................................................................................344**
- Numri i rasteve të nacionalitetit shqiptar.........................................................................................................303 apo 88%

- Numri i rasteve të nacionaliteteve të tjera..........................................................................................41 apo 22%

- **Numri i ankesave të shkallës së dytë për shërbime sociale.................................................................................6**

- **Numri i personave të moshuar pa përkujdesje familjare të vendosur në SHPMPF-Prishtinë.........................63**
- Numri i personave të moshuar të vendosur në Shtëpinë e Komunitetit-Gurakoc...................................................15
- Numri i personave të moshuar të vendosur në Shtëpinë e Komunitetit-Skenderaj.................................................20
- Numri i personave të moshuar të vendosur në Shtëpinë e Komunitetit-Graçanicë...................................................7

- **Numri i personave me aftësi të kufizuara mendore të vendosur në Institutin Special në Shtime...................42**
- Numri i personave të vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Kamenicë.......................................................11
- Numri i personave të vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Shtime...................................................................14
- Numri i personave të vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Vushtrri .................................................................13
- Numri i personave të vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Deçan.......................................................................9
- Numri i personave të vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Ferizaj...................................................................10
- Numri i personave të vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Graçanice...............................................................10
- Numri i personave të vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Lipjan......................................................................10

- **Numri fëmijëve me aftësi të kufizuara të vendosur në Shtëpinë e Komunitetit në Shtime.............................10**

- **Numri i kërkesave për strehim institucional/rezidencial.....................................................................................40**
- Numri i kërkesave të aprovuara...........................................................................................................................35
- Numri i kërkesave të refuzuara...............................................................................................................................5
- Numri i kërkesave të aprovuara, në pritje për vendosje..........................................................................................9

- **Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në Skemën e FFAKP-së...................................................................2.276**
- Buxheti i shpenzuar për Skemën e FFAKP-së...................................................................................2,775,300.00€

- **Numri i fëmijëve në Skemën e FFAKP-së që janë në kopësht.............................................................39 apo 2%**
- Numri i fëmijëve në Skemën e FFAKP-së që janë në arsim parashkollor.............................................234 apo 10%
- Numri i fëmijëve në Skemën e FFAKP-së që janë në arsim fillor .........................................................376 apo 17%
- Numri i fëmijëve në Skemën e FFAKP-së që janë në arsim të mesëm .....................................................7 apo 0%
- Numri i fëmijëve në Skemën e FFAKP-së që nuk janë në shkollë.....................................................1.620 apo 71%

- **Numri i kërkesave të vlerësuara nga K.M, Shkalla e parë, Skema e FFAKP-së..............................................909**
- Numri i kërkesave të aprovuara.........................................................................................................382 apo 42%
- Numri i kërkesave të refuzuara..........................................................................................................320 apo 35%
- Numri i kërkesave në plotësim...........................................................................................................138 apo 15%
- Numri i kërkesave që nuk janë paraqitur në senacë..................................................................................69 apo 8%

- **Numri i banorëve në Republikë e Kosovës...............................................................................................1.820.631**
- Numri i ekonomive familjare në Republikën e Kosovës.................................................................................297.090
- Çmimi-vlera e shportës mujore e një qytetari në Kosovë kushton:......... ........................................................115€
- Konsumi për kokë banori brenda vitit kushton ...............................................................................................1.386€
- Konsumi vjetor për një ekonomi familjare kushton.........................................................................................7.611€

- **Buxheti i shpenzuar ....................................................................................................................32,858,645.00€**

- **Numri i familjeve në SNS (dhjetor 2018) ...........................................................................................24.352**
- Numri i familjeve në SNS, kategoria I .................................................................................16.728 ose 69%
- Numri i familjeve në Kategorinë II.........................................................................................................7.624 ose 31%
- Numri i familjeve shqiptare në SNS.....................................................................................18.648 ose 77%
- Numri i familjeve joshqiptare në SNS..................................................................................5.704 ose 23%
- Bartëse (femra) të ndihmës sociale ....................................................................................8.252 ose 34%
- Bartës (meshkuj) të ndihmës sociale...................................................................................16.100 ose 66%

  Prindër vetushqyese (femra 1.886 dhe 404 meshkuj) në ndihmë sociale............................................2.293 ose 9%

- **Numri i anëtarëve të familjes në SNS..........................................................................................................103.399**
- Numri i anëtarëve të familjes femra në SNS...............................................................................42.619 ose 57%
- Numri i anëtarëve të familjes meshkuj në SNS...........................................................................31.800 ose 43%

- Numri i anëtarëve të familjeve në SNS të moshës 0 –18 vjeç..........................................................49.457 ose 50%
- Numri i anëtarëve të familjeve në SNS të moshës 19 – 65 vjeç.......................................................48.295 ose 49%
- Numri i anëtarëve (pasiv në pagesë) të familjeve në SNS të moshës + 65 vjeç.............................1.043 ose 1.06%

- **Shuma minimale mujore e ndihmës sociale për një familje.........................................................................60.00€**
- Shuma maksimale mujore e ndihmës sociale.......................................................................................180.00€
- Mesatarja mujore e ndihmës sociale për një familje.........................................................................126.50€
- Mesatarja mujore e ndihmës sociale për një anëtar të familjes........................................................................22.85€
- Mesatarja ditore e ndihmës sociale për një anëtar të familjes..........................................................................0.74€
- Shtesa mujore për çdo fëmijë në familje të moshës 0-18 vjeç..........................................................................5.00€

- **Komisioni Mjekësor i Shkallës I ka vlerësuar për paaftësi për punë (persona)........................................21.577**
- Numri i personave të vlerësuar të paaftë për punë mbi 80% (aprovim)........................................19.711 ose 91%
- Numri i personave të vlerësuar të aftë për punë (refuzim)....................................................................1.303 ose 6%
- Nmri i kërkesave të kthyera për plotësim..........................................................................................563 ose 3%

- **Numri i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni i Ankesave, Shkalla II ..........................................................610**
- Numri i ankesave të aprovuara në Shkallën II .......................................................................................124 ose 20%
- Numri i ankesave të refuzuara në Shkallën II .......................................................................................486 ose 80%

- **Komisioni Mjekësor i Shkallës II ka vlerësuar për paaftësi për punë (persona)...........................................428**
- Komisioni Mjekësor i Shkallës II ka vlerësuar të paaftë për punë (persona)-aprovim...............................90 ose 21%
- Komisioni Mjekësor i Shkallës II ka vlerësuar të aftë për punë (persona)-refuzim..................................338 ose 79%

- **Numri i kontesteve administrative në procedurë nga Gjykata Themelore.......................................................11**
- Numri i kontesteve administrative, ta aprovuara nga Gjykata Themelore...............................................................0
- Numri i kontesteve administrative në rivendosje nga Gjykata Themelore...............................................................0

- **Numri i QPS-ve të kontrolluara nga NJKM...............................................................................................................13**
- Lëndë të kontrolluara nga NJKM 818 (komplet: 521 ose 64%; jo komplet.............................................297 ose 36%
- Familje të verifikuara nga NJKM 486 (të përzgjedhshme: 437 ose 90%; të papërzgjedhshme................49 ose 10%

- **Numri i familjeve/individëve përfitues të ndihmës emergjente 100 euro.........................................................109**
- Numri i familjeve/individëve përfitues të ndihmës emergjente 150 deri 300 euro...................................................78
- Buxheti i shpenzuar për ndihma të njëhershme (2018)..........................................................................29,800.00€

- **Buxheti për subvencionim të energjisë elektrike për vitin 2018....................................................4,500,000.00€**
- Numri i familjeve të subvencionuara në të gjitha skemat/pensionet.....................................................................35.851
- Numri i familjeve të subvencionuara për SNS.........................................................................................23.304 ose 65%
- Numri i familjeve të subvencionuara për FDIL.......................................................................................10.442 ose 29%
- Numri i familjeve të subvencionuara për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik..................................1.269 ose 4%
- Numri i familjeve të subvencionuara për Personat e Verbër...................................................................836 ose 2%
- Mesatarja mujore e energjisë elektrike të subvencionuar për një familje.................................270 KWh apo 11.27€
- Shuma vjetore e energjisë elektrike të subvencionuar për një familje...........................................................135.00€

- **Numri i familjeve/individëve përfitues të Skemave të MPMS-së, 2019.....................................................284.326**
- Numri i përfituesve të SNS-së (dhjetor 2019)..................................................................................................24.352
- Numri i përfituesve të Pensionit Bazik të Moshës (dhjetor 2019)......................................................................47.486
- Numri i përfituesve të Pensioneve të Personave me Aftësi të Kufizuara (dhjetor 2019)....................................17.791
- Numri i përfituesve të Pensionit Familjar (dhjetor 2019).......................................................................................3.940
- Numri i përfituesve të Pensionit Invalidor të Punës (dhjetor 2019)........................................................................108
- Numri i përfituesve të Pensionit Paraplegjik dhe Tetraplegjik (dhjetor 2019)......................................................3.106
- Numri i përfituesve të të Skemës së FDIL-së (dhjetor 2019).............................................................................10.493
- Numri i përfituesve të Skemës për Veteranët e Luftës (dhjetor 2019)................................................................38.101
- Numri i përfituesve të Pensionit të TMK-së (dhjetor 2019)....................................................................................1.098
- Numri i përfituesve të Pensioneve të Trepçës (dhjetor 2019).................................................................................2.635
- Numri i përfituesve të Skemës së Personave të Verbër (dhjetor 2019).................................................................1.976
- Numri i përfituesve të Skemës së FFAKP-së (dhjetor 2019)...................................................................................2.276
- Numri i përfituesve nga Strehimi Familjar i Fëmijëve brenda Familjes (dhjetor 2019) ............................................496
- Numri i përfituesve nga Strehimi Familjar i Fëmijëve jashtë Familjes (dhjetor 2019)................................................53

- **Buxheti i shpenzuar për pagesën e Skemave të MPMS-së, 2019.............................................446,555,731.16 €**

- **Numri i OJQ-ve që ofrojnë shërbime sociale familjare, të licencuara (2019)....................................................18**
- Numri total i OJQ-ve të licencuara/rilicencuara.........................................................................................................43

- **Numri inspektimeve të kryera nga NJMI-ja ..............................................................................................................10**
- Numri i inspektimeve/rinispektimeve të rregullta ..........................................................................................................7
- Numri i inspektimeve të jashtëzakonshme.......................................................................................................................3

- **Numri i përgjithshëm i ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare të licencuar ...................................1.190**
- Numri totali ofruesve të licencuar, niveli superior.......................................................................................................598
- Numri total i ofruesve të licencuar, niveli bazik, i mesëm dhe i lartë........................................................................592

- **Numri i kërkesave të shqyrtuara, niveli superior, 2019...........................................................................................184**
- Numri i kërkesavë të aporovuara..................................................................................................................142 ose 77%
- Numri i kërkesavë të refuzuara ......................................................................................................................25 ose 14%
- Numri i kërkesavë në plotësim .........................................................................................................................17 ose 9%
- Numri i ofruesve të licencuar (për herë të parë).............................................................................................82 ose 58%
- Numri i ofruesve të rilicencuar.........................................................................................................................60 ose 42%

- **Numri i kërkesave të shqyrtuara, niveli bazik, i mesëm dhe i lartë, 2019.......................................................164**
- Numri i kërkesave të aporovuara....................................................................................................................119 ose 73%
- Numri i kërkesave të refuzuara ......................................................................................................................20 ose 12%
- Numri i kërkesave në plotësim ........................................................................................................................25 ose 15%
- Numri i ofruesve të licencuar (për herë të parë).............................................................................................62 ose 52%
- Numri i ofruesve të rilicencuar.........................................................................................................................57 ose 48%

- **Numri i ankesave të shqyrtuara, 2019.........................................................................................................................15**
- Numri i kërkesave të aporovuara ....................................................................................................................14 ose 93%
- Numri i kërkesave të refuzuara .........................................................................................................................1 ose 7%

- **Numri i ankesave të shqyrtuara të nivelit superior, 2019.............................................................................................8**
- Numri i ankesave të aprovuara.......................................................................................................................8 ose 100%
- Numri i ankesave të refuzura.............................................................................................................................0 ose 0%

- **Numri i ankesave të shqyrtuara të nivelit bazik, të mesëm dhe të lartë, 2019....................................................7**
- Numri i ankesave të aprovuara.........................................................................................................................6 ose 86%
- Numri i ankesave të refuzura.............................................................................................................................1 ose 14%

- **Numri i total i ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare të trajnuar ......................................................350**

**Prishtinë, 2020**